



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 32/2021 regjistër (JR)  
Datë 11.06.2021

Nr. 20 i vendimit  
Datë 03.05.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 03.05.2023, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Bledar Maksuti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 367, datë 16.04.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### **VËREN:**

#### **I. Rrethanat e çështjes**

1. Subjekti i rivlerësimit Bledar Maksuti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, mbante detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për shkak të këtij funksioni, në zbatim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Për subjektin e rivlerësimit, nga Komisioni janë zhvilluar hetime për të tria kriteret e rivlerësimit dhe bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.
  - 2.1 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit është konstatuar se:
    - deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
    - nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
    - ka kryer fshehje të pasurisë;
    - ka kryer deklarim të rremë;
    - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 2.2 DSIK-ja, në zbatim të përcaktimeve të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i ka përcjellë Komisionit raportin<sup>1</sup> mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Bledar Maksuti, me anë të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për të vazhduar detyrën.
  - 2.3 Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme i ka përcjellë Komisionit një raport<sup>2</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

---

<sup>1</sup> Raport i përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.10.2017, i deklasifikuar me vendimin e KDZH-së nr. {\*\*\*}, datë 31.07.2019.

<sup>2</sup> Raport i përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.02.2020.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

- 3 Me vendimin nr. 367, datë 16.04.2021, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bledar Maksuti, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [...].*
- 4 Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Bledar Maksuti është marrë bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe në vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se:
- a) **Në lidhje me vlerësimin e pasurisë:** (i) *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;* (ii) *subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme krijimin e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tij apo të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016;* (iii) *subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm: (a) të të ardhurave të babait të tij; si dhe (b) të pasurive të krijuara nga babai i tij ndër vite, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*
- b) **Në lidhje me vlerësimin të figurës:** *subjekti i rivlerësimit, z. Bledar Maksuti, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera, nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklaram të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.*
- c) **Në lidhje me vlerësimin profesional:** *subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*
- 5 Në përfundim, mbështetur në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## III. Shkaqet e ankimit dhe analizimi i tyre

- 6 Subjekti i rivlerësimit Bledar Maksuti ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 367, datë 16.04.2021, me anë të të cilit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): *Ndryshimin e vendimit nr. 367, datë 16.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë.*

### A. Shkaqet e ankimit

- 7 Në ankim subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime me anë të të cilave kundërshton analizën dhe konkluzionet e vendimit të Komisionit që kanë të bëjnë me kriterin e vlerësimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur e atyre të tjerë të lidhur, si më poshtë vijon.

**7.1** Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar vlerësimin e Komisionit lidhur me identifikimin e pasurive që janë objekt kontrolli në funksion të procesit të tij të rivlerësimit, duke pretenduar se pasuritë në pronësi të babait dhe nënës së tij nuk mund të jenë objekt kontrolli për sa kohë ai me prindërit nuk është i lidhur me interesa pasurorë sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe se për këto pasuri nuk provohet se ai ka të drejta reale dhe interes pasuror.

**7.2** Për pasurinë apartament me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të babait të tij, blerë që në vitin 2004, subjekti kundërshton si të pabazuara ligjërisht konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se:

- (i)** Nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për një pronë të blerë nga babait i tij larg periudhës kur subjekti filloi detyrën e prokurorit, të financuar tërësisht me të ardhura të ligjshme të siguruar nga puna e të atit, të cilat nuk ka pasur detyrim t'i deklarojë në Deklaratat Vjetore Periodike (në vijim “DVP”) dhe që janë përlllogaritur në mënyrë jo të drejtë nga Komisioni.
- (ii)** Edhe pse nuk duhej kryer analiza për pasuri të krijuara nga prindërit para periudhës që subjekti ushtronte detyrën, ai pretendon se kjo analizë është e pasaktë pasi nuk përfshin si të ardhura vlerat reale që janë siguruar nga shitja e pasurive të tjera paluajtshme.
- (iii)** Analiza ekonomike për burimet e financimit të kësaj pasurie është e pasaktë pasi në të nuk përfshihen të ardhurat që vetë subjekti ka siguruar nga puna në OSBE dhe IRC para ushtrimit të detyrës si prokuror

**7.3** Për pasurinë automjet Mercedes Benz 250 D dhe Mercedes Benz 270 D, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të padrejta konkluzionet e Komisionit që kanë të bëjnë me: **(i)** mënyrën e fitimit të pronësisë të automjetit Mercedes Benz 250 D; **(ii)** mospërfshirjen në analizën financiare të vlerës së shitjes së mjetit Mercedes Benz 250 D (në shumën 700.000 lekë), duke pretenduar se përveçse ligji nuk parashikonte pagimin e tatimit për shitblerjet e automjeteve personale, por nga vlera e shitjes nuk ka realizuar fitim pasi duhet konsideruar se ka investuar/shpenzuar ndër vite për mirëmbajtjen e mjetit; **(iii)** shuma 700.000 lekë e cila u sigurua nga shitja e automjetit Mercedes Benz 250 D, duhet të konsiderohet si një burim i ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e automjetit tjetër Mercedes Benz 270 D në vitin 2009.

**7.4** Për automjetin Volkswagen Sharan 2.0, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ai pretendon se analiza e Komisionit është kryer në mënyrë të cunguar, duke mos përfshirë si burim financimi të ardhurat familjare të deklaruara si burim në deklaratën “vetting”, të përbëra nga: **(i)** gjendja cash e subjektit dhe bashkëshortes në shumën 800.000 lekë, e cila pasi u përdor, më pas u shtua në këtë sasi deri në fund të vitit 2015; **(ii)** gjendja në cash e babait të subjektit, të cilën, sipas analizës financiare, ai kishte mundësi të krijonte.

**7.5** Lidhur me garazhin në pronësi të babait, subjekti pretendon se për sa kohë nuk ka të drejta reale dhe as interesa pasurorë dhe as ndonjë marrëdhënie dhurimi apo huaje siç kërkon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për këtë pasuri. Gjithashtu subjekti pretendon se për blerjen e kësaj pasurie, nëse do të përlllogaritet mundësia për kursim e babai të tij për periudhën 2008-2014, rezulton se ai kishte mundësi për financimin me burime të ligjshme të saj.

**7.6** Për llogarinë dyemërore në Bankën BKT, në shumën 3.000.000 lekë, e cila figuron në emër të nënës dhe subjektit të rivlerësimit, ky i fundit pretendon se nuk ka krijuar dhe as nuk

pretendon se gëzon ndonjë pjesë të kësaj shume, e cila e ka origjinën e krijimit që në vitin 2005, e më pas, në vitin 2012, u rivendos në depozitë dyemërore, tek e cila subjekti kishte vetëm të drejtën e tërheqjes së shumave me autorizim të nënës së tij. Gjithashtu subjekti pretendon se për këtë likuiditet në bankë, provohet krijimi i saj me burime të ligjshme nga të ardhurat e nënës dhe babait të tij.

**7.7** Për llogarinë në Bankën BKT, në vlerën 1.000.000 lekë, në emër të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të ngelet jashtë kontrollit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, pasi ajo është krijuar si kontribut i familjes së origjinës së bashkëshortes para martese. Megjithatë, për këtë shumë, subjekti pretendon se provohet burimi i ligjshëm i krijimit, nga të ardhurat e familjes së origjinës së bashkëshortes së tij.

**7.8** Për llogarinë në Bankën BKT, në shumën 3.116.878 lekë, në emër të babait të tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se edhe në këtë rast, ai nuk mund të ngarkohet me barrë prove dhe përgjegjësi për pasuri individuale të babait, mbi të cilën ai nuk ka asnjë interes dhe të drejta pasurore. Megjithatë, subjekti pretendon se provohet krijimi i likuiditeteve të kësaj llogarie, me burime të ligjshme, me burim nga kursimet në cash të babait, të cilat, sipas analizës financiare, ai kishte mundësi t'i krijonte.

**7.9** Lidhur me gjendjen cash “si trung familjar në shumën 1.400.000 lekë”, të deklaruar në deklaratën “vetting”, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësinë e krijimit të saj, duke pretenduar se kjo shumë përfaqëson një pjesë të kursimeve në cash (në shumën totale prej 4.300.000 lekësh) që nga analiza financiare babai i tij kishte mundësi të krijonte, dhe që i zotëronte në fund të vitit 2016, nga e cila një pjesë (2.700.000 lekë) shërbyen për hapjen e depozitës në Bankën BKT dhe pjesa tjetër u mbajt si likuiditet cash në banesë.

**7.10** Për huatë e dhëna në vitin 2015 nga babai i tij, z. Sh. Ll., në shumën 4.500.000 lekë, dhe z. Xh. K. 1.500.000 lekë, subjekti pretendon se provohet mundësia e babait (në cilësinë e huadhënësit) të tij për t'i krijuar ato me burime të ligjshme, pjesë e të cilave janë edhe kthimet e huave nga motrat e subjektit.

**7.11** Konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën vjetore periodike (ne vijim “DVP”) të vitit 2015 dhe në deklaratën “vetting”, marrjen hua prej babait të shumës 800.000 lekë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, subjekti i rivlerësimit e kundërshton si jo të drejtë dhe të bazuar në ligj; gjithashtu konsideron si jo të drejtë edhe qëndrimin e Komisionit se nuk provohet mundësia financiare e babait të subjektit për kthimin e shumës kësaj shoqërie (“{\*\*\*}” ShPK).

**7.12** Subjekti i rivlerësimit e konsideron si jo të bazuar ligjërisht qëndrimin e Komisionit lidhur me mosdeklarimin në deklaratën “vetting” prej babait të tij të kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2014, duke pretenduar se kjo kërkesë është përtej detyrimeve ligjore që përcakton ligji nr. 84/2016.

**7.13** Subjekti i rivlerësimit konsideron si jo të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti dhe babai i tij nuk kanë deklaruar në deklaratën “vetting” në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë lokal me sip. 80 m<sup>2</sup>, në qytetin e Peshkopisë.

7.14 Me qëllim analizimin sa më të drejtë të çështjes që i përket procesit të tij të rivlerësimit, subjekti ka kërkuar nga Kolegji vlerësimin e saj duke aplikuar parimin e proporcionalitetit.

## **B. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit**

### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

- 8 Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bledar Maksuti, vendim për të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti kërkon të ndryshohet, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

### *b) Legjitimimi i ankuesit*

- 9 Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

### *c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

- 10 Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Kolegji konstatoi se me ankimin, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova të reja dhe as argumente/pretendime lidhur me situatën faktike të konstatuar prej Komisionit apo me shkelje procedurale që kanë afektuar procesin e rregullt ligjor, të cilat, në kuptim të neneve 47 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, do të përbënin shkak për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

## **C. Analizimi i shkaqeve të ankimit**

- 11 Kolegji fillimisht mori në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi të cilin ngrihet pothuajse tërësia e gjithë ankimit të tij, sipas të cilit ai kundërshton si jo të drejtë dhe të bazuar në ligj analizën ekonomike të kryer nga Komisioni, duke qenë se ka identifikuar në mënyrë të gabuar pasuritë që janë objekt kontrolli, në funksion të procesit të tij të rivlerësimit, duke pretenduar se : (i) *pasuritë në pronësi të babait dhe nënës së tij nuk mund të jenë objekt kontrolli, për sa kohë ai me prindërit nuk është i lidhur me interesa pasurorë, sipas nenit 32,*

*pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe se për këto pasuri nuk provohet se ka të drejta reale dhe interes pasuror.*

**11.1** Në analizë të këtij shkakut ankimi, i cili afekton trajtimin që Kolegji do të bëjë në vijim për pjesën më të madhe të shkaqeve të ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, që lidhen me vlerësimin e pasurive të krijuara nga prindërit e tij, Kolegji konstatoi se në vendimin e Komisionit lidhur me këto pasuri, është konkluduar në vija të përgjithshme se pavarësisht faktit se pasuritë janë krijuar prej prindërve të subjektit edhe para se ai të ushtronte detyrën e prokurorit, pasja prej tyre e statusit të personit të lidhur sipas pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, e ngarkon subjektin me përgjegjësi për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të tyre. Gjithashtu Komisioni ka vlerësuar se pavarësisht se, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), subjekti dhe prindërit e tij nuk kishin detyrim të deklarorin në deklarata periodike, fakti që subjekti ka deklaruar në to të ardhurat e prindërve, e vendos atë nën detyrimin e deklarimit të plotë për ta, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Fakti i mosdeklarimit të kursimeve në *cash* të prindërve të tij apo veprimeve juridike të kryera prej tyre, e vendos subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe në pamundësi për të provuar në procesin e rivlerësimit, burimet e ligjshme të krijimit të këtyre pasurive, si edhe ekzistencën e marrëdhënieve juridike të pretenduara prej tij se janë kryer prej tyre. Komisioni ka konstatuar për më tepër se analiza financiare për subjektin, është bërë duke konsideruar të ardhurat e gjithë familjes, pasi nëse do të analizoheshin më vete subjekti, rezultatet e analizës financiare do të ishin me balanca negative edhe më të larta.

**11.2** Nga aktet e administruara gjatë të hetimit administrativ, Kolegji konstatoi se sipas certifikatës të përbërjes familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, subjekti i rivlerësimit, nga momenti i deklarimit fillestar të pasurisë para fillimit të detyrës si oficer i policisë gjyqësore në vitin 2004<sup>3</sup>, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, ka qenë në të njëjtën përbërje/gjendje familjare me prindërit e tij. Krahas këtij informacioni që vjen nga dokumentet ligjore, edhe vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, ka pohuar se ai ka jetuar në të njëjtën banesë me prindërit gjatë gjithë këtyre viteve, duke pasur një ekonomi të përbashkët me ta. Në këto kushte, Kolegji, në dritën e parashikimeve të pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“person i lidhur” i subjektit të rivlerësimit është [...] çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit për periudhën e rivlerësimit, çmtoi se me të drejtë prindërit e subjektit të rivlerësimit janë konsideruar nga Komisioni si persona të lidhur me të. Gjithashtu, nga leximi i deklaratimeve të bëra nga subjekti sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, të njohur ndryshe edhe si deklarata e pasurisë *vetting*, konstatohet se edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit kjo dispozitë është kuptuar dhe aplikuar në mënyrë të tillë, pasi rezultoi se deklarata e pasurisë *vetting* është plotësuar në cilësinë e personit të lidhur, përveç bashkëshortes së subjektit, edhe nga babai dhe nëna e tij, të cilët kanë deklaruar të gjitha pasuritë që ata dispononin në momentin e deklarimit, si dhe burimet të krijimit të tyre. Në këto kushte, pretendimet e subjektit për një status të*

---

<sup>3</sup> Në këtë rast, duhet konsideruar se subjekti i rivlerësimit Bledar Maksuti ka deklaruar pasurinë në vitin 2004, para fillimit të detyrës si oficer i policisë gjyqësore, dhe e ka kryer sërish deklarimin fillestar të pasurisë edhe në gusht të vitit 2008, pas emërimit të tij si prokuror.

ndryshëm të prindërve të tij nga ai i personit të lidhur, siç i ka kualifikuar edhe Komisioni, vlerësohen të pambështetura në ligj.

**11.3** Në vijim të kësaj analize, Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit se pasuritë që prindërit e subjektit disponojnë veçmas tij, nuk duhet të jenë objekt kontrolli në funksion të procesit të tij të rivlerësimit sepse ai nuk gëzon të drejta reale dhe as interesa pasurorë ndaj këtyre pasurive, duke qenë se ai nuk është në marrëdhënie huaje apo dhurimi me prindërit e tij, siç kërkon parashikimi i nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se Komisioni, në vlerësimin që u ka bërë pasurive të prindërve të subjektit të rivlerësimit, i ka identifikuar ata si persona të lidhur me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, të cilët, për shkak të kësaj cilësie, kanë detyrimin të deklarojnë të gjitha pasuritë që kanë pasur në pronësi në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, si dhe të burimeve të financimit të tyre. Kualifikimi i prindërve si persona të lidhur dhe detyrimi i subjektit për të provuar burimet e ligjshme të tyre, nuk buron nga përcaktimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, siç subjekti potencon dhe analizon në ankimin e tij, por nga parashikimet e nenit 3, pika 13 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të provojë bindshëm burimet e krijimit të pasurive të personave të lidhur të tij. Në kushtet kur Kolegji vlerëson se prindërit e subjektit, të cilët kanë qenë në një gjendje familjare me të përgjatë gjithë viteve të ushtrimit të funksionit të tij si prokuror, por edhe më parë, dhe veçanërisht në tri vitet para se të hynte në fuqi ligji nr. 84/2016<sup>4</sup>, pra gjatë periudhës së rivlerësimit sipas parashikimit të pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka për justifikimin e tyre, të njëjtin detyrim si për çdo person tjetër të lidhur, siç mund të ishin bashkëshortja apo fëmijët e tij. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se pasuritë e prindërve nuk mund të jenë objekt kontrolli në funksion të këtij procesi, gjenden të pabazuara. Pa relevancë gjenden edhe referimet që subjekti ka bërë në jurisprudencën e Kolegjit për trajtimin e personave të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë prindërit e subjektit nuk përfshihen te kjo kategori, por te personat e lidhur me subjektin, dhe jo për shkak të pasjes së ndonjë të drejta reale apo interesi pasuror specifik, por për shkak të faktit juridik të qenies në një përbërje familjare me subjektin, sipas parashikimit të pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

**11.4** Në vijim të këtij qëndrimi, Kolegji vlerëson me rëndësi për zgjidhjen e çështjes që të marrë disa qëndrime lidhur me detyrimet e subjektit të rivlerësimit në raport me vlerësimin e pasurisë së prindërve të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, të cilat janë të ndryshme me ato të mbajtura nga Komisioni e që afektojnë në tërësinë e tyre, mënyrën e vlerësimit të burimeve të ligjshme të përdorura prej prindërve të subjektit për krijimin e këtyre pasurive, por edhe për pasuritë e tjera të krijuara në vite, veçanërisht krijimin e likuiditeteve në *cash* nga të ardhurat e tyre.

**11.5** Në vijim do të renditen disa konsiderata faktike dhe ligjore lidhur me çështjen e përshkruar më lart, mbi të cilat Kolegji ka mbështetur qëndrimet e tij.

**11.6** Së pari, prindërit e subjektit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/ 2003, nuk kanë gëzuar ndonjë status ligjor që detyronte subjektin e rivlerësimit, si subjekt deklarues sipas këtij ligji,

---

<sup>4</sup> Pika 12 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 parashikon se : ““Periudha e rivlerësimit” është periudha e punës së subjektit të rivlerësimit, gjatë së cilës vlerësohen aftësitë etike dhe profesionale të tij, sipas këtij ligji”.



apo ata vetë, që të bënin deklarime në deklarata periodike të pasurisë, për pasuritë në pronësi apo në përdorim, të drejtat reale apo edhe burimet e krijimit të tyre, fakt i pranuar edhe prej vetë Komisionit në arsyetimin e tij.

**11.7** Prindërit e subjektit kanë fituar statusin e personit të lidhur me të vetëm me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, dhe vetëm pas këtij momenti atyre dhe subjektit u kanë lindur detyrime për të bërë deklarime për pasuritë e tyre dhe justifikimin e ligjshmërisë së krijimit të tyre, sipas modelit të shtojcës nr. 2 të këtij ligji.

**11.8** Fakti që subjekti i rivlerësimit ka bërë në DPV-të e plotësuara prej tij, deklarime lidhur me të ardhurat e prindërve të tij, apo për marrëdhënie të caktuara në të cilat prindërit kanë hyrë, siç është ajo e huamarrjes së babait të tij me motrat e subjektit, ndërsa siç u potencua më lart, nuk ishte një detyrim ligjor i tij, por vlerësohet se ka qenë një zgjedhje e subjektit për mënyrën dhe kufijtë e deklarimit përtej asaj që ligji e ngarkonte, nuk çmohet nga Kolegji si një rrethanë që duhet të trajtohet sipas prezumimit ligjor se ai ka deklaruar në këto deklarata çdo të drejtë pronësie apo detyrim të prindërve të tij sipas parashikimit ligjor për subjektet deklaruese. Subjekti ka zgjedhur/çmuar të japë në këto deklarata disa informacione që ai i ka vlerësuar të përshtatshme në funksion të prezantimit të situatës financiare të familjes së tij. Në vlerësimin e Kolegjit, fakti që ai nuk ka deklaruar në këto deklarata gjithçka që lidhet me pasuritë, të drejtat apo detyrimet e familjarëve të tij, sa kohë që ligji nuk e detyronte ta bënte këtë, nuk duhet të prezumojë të kundërtën, se këto pasuri nuk kanë ekzistuar dhe se subjekti nuk mund t'i provojë ato nëpërmjet dokumentacionit ligjor dhe në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 84/2016 që i ngarkon atij këtë barrë, për shkak të cilësisë si persona të lidhur që fitojnë prindërit e tij.

**11.9** Në këtë këndvështrim, Kolegji ndan një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, për sa i përket trajtimit të ekzistencës së likuiditeteve në *cash* të krijuara në vite nga prindërit e subjektit e të padeklaruara në DPV prej tij. Ndërsa Komisioni ka konkluduar se meqenëse subjekti ka deklaruar në këto DPV të ardhurat e prindërve, dhënien e huas të tretëve, por nuk ka deklaruar kursimet e tyre *cash* ndër vite, por as likuiditet në llogari bankare, këto kursime ai nuk mund t'i provojë me mënyra të tjera, Kolegji çmon se provueshmëria e këtyre likuiditeteve, do të duhet t'i nënshtrohet analizës së çdo të dhëne që vjen për to me deklaratën e pasurisë *vetting*, si edhe me provat bashkëlidhur saj, ashtu edhe nga provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, por edhe duke vlerësuar shpjegimet e subjektit. Standardi i përdorur nga Komisioni vlerësohet prej Kolegjit se i përket analizës që u bëhet likuiditeteve në *cash* të subjekteve deklaruese, të cilat kanë pasur detyrimin në vite të deklarojnë gjendjen e kursimeve të tyre në *cash*, si e vetmja mundësi për provueshmërinë e tyre, standard i konsoliduar tashmë edhe nga jurisprudenca e Kolegjit, i cili nuk mund të përdoret për subjekte që nuk kanë pasur detyrimin për deklarim, siç janë personat e lidhur të konsideruar të tillë vetëm nga ligji nr. 84/2016. Vërtetësia e deklarimeve të tyre për gjendjet e likuiditeteve në *cash*, do t'i nënshtrohet një procesi analize që do të duhet të konsiderojë çdo të dhënë që rezulton nga hetimi dhe në këtë drejtim, edhe të dhënat që vijnë nga DPV-të, në të cilat subjekti ka bërë deklarime në tejkalim të ligjit për pasuritë e tyre, do të shërbejnë për t'u analizuar së bashku me gjithë të dhënat e tjera që janë përfutur.

**11.10** Për sa më sipër, konstatohet se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë deklaruar çdo pasuri të paluajtshme të regjistruar në pronësi të tyre, gjendjet e llogarive bankare që ata dispononin në momentin e plotësimit të kësaj deklarate, si dhe huatë e dhëna prej tyre të cilat ishin ende të pashlyera. Lidhur me kursimet në *cash* në deklaratën *vetting*, ato janë identifikuar si kursime që i përkasin trungut familjar. Ndërsa të ardhurat e prindërve në vite, janë deklaruar si burim i krijimit të pasurive të deklaruara në këtë deklaratë, nën përgjegjësinë ligjore të parashikuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerëson se pikërisht këto deklarime të bëra rishtas prej personave të lidhur dhe pasuritë e deklaruara në to, janë objekt verifikimi dhe kontrolli në kuadër të procesit të rivlerësimit.

**11.11** Për sa u analizua më lart, në konkluzion të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, Kolegji konkludon se:

(i) Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pasuritë e prindërve nuk duhet të jenë objekt kontrolli në kuadër të procesit të tij të rivlerësimit, për sa kohë nuk provohet se ai ka pasur të drejta reale dhe interes pasuror në pasuritë e prindërve, sipas kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është i pabazuar ligjërisht dhe jo në përputhje me këtë situatë faktike që provon se subjekti ka pasur gjithmonë prindërit në të njëjtën gjendje të certifikatës së përbërjes familjare me të dhe, si të tillë, ata konsiderohen si persona të lidhur me të, sipas parashikimit të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016.

(ii) Prindërit, në cilësinë e personave të lidhur të subjektit të rivlerësimit, kanë detyrimin për deklarimin e të gjitha pasurive që disponojnë në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, si dhe të burimeve të financimit të tyre, dhe se verifikimi i mundësisë financiare të tyre për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, duhet të përfshijë edhe të ardhurat/kursimet në *cash* që nga analiza financiare rezultojnë si mundësi potenciale për t'u kursyer nga prindërit e subjektit, duke u bazuar në indikatorët financiarë, si të ardhurat e ligjshme që prindërit kanë pasur në dispozicion, mbulimi i kostove të jetesës, investimet e kryera dhe huatë e dhëna prej tyre.

**12** *Për pasurinë apartament me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të babait të tij, Kolegji mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se:*

(i) *Nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për një pronë të blerë nga babait i tij larg periudhës kur subjekti filloi detyrën e prokurorit, të financuar tërësisht me të ardhura të ligjshme të siguruara nga puna e të atit, të cilat nuk ka pasur detyrim t'i deklarojë në deklaratimet periodike të pasurisë, dhe që janë përlllogaritur në mënyrë jo të drejtë nga Komisioni.*

(ii) *Edhe pse nuk duhej kryer analiza për pasuri të krijuara nga prindërit para periudhës që subjekti të ushtronte detyrën, ai pretendon se kjo analizë është e pasaktë pasi nuk përfshin si të ardhura, vlerat reale që janë siguruar nga shitja e pasurive të paluajtshme të mëparshme të familjes.*

(iii) *Analiza ekonomike për burimet e financimit të kësaj pasurie është e pasaktë pasi në të nuk përfshihen të ardhurat që vetë subjekti ka siguruar nga puna në OSBE dhe IRC para ushtrimit të detyrës si prokuror.*

**12.1** Në vendimin e Komisionit, lidhur me pasurinë apartamenti me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}” në Tiranë, është konkluduar si vijon:

33.6. Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të babait të subjektit, të krijuar tri vite përpara se subjekti të fillonte detyrën, Komisioni vlerëson se pavarësisht faktit se subjekti nuk ka të drejta reale mbi këtë apartament, për sa kohë që babai i tij është person i lidhur, në kuptim të nenit 3/13 të ligjit nr. 84/2016, pasi bën pjesë në certifikatën familjare të tij, ai ka detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për blerjen e pasurisë apartament.

33.7. Për sa më sipër, subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament, si dhe nuk ka deklaruar saktë burimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. Si rrjedhojë, përpos nivelit të përgjegjshmërisë dhe të pasojave konkrete që mund të shkaktojnë problematikat e konstatuara në këtë pasuri, për shkak të faktit se ajo është krijuar përpara se subjekti të fillonte detyrën dhe mungesa e kontributit të tij financiar në krijimin e saj – si përfundim ka rezultuar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. [...]

79.1. Në përfundim, konstatohet se subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen pasurisë apartament me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Njësia nr. {\*\*\*}, Tiranë, në pronësi të babait të tij, si dhe nuk ka deklaruar saktë burimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie. [...]

**12.2** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*, përkatësisht: *Shtëpi banimi, apartament në adresën: Njësia nr. {\*\*\*}, në rr. “{\*\*\*}”, pall. “{\*\*\*}”, Sh. {\*\*\*}, K. {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*} Tiranë. Blerë në vitin 2004 nga të ardhurat e përbashkëta familjare, kryesisht të babait si noter dhe avokat, si dhe nga shitja e dy apartamenteve të tjera në Peshkopi dhe në Tiranë. Apartamenti ku aktualisht jeton e gjithë familja, është regjistruar në emër të babait P. M.. Vlera: 60.000 euro.*

**12.3** Komisioni, në kuadër të procesit të rivlerësimit, ka kontrolluar përveçse vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, edhe burimet e ligjshme të përcaktuara prej tij se janë përdorur për krijimin e saj. Pjesë e këtij kontrolli ka qenë edhe verifikimi i çmimit të blerjes së kësaj pasurie, i cili është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* 60.000 euro, ndërsa në kontratën e shitjes me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, nr. {\*\*\*} rep., e {\*\*\*} kol., datë 15.06.2010, rezultoi të jetë në vlerën prej 5.221.880 lekësh. Komisioni e ka ftuar subjektin të japë shpjegime për diferencën në çmimin e deklaruar nga ai i përcaktuar në kontratën e shitblerjes dhe, pasi subjekti ka shpjeguar se çmimi më i lartë i deklaruar prej tij përfaqëson vlerën e punimeve shtesë të kryera prej familjes së tij në apartament, përtej vlerës së paguar shoqërisë, ka vijuar me kontrollin e burimeve të deklaruara dhe ka kryer analizën financiare të njësive ekonomike familjare mbi çmimin prej 60.000 eurosh, të deklaruar nga vetë subjekti se ka përfaqësuar vlerën e shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie.

**12.4** Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, si dhe i akteve të hetimit administrativ, konstatohet se nga Komisioni, kontrolli i burimeve të financimit të pasurisë apartament banimi me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, të blerë në vitin 2004 nga babai i subjektit të rivlerësimit, është bërë duke ia nënshtruar analizës në funksion të identifikimit të mundësisë për të financuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie, të gjitha burimet e deklaruara prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat e krijuara nga babai dhe vetë subjekti,

të ardhurat e krijuara nga shitja e pasurive të blera para pasurisë objekt kontrolli, si edhe duke konsideruar edhe investimet e tjera që kanë rezultuar të kryera nga familja para periudhës së blerjes së kësaj pasurie. Në përfundim të kësaj analize, Komisioni ka konkluduar se babai i subjektit, *si person i lidhur*, nuk provon financimin e apartamentit me sip. 133,4 m<sup>2</sup> në Tiranë, me të ardhura të ligjshme.

**12.5** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim, përveç sa më sipër trajtuar lidhur me objektin e kontrollit të Komisionit, pretendim i cili u gjet i padrejtë prej Kolegjit, edhe analizën e kryer nga Komisioni për të ardhurat e krijuara prej babait të tij nga puna si avokat e noter, të cilat kanë shërbyer si burim kryesor për financimin e kësaj pasurie, duke pretenduar se nuk janë vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë provat që subjekti ka paraqitur për të provuar këto të ardhura.

**12.6** Në drejtim të kontrollit të vendimit të Komisionit sipas këtij shkak ankimi, Kolegji fillimisht konstaton se Komisioni ka trajtuar të ardhurat e babait të subjektit në mënyrë të përsëritur në vendim, duke i analizuar ato në cilësinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie dhe të pasurive të tjera të deklaruara se janë krijuar prej tyre, por edhe si një zë më vete në drejtim të kontrollit të vërtetësisë së deklarimeve të personit të lidhur, babait të subjektit. Kolegji vlerëson t'i analizojë këto të ardhura në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës dhe ligjshmërisë së tyre, në funksion të llogaritjes të tyre si burim për krijimin e pasurive të subjektit dhe personave të lidhur, duke konsideruar të panevojshëm dhe të paefektshëm për këtë gjykim, analizimin e tyre në mënyrë të përsëritur, sipas strukturës së vendimit të Komisionit. Ky qëndrim i Kolegjit lidhet me këndvështrimin se të ardhurat që deklarohen në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe DPV-të, duhet të provohen se janë krijuar në funksion të justifikimit me burime të ligjshme të pasurive të krijuara me to dhe përballimit të shpenzimeve. Pamundësia për të provuar krijimin e tyre apo standardin e të ardhurës së ligjshme sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nuk shoqërohet me konstatimin e veprimeve të qëllimshme për të rritur artificialisht të ardhurat e deklaruara, nuk është një konkluzion që ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në mënyrë autonome. Vetëm mungesa e provueshmërisë së një pjese të të ardhurave, e pashoqëruar me deklarime të rreme lidhur me to, pavarësisht faktit që përfaqëson një deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me kuadrin ligjor, në kuptim të parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të shërbejë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në rast se ai justifikon me të ardhurat e provuara si të ligjshme, krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve.

**12.7** Në logjikën e arsytimit të bëra më sipër, Kolegji kontrollon konkluzionet e Komisionit lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme të përdorura për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi, duke analizuar të ardhurat e pretenduara se janë krijuar nga puna e babait të tij, ato të krijuara nga shitja e pasurive të paluajtshme, ato të krijuara nga puna e subjektit në OSBE dhe IRC, si edhe kontrollon analizën e kryer nga Komisioni në konkluzion të përfundimeve për të ardhurat e përcaktuara si burim për krijimin e kësaj pasurie.

**12.8** Subjekti i rivlerësimit, referuar analizës së kryer nga Komisioni, ka kundërshtuar shifrat e pranuar se përfaqësojnë të ardhurat e babait të tij, duke pretenduar se për periudhën 1993-

1995, të ardhurat nga puna si avokat<sup>5</sup> e të atit, duhet të konsiderohen në masën 80.000 lekë/muaj (pasi, sipas tij, çdo mbrojtje në gjykatë duhet të konsiderohet në vlerën 4.000 lekë), dhe për periudhën 1997-2000 duhet të konsiderohet se qarkullimi vjetor ka qenë në masën 2.000.000 lekë, për të cilin korrespondon një masë fitimi prej 80% (1.600.000 lekë), ndërsa për vitin 1996 shuma e të ardhurave duhet të rezultojë në vlerën prej 1.466.667 lekësh.

**12.9** Kolegji, në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, konstaton se nga ana e Komisionit, për përlllogaritjen e fitimit të babait të subjektit për periudhën 1993-1995, kohë gjatë së cilës ai ka ushtruar profesionin e avokatit, janë marrë në konsideratë të dhënat e regjistratit të avokatisë, një dokument privat i mbajtur prej tij dhe i paraqitur si provë nga subjekti gjatë hetimit administrativ, për të provuar punët dhe të ardhurat e gjeneruara në këtë periudhë. Mbi bazën e këtij regjistri, Komisioni ka evidentuar numrin e çështjeve vjetore të ndjekura nga babai i subjektit si avokat. Nga regjistrat, rezulton se ka të dhëna për vitet 1992, 1993 dhe vitin 1994, ndërsa për vitin 1995 ky regjistër mungon. Për vitet për të cilat ka informacion, ka rezultuar se babai i subjektit ka ndjekur respektivisht në vitin 1992 – 52 çështje; në vitin 1993 – 615 çështje; në vitin 1994 – 557 çështje. Për vitin 1995, Kolegji vëren se, edhe pse nuk ka pasur të dhëna mbi numrin e çështjeve, nga ana e Komisionit ato janë konsideruar në një volum të barabartë me vitin 1994, prej 557 çështjesh të ndjekura.

**12.10** Nga ana e Komisionit, të dhënat e regjistrave janë vlerësuar në terma financiarë, mbështetur në çmimet e përcaktuara në dy dokumente të sjella nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ, të cilat janë përkatësisht: (i) aktmarrëveshja e datës 10.8.1994, e lidhur ndërmjet “{\*\*\*}” dhe avokatit të rrethit Dibër, z. P. M. (babai i subjektit) për ndjekjen në gjykatë të kërkesëpadive të dërguara nga ndërmarrja për personat që kanë dëmtuar kosheret e kësaj ndërmarrjeje në fshatin Zdojan në vitin 1992 deri në përfundimin e gjykimit të çështjeve. Për të gjithë shërbimin e avokatisë, do të paguhej një shumë prej 22.000 lekësh; (ii) aktmarrëveshja e datës 21.12.1994 ndërmjet Drejtorisë së {\*\*\*} Dibër dhe avokatit të rrethit Dibër, z. P. M., në të cilën përcaktohet se avokati do të shpërblehet në shumën 5.500 lekë, 500 lekë për aktpadinë dhe 5.000 lekë për ta ndjekur çështjen në gjyq dhe nëse lind nevoja, të bëjë ankimin e saj.

**12.11** Komisioni ka përdorur për të gjithë periudhën 1992-1996, çmimin 500 lekë për të vlerësuar hartimin e një akti, si dhe të njëjtin çmim për mbrojtjen e çështjeve në gjykatë. Këtë vlerë e ka shumëzuar me numrin e çështjeve që kanë rezultuar nga regjistrat dhe ka nxjerrë një shumatore të qarkullimit të realizuar për këto vite.

Nga qarkullimi i përlllogaritur, Komisioni ka konsideruar se 70% të tij kanë qenë fitime nga aktiviteti i avokatisë. Në total, sipas Komisionit, shuma e rezultuar si fitim për periudhën 1992-1995, ka qenë 1.246.700<sup>6</sup> lekë. Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore, Komisioni ka

---

<sup>5</sup> Subjekti i rivlerësimit shpjegon se i ati ka ushtruar profesionin e avokatisë në Peshkopi, nga data 27.08.1992 deri më datë 12.02.1996.

<sup>6</sup> Përlllogaritjet e bëra nga ana e Komisionit për të ardhurat e periudhës 1992-1995, është bërë duke konsideruar përkatësisht se babai i subjektit për çdo çështje ka përfituar 500 lekë për hartimin e akteve dhe 500 lekë për mbrojtjen në gjykatë, metodologji e cila, sipas Komisionit, i ka siguruar babait të subjektit të ardhura përkatësisht: (i) në vitin 1992, për 52 çështje, ka realizuar një qarkullim në masën 52.000 lekë, nga i cili ka marrë fitim në masën 70% të këtij qarkullimi, që i korrespondon vlerës prej 36.400 lekësh; (ii) në vitin 1993, për 615 çështje, ka realizuar një qarkullim në masën 615.000 lekë, nga i cili ka marrë fitim në masën 70% të këtij

prezumuar që ato janë paguar, për sa kohë subjekti ka depozituar një numër të konsiderueshëm aktesh juridike të përpiluara nga babai i tij në cilësinë e avokatit, si edhe për shkak se Drejtoria Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Dibër ka informuar se z. P. M. nuk ka detyrime të papaguara për periudhën 1992 - 2000, dhe se dokumentacioni për këtë periudhë është i dëmtuar.

**12.12** Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se çmimi prej 500 lekësh, i përdorur nga Komisioni për përlllogaritjen e të ardhurave nga shërbimet si avokat të babait të tij (*kryesisht ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen në gjykatë të çështjeve*) është tepër i ulët, pasi mesatarisht duke filluar që prej vitit 1992, këto shërbime, sipas subjektit, janë vlerësuar në masën 4.000 lekë, pasi kjo vlerë korrespondon saktësisht dhe me të ardhurat e deklaruara nga babai në deklaratën *vetting*, prej mesatarisht 80.000 lekësh në muaj ose 960.000 lekësh në vit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në regjistrin e avokatit të mbajtur nga babai i tij, janë pasqyruar vetëm çmimet e kërkesëpadive apo akteve të tjera dhe nuk janë shënuar të ardhurat/vlerat e siguruara për mbrojtjet ligjore, si dhe seancat përkatëse që janë ndjekur nga babai i tij në funksionin e avokatit, rrethanë e cila, sipas tij, tregojnë se përlllogaritjet e bëra nga Komisioni janë të cingëruara dhe nuk pasqyrojnë realitetin. Sipas subjektit të rivlerësimit, është alogjike të pretendohet që mbrojtja e një çështjeje, bashkë me përpilimin e kërkesëpadiës, të kushtojë në vlerën 500 lekë, qoftë kjo dhe në vitet 1992-1996. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nëse do të përlllogaritet një çështje në një vlerë mesatarisht 4.000 lekë, do të rezultonte se në vitin 1992 do të kishim një qarkullim rreth 208.000 lekë, për vitin 1993 në masën 2.460.000 lekë dhe për vitin 1994 në masën 2.228.000 lekë. Për vitin 1995, Komisioni në kushtet kur regjistri i avokatisë i mbajtur nga babai i subjektit, nuk ka pasur të dhëna edhe pse ai ka ushtruar profesionin, ka pranuar të njëjtin volum pune me atë të vitit 1994, për të cilin subjekti me të njëjtin arsyesim si për vitin 1994, konteston vlerën e identifikuar si qarkullim në këtë vit.

**12.13** Nga analizimi i akteve<sup>7</sup> mbi të cilat është bazuar Komisioni për llogaritjen e të ardhurave të periudhës 1992-1996, vërehet se çmimi për mbrojtjen e çështjeve në gjykatë është në vlerën 500 lekë. Gjithashtu, rezulton se subjekti, për sa u përket të ardhurave të babait të tij nga ushtrimi i profesionit të avokatit, pretendon se të ardhurat vjetore të tij prej avokatisë në çdo vit, janë maksimalisht në shumën 960.000 lekë ose 80.000 lekë në muaj. Në lidhje me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vëren se, nëse shumën e fitimit të pretenduar nga subjekti e pjesëtojmë me numrin e çështjeve që pasqyrohen si të ndjekura në regjistrat e avokatisë, rezulton se për çdo çështje, çmimi mesatar varion nga 2.230 lekë në 2.462 lekë, vlerë e cila është më e vogël se gjysma e vlerës prej 5.500 lekësh, të përcaktuar në marrëveshjen e datës 21.12.1994, ndërmjet Drejtorisë së {\*\*\*} Dibër dhe babait të subjektit, sipas të cilës: *[...] avokati do të shpërblehet në shumën 5.500 lekë, 500 lekë për aktpadinë dhe 5.000 lekë për ta ndjekur çështjen në gjykatë.* Ndërsa referuar çmimit të përdorur nga Komisioni për mbrojtjen

---

*qarkullimi, që i korrespondon vlerës prej 430.000 lekësh; (iii) në vitin 1994, për 557 çështje, ka realizuar një qarkullim në masën 557.000 lekë, nga i cili ka marrë fitim në masën 70% të këtij qarkullimi, që i korrespondon vlerës prej 389.900 lekësh; (iv) në vitin 1995, për 557 çështje, ka realizuar një qarkullim në masën 557.000 lekë, nga i cili ka marrë fitim në masën 70% të këtij qarkullimi, që i korrespondon vlerës prej 389.900 lekësh.*

<sup>7</sup> *Aktmarrëveshje, datë 21.12.1994, ndërmjet drejtorisë së {\*\*\*} Dibër dhe avokatit të rrethit Dibër, z. P. M., në të cilën përcaktohet se avokati do të shpërblehet në shumën 5.500 lekë, 500 lekë për aktpadinë dhe 5.000 lekë për ta ndjekur çështjen në gjyq dhe, nëse lind nevoja, të bëjë ankimin e saj.*

e çështjeve në gjykatë, prej 500 lekë/çështja, kjo vlerë rezulton të jetë 10 herë më e vogël se ajo e përcaktuar në aktmarrëveshjen e datës 21.12.1994 të referuar më sipër. Lidhur me tarifën e avokatisë së aplikuara në periudhën 1992-1996, nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.03.2021, e lëshuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, rezulton se tarifën e shërbimit të avokatisë kanë qenë të liberalizuara, pa asnjë kufizim dhe mbi bazën e marrëveshjes midis avokatit dhe klientit. Gjatë hetimit administrativ në Komision, është administruar edhe shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.08.1994, e përcjellë nga Ministria e Drejtësisë drejt Ministrisë së Financave, e titulluar “Miratim tarifash për kryerjen e shërbimeve noteriale”, për periudhën 1994-2000, në të cilën ka të dhëna mbi tarifën e përdorura përgjatë kësaj periudhe. Nga udhëzimi i siguruar prej kësaj korrespondence me Ministrinë e Drejtësisë të datës 11.08.1994, i cili miraton tarifën për shërbimin e noterisë, si dhe nga rregullorja nr. 2, datë 21.05.1996, “Përcaktimin e tarifave të shpërblimit tavan për ndihmën ligjore që japin avokatët”, rezulton se përfaqësimi në gjykatë i çështjeve ka pasur tarifën shumë më të lartë se pagesa 500 lekë, e pranuar dhe e përdorur nga Komisioni, në një kohë shumë të afërt me periudhën e marrë në analizë. Po ashtu edhe tarifën e miratuar për shërbimet e noterisë në vitin 1994, për hartime dhe vërtetime dokumentesh ishin shumë më të larta se kjo vlerë.

**12.14** Në analizë të të dhënave që u renditën më lart, Kolegji vlerëson se të ardhurat e siguruar nga aktiviteti si avokat i babait të subjektit për periudhën 1992-1996, kanë qenë më të larta se 500 lekë për çështje, të përlllogaritura nga Komisioni, shifër e cila përfaqëson një vlerë të ulët, edhe në konsideratë të kohës dhe vendit ku ushtrohej avokacia. Pavarësisht kësaj konsiderate, ndodhur në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë numrin e çështjeve që babai i tij ka përfaqësuar në këtë kohë në gjykatë, dhe as të ardhurat e përfituara rast pas rasti, Kolegji çmon se vlerat e pretenduara nga subjekti si të siguruar nga përfaqësimet në gjykatë që ka kryer si avokat babai i tij, ato nuk mund të përfshihen si të ardhura në analizën financiare, si të paprovuara, duke e lënë kështu të pandryshuar vlerën prej **1.246.700 lekësh**, të përlllogaritur nga Komisioni se përfaqëson të ardhurat e krijuara për periudhën **1992-1996**, nga puna e tij si avokat. Ky vlerësim gjithsesi u mbajt në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin e konkluzioneve të arritura pas shqyrtimit të ankimit për këtë pasuri.

**12.15** Analiza e mëtejshme e Kolegjit vijoi me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit lidhur me të ardhurat e krijuara prej babait të tij nga aktiviteti si noter, për periudhën **1996-1999**.

**12.16** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si jo të drejtë dhe të saktë analizën e kryer nga Komisioni<sup>8</sup> për këtë periudhë, duke pretenduar se në këto vite, duhet të konsiderohet se

---

<sup>8</sup> Komisioni ka përlllogaritur të ardhura për periudhën **1996-1997**, duke u mbështetur në regjistrat noterialë të babait, të vënë në dispozicion nga subjekti gjatë procesit, në të cilët kanë rezultuar shënime me shumat e paguara për çdo shërbim dhe mbi këto të dhëna, ka përcaktuar të ardhurat vjetore dhe fitimin korrespondues:

- Për vitin 1996, që fillon më datë 13.02.1996, nga verifikimi i të dhënave në regjistrat noterialë, janë regjistruar 3966 akte, nga të cilat 1188 janë me numër koleksioni dhe fitimi i përcaktuar nga Komisioni, i përlllogaritur sipas shumave të disponuara në regjistrat noterialë në lidhje me pagesat për shërbimet e kryera, është në shumën 1.140.580 lekë.
- Për vitin 1997, janë regjistruar 3229 akte, nga të cilat 920 janë me numër koleksioni dhe fitimi i përcaktuar nga Komisioni, i përlllogaritur sipas shumave të disponuara në regjistrat noterialë në lidhje me pagesat për shërbimet e kryera, është në shumën 664.054 lekë.

Përcaktimi i të ardhurave për vitet **1998-1999**, nga ana e Komisionit është bërë duke u mbështetur në tatimin e përcaktuar në fletënjoftimit tatimore, e mbi bazën e të cilave është përcaktuar qarkullimi vjetor e më pas fitimi.

qarkullimi vjetor ka qenë në masën 2.000.000 lekë, për të cilin korrespondon një masë fitimi prej 80% (1.600.000 lekë), ndërsa për vitin 1996, shuma e të ardhurave duhet të rezultojë në shumën 1.466.667 lekë, pasi aktiviteti i noterisë ka filluar më datë 13.02.1996. Subjekti i rivlerësimit pretendon që për periudhën 12 shkurt 1996 deri më 31 dhjetor 1999, të njihet fitimi për qarkullimin deri në 2.000.000 lekë/vit, me argumentin që numri i akteve të përpiluara çdo vit në periudhën 1996-1999, është pothuaj në të njëjtin nivel. Për vitet 1996 dhe 1997, për shkak të mungesës së dokumentacionit për të provuar xhiron e deklaruar dhe për të cilën janë paguar detyrimet tatimore, subjekti kërkon që të merret në konsideratë qarkullimi vjetor i vitit 1998, për të cilin ka arritur të sigurojë dokumentacion. Dokumentacioni ligjor i vendosur në dispozicion nga subjekti, vërteton faktin se për periudhën 1998-1999, qarkullimi vjetor është në masën 2.000.000 lekë dhe subjekti tatimor ka paguar tatim për këtë vlerë të qarkullimit vjetor.

**12.17** Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që lidhen me të ardhura e siguruar nga babai i tij prej aktivitetit si noter, Kolegji konstaton e analizon si vijon. Për vitet 1996 dhe 1997, Komisioni u është referuar të dhënave që gjenden në regjistrat noterialë të paraqitur prej subjektit, të cilët tregojnë për numrin e praktikave të kryera nga noteri (babai i subjekti) dhe shumat përkatëse të përfituara në këmbim të shërbimit të ofruar, duke përcaktuar në total, si të realizuar në këtë periudhë, shumën prej 1.140.580 lekësh në vitin 1996 dhe prej 664.054 lekësh në vitin 1997. Kolegji ka konsideruar të njëjtat vlera në analizën financiare të kryer, pasi ato rezultojnë të jenë të konfirmuara nga vetë shënimet e noterit dhe nuk rezulton që të ketë një akt apo të dhënë tjetër që i kundërshton ato, përveç pretendimeve të subjektit, që mbeten deklarative.

Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se qarkullimi në vitet 1996-1997, duhet të konsiderohet se i përket fashës nga 0 - 2.000.000 lekë, referuar ligjit të kohës nr. 7679, datë 03.03.1993, "Për tatimin mbi biznesin e vogël", në të cilin përcaktohet se personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse i nënshtrohen tatimit me *tarifa proporcionale* mbi të ardhurat që janë realizuar nga shitja e mallrave apo shërbimeve apo me *kuota fikse* sipas llojit të veprimtarive që ka ushtruar personi fizik, vlerësohet nga Kolegji si jo i drejtë. Përfshirja e aktivitetit të babait të tij në fashën e biznesit të vogël që realizon qarkullim nga 0 - 2.000.000 lekë, për efekt të përcaktimit të tarifës së tatimit që duhet të paguhet, nuk prezumon apriori se biznesi ka realizuar qarkullimin maksimal në secilin vit. Në mungesë të deklarimeve të babait të tij në organet tatimore në vitet 1996-1997, të dhënat që vijnë nga regjistrat noterialë, të cilët për më tepër janë paraqitur prej vetë subjektit, janë të vetmet që meritojnë të konsiderohen në kuptim të përcaktimit të vlerës së xhiros. Për këto arsye, edhe

- 
- Për vitin 1998, nga ana e Komisionit, është përcaktuar fitimi në shumën 1.120.000 lekë. Duket se Komisioni, qarkullimin e ka përlllogaritur mbështetur në vlerën e tatimit prej 56.0008 lekësh, të cilin e ka konsideruar që përfaqëson 4% të qarkullimit vjetor, përkatësisht në shumën 1.400.000 lekë, ka përlllogaritur fitimin në masën 80% të qarkullimit, në një shumë prej 1.120.000 lekësh. Referuar vitit 1998, në regjistrin e noterit rezultojnë 3333 akte, nga të cilat 665 janë me numër koleksioni.
  - Për vitin 1999, nga ana e Komisionit, është përcaktuar fitimi në masën 1.280.000 lekë. Duket se Komisioni, mbështetur në vlerën e tatimit fiks prej 40.000 lekësh, të cilin e ka konsideruar që përfaqëson qarkullimin vjetor përkatësisht në shumën 1.600.000 lekë, ka përcaktuar fitimin në masën 80% të qarkullimit, në një shumë prej 1.280.000 lekësh. Referuar vitit 1999, në regjistrin e noterit, rezultojnë 2989 akte, nga të cilat 587 janë me numër koleksioni.



Kolegji konfirmon në analizën e tij financiare të njëjtën vlerë të qarkullimit, siç ka pranuar edhe Komisioni për këto dy vite.

**12.18** Për vitet 1998 -1999, në funksion të shqyrtimit të shkaqeve ankimore, Kolegji analizoi të dhënat që vijnë nga organet tatimore, e që përcaktojnë vlerat e paguara prej babait të subjektit si tatim për qarkullimin e realizuar, për të përcaktuar masën e fitimit të realizuar prej tij në këto periudhë, në këndvështrim të legjislacionit tatimor në fuqi. Referuar ligjit të kohës, me nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar, përllogaritja e tatimit për aktivitete që qarkullojnë nga 0 - 2 milionë lekë, ku përfshihej aktiviteti i personit të lidhur, ishte e përcaktuar me kuota fikse, ndërsa për aktivitete me xhiro nga 2 - 5 milionë lekë/vit, tatimi përllogaritej në masën 4% të xhiros së deklaruar.

**(i)** Për vitin **1998**, për të ardhurat e krijuara nga personi i lidhur, subjektit ka dorëzuar gjatë hetimit administrativ “Fletë njoftim tatimi”, datë 05.02.1998, në të cilën është përllogaritur vlera e tatimit për t’u paguar, sipas përcaktimeve të ligjit të vitit 1993, neni 3, pika “ç”, në të cilin parashikohet se: *Specialistët, si: inxhinierë, mësues, veterinerë, financierë, agronomë etj., të kësaj natyre që aktivitetin e tyre e kryejnë në mënyrë të pavarur, taten me tarifa proporcionale mbi të ardhurat dhe masa e tatimit do të jetë 3 për qind.* Në këto kushte, përllogaritja e qarkullimit vjetor të aktivitetit të noterisë për noterin P. M., për vitin 1998, është përllogaritur duke konsideruar që shuma e tatimit të përcaktuar nga organet tatimore, prej 56.000 lekësh, përbën 3% të qarkullimit vjetor, që rezulton të jetë bazuar mbi këtë logjikë në vlerën prej 1.866.667 lekësh, dhe më pas fitimi në shumën 1.493.333 lekë, që përfaqëson masën 80% të qarkullimit vjetor të pranuar edhe nga Komisioni si një marzh fitimi për këtë lloj aktiviteti. Nga përllogaritja e kryer si më lart, në Kolegj ka rezultuar se analiza financiare e Komisionit ka qenë e gabuar për përcaktimin e fitimit të personit të lidhur për vitin 1998, dhe ajo duhet të korrektohet, nga 1.120.000 lekë në 1.493.333 lekë.

**(ii)** Për vitin **1999**, nga ana e Komisionit, qarkullimi i vitit 1999<sup>9</sup> për subjektin tatimor P. M. është përllogaritur duke marrë për bazë që vlera e tatimit përbën 4% të volumit të qarkullimit vjetor, si në rastin e një subjekti që qarkullon të ardhura në fashën 2 - 5 milionë lekë, sipas së cilës personi fizik ka realizuar qarkullim në shumën 1.600.000 lekë dhe një fitim të përllogaritur në masën 1.280.000 lekë (80% të qarkullimit vjetor). Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, Kolegji konstaton se për të ardhurat e babait si noter në vitin 1999, subjekti i rivlerësimit ka depozituar “Fletë njoftim tatimi”, të datës 26.04.1999, për pagesën e tatimit fiks prej 40.000 lekësh, për fashën 0 - 2 milionë lekë. Nisur nga kjo e dhënë, Kolegji e gjen të gabuar mënyrën e përdorur prej Komisionit për përcaktimin e qarkullimit dhe më pas fitimit të aktivitetit, sikur ai të ishte një aktiviteti që krijon të ardhura në fashën 2 - 5 milionë lekë, ndërsa provohet se aktiviteti sërish ka vijuar të kryhet brenda së njëjtës fashë tatimore, asaj të biznesit të vogël, me një qarkullim prej 0 - 2 milionë lekë. Për vitin 1999, në analizën financiare të Kolegjit, fitimi i konsideruar do të jetë në shumën

---

<sup>9</sup> Në vitin 1999, legjislacioni i aplikueshëm për tatimin e aktivitetet e noterisë nuk është ligji nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, në të cilin përcaktohet se personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse, i nënshtrohen tatimit me tarifa proporcionale mbi të ardhurat e realizuara, por aplikohet ligji nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar, sipas të cilit përllogaritja e tatimit për aktivitete që qarkullojnë nga 0-2 milionë lekë, ishte e përcaktuar me kuota fikse.

1.600.000 lekë, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, pasi babai i tij si subjekt tatimor, mbështetur në “Fletë njoftimin për tatimin”, i përket fashës tatimore nga 0 - 2 milionë lekë.

**(iii)** Në total, për vitet 1996-1999, periudhë gjatë së cilës babai i subjektit ka ushtruar aktivitetin si noter në Dibër, nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se të ardhurat e tij të ligjshme që do të shërbejnë si burim për krijimin e pasurive të analizuara, do të jenë në masën prej (+) 2.945.960 lekësh, në ndryshim nga vlera prej (+) 1.879.294 lekësh, e konsideruar prej Komisionit. Pjesa tjetër e të ardhurave të krijuara prej babait të subjektit, për vitet 2000-2005, do të përlllogaritet nga Kolegji në të njëjtat vlera si Komisioni, të cilat janë të pranuar dhe të pakontestuara nga subjekti i rivlerësimit në ankim.

**12.19** *Burimi tjetër i përcaktuar prej subjektit se ka shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, u përket të ardhurave të realizuara nga shitja e pasurive të tjera të paluajtshme që kanë pasur në pronësi prindërit e subjektit të rivlerësimit, përkatësisht: (i) të apartamentit në Peshkopi, të cilin familja e subjektit të rivlerësimit e ka përfituar në vitin 1993 nëpërmjet privatizimit nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”); (ii) të apartamentit tjetër që babai i subjektit ka blerë në Tiranë, po në rrugën “{\*\*\*}”, te kullat “{\*\*\*}”, me sip. 79 m<sup>2</sup>, të prenotuar prej tij në vitin 1998.*

**12.20** Kolegji konstaton se për të ardhurat e siguruara nga shitja e apartamentit në Peshkopi, në fashikullin e hetimit administrativ janë administruar aktet: **(i)** aktmarrëveshja e datës 10.6.2004, lidhur ndërmjet babait të subjektit dhe z. B. S. për shitjen e apartamentit në shumën 2.500.000 lekë, në të cilën specifikohet se në datën e nënshkrimit të saj, do të jepej si kapar shuma 200.000 lekë, dhe ndërkohë shuma tjetër do të paguhej kur të bëhej akti noterial sipas Kodit Civil; **(ii)** akti noterial “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme apartament”, me nr. {\*\*\*} rep., e nr {\*\*\*} kol., të datës 05.07.2005<sup>10</sup>, me palë shitëse P., M., M., A. dhe B. M., e palë blerëse shtetasit G. dhe F. S., me objekt shitblerjen e apartamentit me sip. 76 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Peshkopi, në të cilën specifikohet se pala shitëse ia kalon në pronësi palës blerëse apartamentin për shumën 1.000.000 lekë.

**12.21** Lidhur me apartamentin e ndodhur në Peshkopi, Kolegji konstaton se është verifikuar nga Komisioni, edhe mënyra e përfitimit të tij nga familja e subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se ajo ishte përfituar në vitin 1993, nëpërmjet privatizimit nga EKB-ja, në shumën 16.525 lekë. Nga analiza e kryer si në Komision, ashtu edhe në Kolegj, rezulton se familja e subjektit të rivlerësimit kishte mundësi të krijonte shumën e shpenzuar për privatizimin e këtij apartamenti.

**12.22** Me ankimin, ashtu siç ka pretenduar edhe në Komision<sup>11</sup>, subjekti i rivlerësimit kërkon që në analizën financiare, si e ardhur nga shitja e apartamentit të Peshkopisë, duhet të njihet

<sup>10</sup> E cila i është vënë në dispozicion Komisionit nga ASHK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.07.2005.

<sup>11</sup> Referuar mospërputhjes me çmimin e shitjes së ap. prej 1.000.0000 lekësh dhe vlerës së përcaktuar në aktmarrëveshje, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga Komisioni dhe në përgjigje të pyetësorit datë 1.6.2020 dhe datë 9.12.2020, ka sqaruar se me shitjen dhe përgatitjen e dokumentacionit, është marrë babai dhe, sipas deklarimeve të tij, apartamenti në Peshkopi është shitur për shumën 2.500.000 lekë. Fillimisht është lidhur aktmarrëveshja me shtetasin B. S., i cili ka paguar në datën 8.9.2005, shumën 2.300.000 lekë, të cilën babai e ka depozituar në llogarinë bankare në BKT, në emër të bashkëshortes, znj. M. M.. Pas shlyerjes së çmimit të blerjes,

shuma prej 2.500.000 lekësh, e përcaktuar në aktmarrëveshjen e datës 10.6.2004, lidhur ndërmjet babait të subjektit dhe blerësit, z. B. S., dhe jo vlera prej 1.000.000 lekësh, e cila rezulton të jetë përcaktuar në kontratën e shitblerjes, pasi përfitimi i shumës 2.300.000 lekë provohet nga depozitimi i kësaj shifre në bankë nga babai i tij, me përshkrimin si *të ardhura nga shitja e apartamentit*.

**12.23** Kolegji vlerëson si të pabazuar në fakte këtë pretendim të subjektit, pasi, siç u përshkrua më sipër, akti noterial i kalimit të pronësisë mbi këtë pasuri me nr. {\*\*\*} rep., e nr {\*\*\*} kol., i datës 05.07.2005, i lidhur mes bashkëpronarëve si shitës, përfshi edhe subjektin, te pronarët e rinj si blerës, ka përcaktuar si çmim të shitjes së tij vlerën prej 1.000.000 lekësh, për pasojë pretendimi se shitja është kryer me çmimin e dakordësuar me aktmarrëveshjen pararendëse të aktit të kalimit të apartamentit në pronësi, mbetet një pretendim i paprovuar. Ndonëse në aktmarrëveshjen e datës 10.06.2004, të lidhur mes babait të subjektit dhe z. B. S.<sup>12</sup>, përcaktohet se çmimi i shitjes së këtij apartamenti do të jetë 2.500.000 lekë, dhe shitja rezulton të ketë ndodhur mes palëve të projektuara në këtë aktmarrëveshje, përfshi në konsiderim edhe faktin se në llogarinë bankare të nënës së subjektit, është depozituar në datën 08.09.2005, shuma 2.300.000 lekë, me përshkrim të ardhura nga shitja, tregojnë se me shumë gjasa, familja ka përfituar nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2005, vlerën e pretenduar prej subjektit, e cila duket se është një vlerë e arsyeshme për shitjen e një pasurie të paluajtshme, sërish, fakti që në aktin noterial të kalimit të pronësisë, është përcaktuar si çmim i shitjes vetëm shuma prej 1.000.000 lekësh, mbi të cilën rezulton se janë paguar edhe detyrimet tatimore, e përjashton gjithsesi konsiderimin e të gjithë shumës prej 2.500.000 lekësh, si të ardhur të ligjshme.

**12.24** Në përfundim të sa më sipër, në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji konkludon se nga shitja e apartamentit të familjes Maksuti në Peshkopi, vetëm shuma prej 1.000.000 lekësh plotëson kushtet për t'u konsideruar si e ardhur e ligjshme dhe, për pasojë, përfshirja e vetëm kësaj vlere si e ardhur në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni, është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

**12.25** *Në vijim, në drejtim të identifikimit të burimeve të financimit të apartamentin me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, Kolegji mori në analizë edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat ai konsideron si jo të sakta vlerat e përfshira në analizën e Komisionit si të përfituara nga shitja e apartamentit të kullat “{\*\*\*}” në Tiranë, në vitin 2005. Për këtë pasuri, Kolegji u ndal në shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, që kanë të bëjnë me identifikimin e vlerave që duhet të përfshihen në analizën ekonomike si të ardhura nga*

---

*u nënshkrua kontrata e shitblerjes. Në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjes nga z B. S., subjekti ka pretenduar se nuk mund të japë shpjegime të tjera, pasi i ati ka ndërruar jetë në datën 8.8.2020. Subjekti ka deklaruar se nga sa ka dijeni, shtetasit B. dhe G. janë vëllezër dhe me sa kupton, marrëveshjen e ka bërë shtetasi B. për llogari të vëllait të tij, ndërsa blerjen e ka bërë shtetasi G. S.. Komisioni, pasi ka analizuar shpjegimet e subjektit, pavarësisht faktit që me shitjen e kësaj pasurie mund të jetë marrë babai i tij, ka vlerësuar se ato nuk janë bindëse dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare ka përfshirë vetëm shumën 1.000.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes. Rezulton se edhe detyrimet tatimore janë paguar për shumën e përcaktuar në kontratën e shitjes.*

<sup>12</sup> *Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se nga sa ka dijeni, shtetasit B. dhe G. janë vëllezër dhe, me sa kupton, marrëveshjen e ka bërë shtetasi B. për llogari të vëllait të tij, ndërsa blerjen e ka bërë shtetasi G. S..*

shitja e kësaj prone, por edhe me kontrollin dhe verifikimin e mundësisë së familjes Maksuti për të financuar me të ardhura të ligjshme blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme në vitin 1998.

**12.26** Lidhur me këtë pasuri, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Në vitin 1998, është prenotuar një shtëpi në Tiranë, në rrugën “{\*\*\*}”, kullat “{\*\*\*}”, me sip. 79 m<sup>2</sup>, i cili ka kushtuar 23.000 USD. Kjo pasuri, e regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit, është shitur në vitin 2005 në vlerën e blerjes. Në kontratën e shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.6.2005, është pasqyruar vetëm kësti i fundit, në shumën 1.900.000 lekë, por apartamenti realisht është shitur në vlerën 23.000 USD.*

**12.27** Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka konstatuar fillimisht se ekzistojnë mospërputhje midis çmimit të blerjes së apartamentit në vitin 1998, i cili, sipas kontratës së blerjes, rezulton të jetë 19.000 USD dhe, sipas deklaratës së subjektit, rezulton të jetë 23.000 USD. Mbi kërkimin e Komisionit për sqarime rreth këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vlera e pagesës për apartamentin me sip. 79 m<sup>2</sup>, tek kullat “{\*\*\*}” në Tiranë, ka qenë 19.000 USD për karabinanë dhe 4.000 USD janë paguar për punimet shtesë për apartamentin. Në këto kushte, Komisioni, në analizën ekonomike, ka përfshirë si shpenzim të blerjes së këtij apartamentit, vlerën 23.000 USD. Ndërsa, për sa i përket vlerës së shitjes së kësaj pasurie, Komisioni ka përfshirë në analizën ekonomike si të ardhur, vlerën prej 1.900.000 lekësh, e cila, sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., të datës 24.06.2005, është shuma e përcaktuar si vlera e shitjes së këtij apartamenti.

**12.28** Nisur nga kjo situatë faktike, Kolegji, ashtu siç ka arsyetuar më lart për vlerën e shitjes së apartamentit në Peshkopi nga familja Maksuti, edhe në këtë rast konsideron se me të drejtë Komisioni ka përfshirë si të ardhur nga shitja e kësaj pasurie, vetëm vlerën prej 1.900.000 lekësh, e cila në kontratën e shitjes së datës 04.06.2005, është përcaktuar si çmim i shitjes së saj, mbi të cilën janë paguar edhe detyrimet tatimore. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji konstaton se pretendimi i subjektit se kjo pasuri është shitur në shumën 23.000 USD, mbetet një pretendim deklarativ i pambështetur në akte të kohës, pavarësisht arsyetimit që mbështetet nga logjika e thjeshtë ekonomike, e cila ka shoqëruar përgjithësisht zhvillimin e tregut të pasurive të paluajtshme dhe ka diktuar më së shumti shitjen të këtyre pasurive me çmime më të larta se ato të blerjes.

**12.29** Në përfundim, Kolegji konkludon se vlerat e përfshira në analizën ekonomike të Komisionit, që kanë të bëjnë me kostot e blerjes së apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> të kullat “{\*\*\*}” në Tiranë, si dhe vlerën e përfituar nga shitja e tij, janë të sakta dhe të mbështetura në akte provuese. Për pasojë, pretendimin e subjektit, me të cilin ai kërkon të përfshihen të ardhura nga shitja e kësaj pasurie në një vlerë më të lartë se ajo e përfshirë në analizën e Komisionit, Kolegji e konsideron një pretendim të pambështetur në prova.

**12.30** Lidhur me apartamentin me sip. 79 m<sup>2</sup> të kullat “{\*\*\*}” në Tiranë, Kolegji kontrollon edhe analizën e kryer nga Komisioni për mundësinë e familjes së subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e këtij apartamenti. Lidhur me këtë moment, rezulton se Komisioni, pasi ka marrë në analizë edhe dokumentacionin që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë hetimit administrativ për të provuar të ardhurat e ligjshme të familjes së tij në vitet 1998-1999-2000, ka konkluduar se familja e subjektit të rivlerësimit: **(i) në vitin 1998**

*nuk ka pasur mundësitë për kursime kumulative në shumën (-) 491.657 lekë; (ii) në vitin 1999 ka pasur mundësi për kursime kumulative në shumën 1.879.293 lekë; (iii) në vitin 2000 nuk ka pasur mundësi për kursime kumulative në shumën (-) 657.033 lekë. Pavarësisht këtyre rezultateve, nga ana e Komisionit, është vlerësuar se ato nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për shkarkim, me arsyetimin se: (i) të ardhurat e babait të subjektit mund të kenë qenë me të larta sesa janë llogaritur; (ii) shpenzimet familjare mund të kenë qenë më të vogla meqenëse kanë jetuar në Dibër; si dhe (iii) duhet konsideruar fakti që subjekti ka qenë student në momentin e blerjes së apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> në Tiranë.*

**12.31** Në funksion të verifikimit të mundësisë së familjes së subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme pasuritë e krijuara ndër vite, Kolegji kreu analizën financiare për të identifikuar mundësinë për kursim të kësaj familjeje në vitet 1996-2000, që ka shërbyer për financimin e apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> te kullat “{\*\*\*}” në Tiranë. Në këtë analizë, e cila u krye mbi kontrollin e analizës së kryer prej Komisionit, u reflektuan konkluzionet e arritura më sipër lidhur me të ardhurat e krijuara nga puna e babait të subjektit si avokat e noter në periudhën 1996-1999. Analiza shtrihet ashtu siç e ka ndërtuar edhe Komisioni për periudhën 1998-2000, duke qenë se subjekti ka deklaruar se një pjesë të investimit mbi këtë pasuri, në vlerën prej 570.560 lekësh, ai e ka kryer në vitin 2000. Kolegji përfshiu në këtë analizë, si të ardhura nga aktivitetet e babait të subjektit, vlerat për të cilat ai kishte paguar detyrimet tatimore për veprimtaritë si avokat dhe si noter, të ardhurat nga pensioni i nënës dhe motrës së subjektit, asokohe pjesë e trungut familjar, si dhe të ardhurat nga shitja e pasurisë të paluajtshme (banesës në Peshkopi) në vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes. Në këtë analizë janë përfshirë si shpenzime të familjes Maksuti, blerja e apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> te kullat “{\*\*\*}” në Tiranë, dhënia hua motrës së subjektit A. Ç. në shumën 3.314.250 lekë, e cila ishte pozicionuar si e tillë edhe në analizën ekonomike të Komisionit, shpenzimet për ndërtimin e lokalit, 1 kat me sip. 80 m<sup>2</sup>, në Peshkopi, në shumën 1.108.065 lekë, si dhe shpenzimet e jetesës për një familje me 4 persona (subjekti i rivlerësimit, motra M. dhe prindërit e tij). Nga analiza e kryer në Kolegj sipas metodologjisë së mësipërme, familja e subjektit të rivlerësimit rezulton me diferencë pozitive të mbulimit të investimeve/shpenzimeve me të ardhura të ligjshme në vitin 1998, në masën (+) 255.010 lekë; në vitin 1999, në masën (+2.945.960 lekë); dhe në vitin 2000, në shumën (+) 89.633 lekë. Ndryshimi i këtij rezultati me atë të nxjerrë nga Komisioni i dedikohet njohjes si të ardhura të ligjshme në vlera më të larta se ato të njohura nga Komisioni, të gjeneruara nga aktiviteti i babait të subjektit si noter në vitet 1998 dhe 1999, të arsyetuara në paragrafin 12.18 të këtij vendimi.

**12.32** Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin se familja e subjektit të rivlerësimit kishte mundësi për të financuar me burime të ligjshme blerjen e apartamentit me sip. 79 m<sup>2</sup> në kullat “{\*\*\*}”, në Tiranë.

**12.33** Në drejtim të burimeve të financimit të apartamentit 133,4 m<sup>2</sup> në Tiranë, Kolegji mori në analizë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të Komisionit nuk janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga paga e vetë subjektit nga punësimi pranë Misionit të Monitorimit të Komunitetit Evropian [European Community Monitor Mission ECMM (në vijim “ECMM”)] dhe nga angazhimi i tij si përkthyes me zyrën e International Rescue Committee [ në vijim “IRC”], në Peshkopi.

**12.34** Në vendimin e Komisionit lidhur me këto të ardhura të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, është konkluduar se: [...] *Nuk mund të përfshijë në analizën financiare një shumë të caktuar të ardhurash, për sa kohë nuk provohet vlera e pagave të përfituara nga subjekti nga punësimi pranë ECMM dhe nga angazhimi i tij me zyrën e IRC në Peshkopi, si dhe nuk ka asnjë të dhënë/referencë për pagat.*

**12.35** Kolegji konstaton se përgjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit për të provuar marrëdhënien e punës, ka depozituar aktet, si: (i) letër rekomandimi, datë 17.8.2000, në gjuhën angleze (përkthyer dhe noterizuar) të Misionit të Monitorimit të Komunitetit Evropian (ECMM), sipas së cilës subjekti ka punuar si përkthyes pranë kësaj organizate nga tetori i vitit 1999 (pa përcaktuar deri kur e ka kryer këtë funksion); (ii) letërkëmbim me prezencën e Bashkimit Evropian në Shqipëri, nga ku rezulton se pasi i është kërkuar informacion shtesë në lidhje me punësimin e subjektit në ECMM, Zyra e Bashkimit Evropian është përgjigjur duke sqaruar se: *Misioni ka qenë i pranishëm në Shqipëri pas nënshkrimit të marrëveshjes zyrtare më datë 23.03.2003*; (iii) letër reference, datë 2.6.2001, e Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit (IRC), sipas së cilës rezulton se subjekti ka punuar si përkthyes për periudhën 1.2.2001 - 23.7.2001; (iv) subjekti pretendon se pagesat gjatë angazhimit në ECMM - Zyra në Tiranë, kanë qenë rreth 700 USD/muaj dhe IRC - zyra Peshkopi, kanë qenë rreth 1.200 USD/muaj.

**12.36** Në ankim, për këto të ardhura, subjekti pretendon se për shkak të kohës së largët që ka kaluar, mbylljes së këtyre misioneve dhe largimit të personave që kanë qenë të punësuar në atë periudhë, gjendet në pamundësi objektive për të gjetur të dhëna të tjera që vërtetojnë marrëdhënien e punësimit dhe kërkon të trajtohet pamundësia e sigurimit të dokumentacionit për pagimin e detyrimeve tatimore që vjen nga marrëdhënia e punës, duke konsideruar se gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**12.37** Nga analizimi i informacionit që japin aktet e mësipërme të administruara në fashikullin e hetimit administrativ për punësimin e subjektit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se marrëdhënia e punës së subjektit pranë Misionit të Monitorimit të Komunitetit Evropian, si edhe punësimi pranë Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit për periudhën 01.02.2001 - 23.07.2001, provohet nga aktet e sipërcituara, të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, por vëren se mbetet e paprovuar shuma e të ardhurave të përfituara prej subjektit nga ky punësim, si dhe shlyerja e detyrimeve tatimore në lidhje me këto të ardhura. Në kushtet kur sipas parashikimit të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës në procesin e rivlerësimit dhe ai nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhurat e përfituara e të pretenduara prej tij, zbatimi i nenit 32, pika 2 e ligjit, për të provuar të gjitha elementet e një marrëdhënieje, nuk gjendet relevant. Në rastin konkret, përveç se mungon kontrata e punësimit/angazhimit si përkthyes të subjektit, e cila do të kishte të përcaktuar pagën që do të përfitonte subjekti si ofrues i shërbimit, si dhe përcaktimin e personit përgjegjës për pagimin e detyrimeve tatimore, mungojnë edhe të dhëna apo fakte të tjera që në mënyrë qoftë edhe të tërthortë, provojnë apo mbështesin deklaratimet e subjektit lidhur me të ardhurat e siguruar nga punësimi si përkthyes. Në këto kushte, Kolegji çmon se shpjegimi i subjektit se gjendet në pamundësi për shkak të kohës së largët, që të disponojë dokumentacionin që provon të ardhurat e siguruar nga punësimi i tij në misionin ECMM, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore, nuk është një pretendim i drejtë, për sa kohë që vetë përmbajtja e nenit 32, pika 2

parashikon vendosjen në kushtet e zbatimit të kësaj dispozite për të tjera rrethana, si zhdukja e dokumentacionit, pamundësia për ta gjetur dokumentin, që në thelb tregojnë se duhet të ketë mjaftueshëm të dhëna që dokumenti ka ekzistuar, por që nuk gjendet për shkaqe që nuk varen nga subjekti. Koha e largët nuk është një element i mjaftueshëm për të aplikuar nenin e sipërcituar.

**12.38** Për pasojë, Kolegji çmon se subjekti, për të ardhurat e pretenduara si të siguruara nga angazhimi i tij si përkthyes në Misionin e Monitorimit të Komunitetit Evropian, si edhe nga punësimi pranë Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit për periudhën 01.02.2001 - 23.07.2001, e të shlyerjes së detyrimeve tatimore lidhur me to, nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia/barra e provës që ka në funksion të këtij procesi, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

**12.39** Në këto kushte, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, çmon se të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga subjekti nga angazhimet e tij si përkthyes në vitin 2001, edhe pse janë të deklaruara në deklaratimet periodike të pasurisë dhe atë *vetting*, mbeten të ardhura të paprovuara, në nivel deklarativ, pasi subjekti për to nuk mundi të provojë me dokumentacion provues as kohën e krijimit, as pagesën e siguruar dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore lidhur me to. Për rrjedhojë, këto të ardhura do të konsiderohen se nuk plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, duke konfirmuar se ato me të drejtë nuk janë përfshirë si të ardhura në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

**12.40** Në përfundim të kontrollit të vendimit të Komisionit lidhur me të ardhurat që subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, Kolegji reflektoi në këtë analizë vetëm konkluzionet e ndryshme që u trajtuan më sipër dhe që lidheshin me të ardhurat e krijuara nga babai i subjektit në vitet 1998-1999 nga aktiviteti i tij si noter, pa ndërhyrë në të dhënat e tjera të analizës financiare të kryer nga Komisioni. Në konkluzion të analizës së kryer, rezultoi një balancë negative në vitet 2004-2005, në një vlerë prej (-) 2.386.496 lekësh, në ndryshim nga vlera prej (-) 3.133.162 lekësh e konkluduar prej Komisionit, balancë e cila konsiderohet se e vendos personin e lidhur, si titullari i së drejtës të pronësisë së këtij apartamenti, dhe subjektin e rivlerësimit në kushtet e mungesës të burimeve të ligjshme për financimin e apartamentit, investimeve të tjera, si edhe përballimin e shpenzimeve të kryera për këtë periudhë.

**12.41** *Në përfundim, për pasurinë apartament me sip. 133,4 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në pronësi të babait të tij,* Kolegji konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk arritën të provonin se kishin të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar plotësisht krijimin e kësaj pasurie në vitet 2004 dhe 2005, për një balancë negative prej 2.386.496 lekësh, situatë që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 13** *Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me pasuritë automjet Mercedes Benz 250 D dhe Mercedes Benz 270 D, sipas të cilave konkluzionet e Komisionit janë të padrejta e jo të bazuara ligjërisht, pasi: (i) nuk është vlerësuar drejt mënyra e fitimit të pronësisë mbi automjetin Mercedes Benz 250 D, të cilin nuk ka pasur detyrim ta deklarojë në deklaratën “vetting”; (ii) mospërfshirja në analizën financiare e vlerës së shitjes së këtij*

automjeti (në shumën 700.000 lekë), është e pabazuar, pasi ligji i aplikueshëm nuk parashikonte pagimin e tatimit për shitblerjet e automjeteve, dhe se në funksion të një analize sa më të plotë e të drejtë, duhet konsideruar se vlera e shitjes përfshin edhe shumat që subjekti ka investuar ndër vite për mirëmbajtjen e mjetit dhe nuk përfaqëson fitim të realizuar nga shitblerja e tij; (iii) shuma 700.000 lekë, e siguruar nga shitja e automjetit Mercedes Benz 250 D, duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm financimi për blerjen e automjetit tjetër Mercedes Benz 270 D në vitin 2009.

**13.1** Kolegji konstaton se në vendimin e Komisionit lidhur me automjetin “Mercedes Benz 250 D”, është konkluduar sa vijon:

*Shpjegimet e subjektit në lidhje me kontratën e dhurimit, ndonëse mund të jenë reale, ato nuk mbështeten në prova. Subjekti pretendon se ai e ka blerë automjetin, por nuk ka depozituar asnjë dokument për të provuar këtë deklaram të tij. Për më tepër, subjekti ka pasur të gjitha mundësitë për të sqaruar këtë situatë në deklaratën “vetting”, po ashtu mund ta sqaronte edhe kur është pyetur nga Komisioni, por nuk e ka deklaruar asnjëherë faktin që ky automjet ishte përfituar me kontratë dhurimi. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasqyruar saktë në deklaratën “vetting” mënyrën e fitimit të pasurisë, tip “Mercedes Benz 250 D”, pasi rezulton se ky automjet i është dhuruar dhe jo blerë prej tij. Në analizën financiare nuk do të përfshihet shuma e pretenduar si e përfituar nga shitja e automjetit në vlerën 700.000 lekë, pasi nuk rezulton që subjekti të ketë paguar detyrimet tatimore. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**13.2** Lidhur me pasurinë automjet “Mercedes Benz 250 D”, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratat e deklarimit të pasurisë ndër vite, ka deklaruar si vijon:

**i.** Në deklaratën vetting: *Blerë<sup>13</sup> në datën 19.9.2001, vit prodhimi 1988. Kontrata është bërë për shumën 450.000 lekë, pasi nuk është përfshirë zhdoganimi në shumën 157.525 lekë dhe shpenzimet për riparim. Automjeti është shitur në datën 21.2.2009, në shumën 700.000 lekë, pasi iu bë remont total dhe në kohën e shitjes, taksa doganore ka qenë e lartë. Kopje e kontratës së shitjes në Itali dhe vërtetimi i zhdoganimit. Shuma e blerjes: 450.000 lekë. Shitur në shumën 700.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi sipas deklaratës “vetting”: Blerë me të ardhurat e babait dhe të subjektit.*

**ii.** Në DVP-në e vitit 2003, të plotësuar nga subjekti në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore (në vijim “OPGj”), ka deklaruar: *Automjet, tip “Mercedes Benz”, në vlerën 800.000 lekë, me të ardhura nga puna dhe prindërit.*

**iii.** Në DVP-në e vitit 2004, të plotësuar sërish nga subjekti në cilësinë e OPGj-së, ka deklaruar: *Automjet, tip “Mercedes Benz” i vitit 1988, me targa {\*\*\*}, blerë nga shtetasi P. L., në vlerën 450.000 lekë, në shtator të vitit 2001.*

---

<sup>13</sup> Subjekti ka depozituar dokumentet: (i) kontratë shitjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.2.2009, në të cilën Bledar Maksuti rezulton në cilësinë e palës shitëse dhe B. P. në cilësinë e palës blerëse. Sipas kësaj kontrate, ky automjet është shitur në vlerën 700.000 lekë; dhe (ii) vërtetim zhdoganimi + deklaratë doganore.



iv. Në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2008<sup>14</sup>, e cila është deklarimi fillestar i subjektit të rivlerësimit në funksionin si prokuror, ka deklaruar: *Automjet “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1988, blerë në vitin 2001. Burimi: nga të ardhurat personale si asistent i zyrës rajonale të OSBE-së dhe EUMM; pjesa takuese: 100%.*

v. Në DVP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *Autoveturë “Mercedes Benz”, vit prodhimi 1988, blerë në vitin 2001; vlera: 800.000 lekë; Burimi: nga të ardhurat personale, nga puna si asistent i zyrës rajonale të OSBE-së dhe EUMM; pjesa takuese: 100%.*

13.3 Nga Komisioni është administruar edhe praktika e përcjellë nga DPSHTRR<sup>15</sup> me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.12.2020, për automjetin “Mercedes Benz 250 D”<sup>16</sup>, me vit të prodhimit 1988, për të cilin rezulton se subjekti i rivlerësimit ka fituar pronësinë mbi bazën e kontratës së dhurimit, të lidhur më datë 19.09.2001, e nënshkruar ndërmjet palëve, përkatësisht dhuruesit P. L. dhe subjektit të rivlerësimit Bledar Maksuti, si pranues i dhurimit. Për këtë kontratë dhurimi, nga noteri I. K., Peshkopi, është lëshuar vërtetim nënshkrimi me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., më datë 27.09.2001.

13.4 Lidhur me këtë pasuri, në procesverbalin e datës 25.3.2009, të mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka shpjeguar se kjo autoveturë është blerë në vitin 2001, në shumën 450.000 lekë dhe është shitur në vitin 2009, në shumën 700.000 lekë. Si burim për krijimin e këtij automjeti, ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e tij nga pagat në vitet 1999 - 2001 nga puna në UNHCR dhe nga puna pranë Misionit Vëzhgues të BE-së dhe më pas në OSCE deri në vitin 2002.

13.5 Subjekti është pyetur nga Komisioni për të dhënë sqarime rreth mënyrës së fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri, për shkak të mospërputhjeve të konstatuara si më lart evidentuar, dhe në përgjigje të kësaj kërkesë, ai ka deklaruar:

(i) Në përgjigje të pyetësorit të datës 1.6.2020, se: *Automjeti ka kushtuar 450.000 lekë, plus doganë 157.525 lekë dhe bashkë me riparimet ka kapur vlerën 800.000 lekë. Në vitin 2003, ka deklaruar vlerën totale të automjetit. Në vitin 2004, ka deklaruar vetëm vlerën fillestare pa doganë dhe riparime, ndërsa në vitin 2008, të gjitha shpenzimet të cilat janë bërë me paratë e kursyera nga puna në OSBE dhe KE. Shkaku i deklarimeve të ndryshme për çmimin, ka qenë paqartësia në përpilimin e deklaratave fillestare të pasurisë.*

(ii) Në përgjigje të pyetësorit të datës 09.12.2020, ka sqaruar se: *Duke marrë në konsideratë vlerën e blerjes së automjetit, doganën dhe riparimet, rezulton se vlera e shitjes është më e ulët se vlera e blerjes. Automjeti ka kushtuar 450.000 lekë, plus doganë 157.525 lekë, dhe bashkë me riparimet ka kapur vlerën 800.000 lekë. Automjeti është shitur në vlerën 700.000 lekë, pra 100.000 lekë më pak sesa vlera totale e tij, ku përfshihej blerja, dogana dhe riparimet. Shitja e mjetit me çmimin e lartpërmendur nuk i nënshtrohej tatimit mbi fitimin për këto arsye: ligji nr. 8977, datë 12.12.2002, në nenin 3, pika 20, ka parashikuar: “Taksa e kalimit të pasurive të paluajtshme e automjeteve”. Kjo lloj takse u shfuqizua me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008.*

<sup>14</sup> Subjekti i rivlerësimit ka filluar detyrën e prokurorit në gusht 2008.

<sup>15</sup> Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

<sup>16</sup> Nga kjo praktikë, rezulton se ky mjet fillimisht ka qenë i regjistruar pranë DPSHTR Dibër, në pronësi të Bledar Maksutit, me targë {\*\*\*}, dhe me kërkesë të subjektit, dosja e mjetit është transferuar në Tiranë dhe është regjistruar në DPSHTR Tiranë po në pronësi të Bledar Maksutit, me targa {\*\*\*}.

*Subjekti deklaron se është në dijeni të parashikimeve ligjore të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku në nenin 4 janë parashikuar edhe “të ardhura të tjera”. Gjithmonë, sipas kuptimit të tij, kjo bazë ligjore nuk mund të përdoret, pasi me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, është parashikuar një taksë e drejtpërdrejtë mbi automjetet që është shfuqizuar nga ligjvënësi dhe nuk mund të përdoren dispozita të përgjithshme të ligjit për “Tatimin mbi të ardhurat”. Subjekti deklaron se nuk e ka paguar detyrimin tatimor, në gjykimin e tij automjeti është shitur me humbje. Subjekti deklaron se remontin e automjetit e ka bërë në dhjetor të vitit 2007, në vlerën 200.000 lekë.*

**13.6** Në analizë të situatës faktike, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit për automjetin “Mercedes Benz 250 D”, për të cilin ka fituar pronësinë në shtator të vitit 2001, pavarësisht ndryshimeve në vlerat e përcaktuara se ka shpenzuar për blerjen e tij, të cilat herë janë të plota, duke përfshirë çmim + doganë + shpenzime për riparime, dhe herë jepen të dhëna pjesore për këto elemente, ka qenë konsistent për sa i përket mënyrës së fitimit të kësaj pasurie. Që në deklaratën fillestare në vitin 2003, në të cilën ka deklaruar me cilësinë e OPGj-së, DPV-të e viteve 2008, 2009, deklaratën e pasurisë *vetting*, e deri në shpjegimin e fundit të dhënë prej tij gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar në mënyrë persistente se mënyra e fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri, ka qenë nëpërmjet kontratës së shitblerjes, duke përcaktuar si shitës z. P. L.. Gjithashtu, edhe në shpjegimet e dhëna me pyetësorët, si dhe me shpjegimet për rezultatet e hetimit, subjekti sërish deklaron se mjetin e ka siguruar duke e blerë, pavarësisht se ky transaksion nuk është formatizuar në një kontratë shitblerjeje, por me një kontratë dhurimi, për të cilën subjekti gjithashtu ka dhënë një shpjegim përse është zgjedhur kjo formë për kalimin e pronësisë, duke e lidhur atë me faktin se fillimisht ky automjet u projektua të dhurohej si kompensim i shërbimeve që babai i tij do të bënte për saktësimin e tokave të shitësit dhe, në kushtet kur ky i fundit dështoi të siguronte dokumentacionin e nevojshëm për pasuritë e tij, u ra dakord që automjeti të shitej pasi shërbimi nuk do të ofrohej nga babai i subjektit. Subjekti ka shpjeguar gjatë hetimit administrativ në Komision se, për shkak të faktit që pronari i automjetit, z. P. L., ishte rezident në Itali, anulimi i kontratës së dhurimit dhe lidhja e kontratës së shitjes do të bëhej në momentin kur ai të vinte në Shqipëri.

**13.7** Lidhur me automjetin “Mercedes Benz 250 D”, rezulton se në vendimin e Komisionit është konkluduar, ndër të tjera, se: *Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka pasqyruar saktë në deklaratën “vetting” mënyrën e fitimit të pasurisë tip “Mercedes Benz 250 D”, pasi rezulton se ky automjet i është dhuruar dhe jo blerë prej tij, duke e ngritur këtë konstatim në nivelin e një shkaku që kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Kolegji ndan një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me këtë çështje, i cili së pari, konsiston në mungesën e detyrimit të subjektit për të deklaruar në deklaratën *vetting*, mënyrën e fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri, duke qenë se ajo ishte një pasuri jo vetëm e fituar në vitin 2001, kur subjekti nuk kishte asnjë funksion zyrtar dhe aq më tepër ligji nr. 9049/2003 nuk ishte miratuar ende, por gjithashtu rezulton se kjo pasuri është shitur nga subjekti në vitin 2009 dhe nuk ka qenë në pronësi të tij në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting*.*

**13.8** Në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe të përcaktimeve të shtojcës 2 të këtij ligji, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin për të deklaruar në deklaratën *vetting* të gjitha pasuritë që ata disponojnë në

momentin e plotësimit të kësaj deklarate dhe burimet e financimit të tyre. Në kushtet kur automjeti “Mercedes Benz 250 D” rezulton të jetë shitur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009, pra ai nuk ka ekzistuar si pasuri në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimi nuk ka pasur detyrim të deklarojë lidhur me të, duke mirëspecifikuar aktet ligjore mbi të cilat ka siguruar pronësinë apo vlerën e shpenzuar për të. Këto të dhëna do të ishin elemente që duhej të analizoheshin nga Komisioni, në funksion të verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie apo për të ardhurat e krijuara prej shitjes së saj, që kanë shërbyer më pas për financimin e një tjetër automjeti të blerë prej subjektit. Fakti që subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, përtej të ardhurës së krijuar nga shitja e kësaj pasurie, edhe detaje për mënyrën e fitimit të saj, ndërkohë që ajo nuk ishte një pasuri që duhej të deklarohet në këtë deklaratë, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi sipas ligjit, për sa kohë që deklaramet janë përtej asaj që ligji ka përcaktuar si detyrim për subjektet. Në këtë kuptim, konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në deklaratën *vetting*, për të dhëna që nuk duhej të ishin pjesë e këtij deklarimi sipas përcaktimit ligjor, është në tejkalim të situatës së parashikuar se mund të kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

**13.9** Përveç sa më sipër, Kolegji konstaton si më lart, se pavarësisht pasaktësive në deklaramin e elementeve përbërëse të vlerës së paguar për fitimin e pronësisë, për arsyet që u renditën më lart, subjekti ka qenë konsekuent në deklaramin e tij, se mënyra e fitimit të pronësisë mbi këtë automjet, ka qenë blerja, dhe vetë Komisioni në konkluzionin e tij, e ka pranuar se kjo mund të ketë qenë e mënyra e vërtetë, por ka konkluduar se ka pasur deklaramin të pasaktë për shkak të ekzistencës së kontratës së dhurimit, përcjellë me aktet nga DPSHTRR. Në këtë vlerësim, mbahet në konsideratë edhe fakti që një subjekt deklarues në kuptim të këtij procesi, do të ishte i interesuar në versionin që kërkon të shmanget nga përgjegjësitë, të deklaronte si mënyrë fitimi dhurimin, e cila mundëson kalimin e pronësisë pa shpërblim, që do të thotë pa shpenzime për subjektin. Konsekuenca e subjektit në deklarime, që në vitin 2003, se kjo pasuri është fituar me blerje, për pasojë duke u vetëngarkuar me shpenzime financiare në kuptim të analizës financiare, bën të besueshëm këtë deklaramin dhe të pasaktë konkluzionin e Komisionit për pasaktësi edhe në kuptim të thelbit të tij, në rast se subjekti do të kishte detyrimin ta deklaronte mënyrën e fitimit të pronësisë në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**13.10** Për sa më sipër, Kolegji arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit se subjekti ka bërë deklaramin të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting*, për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që nuk ka ekzistuar detyrimi i subjektit për ta deklaruar në këtë deklaratë këtë pasuri dhe as elementet e tjera që lidhen me fitimin e saj, si një pasuri që ishte tjetërsuar prej tij që në vitin 2009, gjendet nga Kolegji si një konkluzion jo i drejtë dhe i pabazuar në ligj.

**13.11** Në lidhje me automjetin “Mercedes Benz 250 D”, Kolegji mori në analizë përveç sa më lart, edhe konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit vlera e shitjes së këtij automjeti në vitin 2009, prej 700.000 lekësh, nuk duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, meqenëse subjekti nuk ka paguar për fitimin e realizuar nga shitja e tij, si një send i dhuruar, detyrimet tatimore në kuptim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Komisioni ka arritur në këtë konkluzion, pavarësisht faktit se në analizën financiare të kryer për familjen e subjektit, e ka ngarkuar atë me një shpenzim financiar në vlerën prej 800.000 lekësh, aq sa subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar për blerjen e tij në vitin 2001. Pra, ndërsa e

ka njohur si shpenzim këtë vlerë, ka konsideruar si fitim të plotë vlerën prej 700.000 lekësh, të përfituar nga shitja në vitin 2009, dhe nuk e ka konsideruar këtë shumë si të ardhur të ligjshme për arsyet e mësipërme.

**13.12** Në përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe me shpjegimet e dhëna mbi rezultatet paraprake të hetimit, por edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kontestuar këtë qëndrim në të dyja versionet, edhe nëse pranohet se automjetin e ka përfituar nëpërmjet blerjes, edhe nëse pranohet se e ka siguruar nëpërmjet dhurimit, duke pretenduar se, referuar legjislacionit të kohës, nuk ka pasur detyrime tatimore për të paguar për vlerën e përfituar në vitin 2009 nga shitja e tij. Subjekti i rivlerësimit rezulton se në shpjegimet e dhëna mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativ, ka pretenduar se duke u bazuar në ligjin nr. 8439/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe në udhëzimin nr. 5, të miratuar në zbatim të tij në vitin 2009, fitimi kapital nga dhurimi<sup>17</sup> nuk ka qenë objekt tatimi, pasi është parashikuar për pasuritë e paluajtshme me ndryshimet e këtij ligji të miratuara me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010. Subjekti i rivlerësimit pretendon se edhe nëse pranohet që prej tij, pronësia e automjetit “Mercedes Benz 250 D”, është fituar në vitin 2001 nëpërmjet shitblerjes (*i cili është edhe versioni i deklaruar nga subjekti*), sërish ligji i kohës nuk e ngarkonte atë me detyrimin për të paguar tatime mbi shumën e siguruar nga shitja e automjetit në vitin 2009, të cilat ishin më të ulëta se edhe vetë vlera e blerjes. Subjekti i ka shoqëruar këto pretendime me pasqyrimin e bazës ligjore të zbatueshme sipas tij, që mbështet në thelb mungesën e detyrimit të subjektit për të paguar tatimin mbi çmimin e shitjes së automjetit dhe se kjo rrethanë duhej ta kishte çuar Komisionin në konkluzionin se shuma e përfituar nga shitja prej 700.000 lekësh, të konsiderohej si e ardhur e ligjshme në kuptim të standardeve kushtetuese e ligjore të këtij procesi.

**13.13** Në analizë të këtij shkakut të ankimit që lidhet me detyrimin ligjor të subjektit për të paguar detyrime tatimore mbi të ardhurën e siguruar nga shitja e automjetit, Kolegji evidenton fillimisht elementet e situatës faktike, mbi të cilat duhet bërë analiza ligjore, si:

(i) Subjekti i rivlerësimit në mënyrë koherente në deklaratën fillestare dhe ato periodike të deklarimit të pasurisë, ashtu edhe dhe në deklaratën *vetting*, ka deklaruar se pronësinë mbi mjetin “Mercedes Benz 250 D” – me vlerë 800.000 lekë, e cila përfshin vlerën e shitblerjes, zhdoganimit dhe riparimit të mjetit – e ka fituar në vitin 2001, që i përket një periudhe larg kohës kur ai ka filluar funksionin si OPGj, por edhe më të largët nga ajo e ushtrimit të funksionit si prokuror.

(ii) Në drejtim të analizës financiare, konstatohet se në analizën e kryer nga Komisioni, në vitin 2001 familja e subjektit është ngarkuar me shpenzim për blerjen e automjetit “Mercedes Benz

---

<sup>17</sup> Në drejtim të përmbushjes së detyrimeve tatimore për rastet e dhurimit, Kolegji sjell në vëmendje qëndrimin e jurisprudencës së tij të dhënë për një situatë të ngjashme në vendimin JR (9)/2021: “[...] subjekti nuk është individ që e ka krijuar këtë pasuri, por atë e ka përfituar bashkëshortja e tij nëpërmjet dhurimit që, sipas përkufizimit të nenit 761/1 të Kodit Civil: “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat kjo i pranon, i ka sjellë atij të drejta pasurore mbi këtë pasuri, pa pasur ndonjë detyrim lidhur me të”. Për pasojë, në këtë kuptim, subjekti është i zhveshur në kuptim të këtij ligji nga ndonjë detyrim i cili do të kondiciononte ligjshmërinë e pasurisë përtej provimit të krijimit të saj prej personit të lidhur nga burime të ligjshme e të verifikueshme”.

250 D”, në shumën 800.000 lekë, dhe situata financiare e familjes rezulton pozitive, pra nuk konstatohet mungesë e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit.

**(iii)** Pavarësisht analizës financiare, Komisioni pranon në arsyetimin e tij që automjeti është përfituar nga subjekti mbi bazën e dhurimit dhe nuk bën asnjë arsyetim lidhur me vlerën mbi të cilën subjekti kishte detyrim për të paguar detyrimet tatimore në momentin e shitjes së tij.

**(iv)** Vlera e deklaruar prej subjektit si e shpenzuar për automjetin, për të cilën ekonomia familjare është ngarkuar me shpenzim, prej 800.000 lekësh, është më e madhe se vlera e shitjes së automjetit në vitin 2009, në vlerën 700.000 lekë.

**13.14** Në përfundim të trajtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me pasurinë automjet “Mercedes Benz 250 D”, Kolegji çmon se pretendimet e subjektit janë të drejta edhe për sa i përket mënyrës së fitimit të kësaj pasurie, nëpërmjet blerjes/pagimit të vlerës edhe mospasjes së detyrimit për pagimin e ndonjë tatimi mbi vlerën e shitjes së tij. Subjekti vlerësohet i besueshëm në deklaratimet e tij për blerjen e automjetit, kundrejt vlerës prej 800.000 lekësh, të deklaruar si të tillë që në vitin 2003, pavarësisht ekzistencës së një kontrate dhurimi, mes atij dhe pronarit të automjetit. Kolegji nuk evidenton asnjë rrethanë që do e detyronte subjektin të mos deklaronte të vërtetën në këtë rast, për sa kohë që versioni i blerjes së automjetit, i deklaruar në mënyrë vullnetare dhe duke mos qenë aspak nën tryshinë e ndonjë kontrolli të posaçëm nga institucionet, si edhe për një pasuri të fituar në vitin 2001, kur subjekti ishte një i sapodiplomuar në kërkim të punësimit të tij, përveç se e ngarkonte atë me shpenzime, nuk prodhonte asnjë lehtësim për pozitën e tij si deklarues. Subjekti mund të kishte zgjedhur të deklaronte dhurimin si formë e fitimit të pronësisë sepse kjo formë do ta lehtësonte me shumë mundësi nga ngarkimi me shpenzime në analizën financiare, por duket se a nuk e ka bërë këtë deklaram vetëm për arsyen se ai nuk i përgjigjej së vërtetës. Në këtë mënyrë, Kolegji, duke shmangur qëndrimin formalist të Komisionit në vlerësimin e kësaj situatë, konkludon se shpjegimet e subjektit janë të besueshme dhe se mënyra e fitimit të pronësisë mbi këtë pasuri është ajo e deklaruar prej tij. Përveç këtij konkluzioni, nënvizohet edhe fakti se nga analiza financiare e kryer në Komision dhe e konfirmuar në Kolegj, subjekti kishte burime të ligjshme për blerjen e tij në vitin 2001.

**13.15** Në vijim dhe mbështetur mbi këtë përfundim, në analizë të deklarimeve të subjektit dhe akteve që provojnë vlerën e shpenzuar për fitimin e pronësisë mbi këtë pasuri, duket se nuk rezulton diferencë pozitive mes çmimit/vlerës së shpenzuar nga subjekti për automjetin dhe atij të shitjes së tij. Për pasojë, nuk evidentohet një diferencë/fitim që mund t’i nënshtrohej këtij rregulli për t’u ngarkuar me detyrimin tatimor mbi fitimin.

**13.16** Në vijim, Kolegji mban një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni edhe për sa i përket konsiderimit si të ardhura të ligjshme të atyre të fituara nga shitja e këtij automjeti në vitin 2009, në vlerën prej 700.000 lekësh, pasi ato plotësojnë kushtin e së ardhurës së ligjshme për sa kohë kanë buruar nga shitja e një pasurie që është krijuar me burime të ligjshme, e përderisa kjo shumë nuk ka qenë e ngarkuar me pagimin e ndonjë detyrimi tatimor, siç u arsyetua më lart. Në këto kushte, kjo vlerë u përfshi në përlllogaritjen e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tjetër të subjektit “Mercedes Benz 270 D” në vitin 2009, për vlerën prej

8500 eurosh, sipas deklarimeve të tij në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në ato periodike, duke prodhuar një rezultat pozitiv për këtë vit.

**13.17** Përfundimisht, për automjetin “Mercedes Benz 270 D”, pasuri e krijuar prej subjektit në vitin 2009 dhe e shitur në vitin 2015, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie në vitin 2009, duke përfshirë në analizën financiare të ardhurën prej 700.000 lekësh, të krijuar nga shitja e automjetit “Mercedes Benz 250 D” të përshkruar më lart, e ardhur e cila plotëson kriteret e së ardhurës së ligjshme sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

- 14** Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konkluzionet e Komisionit në adresë të pasurisë në emër të tij, e llojit automjet, tip “Volkswagen Sharan 2.0”, sipas të cilave: *analiza e Komisionit është kryer në mënyrë të cunguar, duke mos përfshirë në analizë si burim financimi të ardhurat familjare të deklaruara si burim në deklaratën “vetting”, të përbëra nga: (i) gjendja cash e subjektit dhe e bashkëshortes në shumën 800.000 lekë, e cila pasi u përdor dhe më pas u shtua në këtë sasi deri në fund të vitit 2015; (ii) gjendja në cash e babait të subjektit, e cila provohet nga mundësia për kursim e analizës financiare.*

**14.1** Lidhur me këtë pasuri, në vendimin e Komisionit është konkluduar si vijon:

*Nga analiza financiare e lartpërmendur, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, në shumën (-)622.293,23 lekë. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi duke deklaruar se si burim ka shërbyer gjendja cash në shumën 800.000 lekë që ka pasur në banesë, e cila më pas u zëvendësua me kursimet ndër vite. Subjekti pretendon se si burim ka shërbyer edhe gjendja cash e babait, për të cilën, sipas deklarimeve të tij, nuk ka pasur informacion. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Është e vërtetë që nëse do të përfshihej shuma 800.000 lekë si gjendje cash nga subjekti, ai do të kishte të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti, por ndërkohë, nga analiza e vitit 2015 rezulton se ai nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes cash në shumën 800.000 lekë. Në lidhje me gjendjen cash të babait të subjektit, Komisioni e ka analizuar në detaje në pikën 39.7.1 të këtij vendimi. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë tip “V. Sh”, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**14.2** Subjekti i rivlerësimit pretendon se: Komisioni, në analizën financiare të kryer deri në datën 06.07.2015, duhet të përfshinte: (i) gjendjen *cash* të disponuar prej meje dhe bashkëshortes, 800.000 lekë; (ii) të ardhurat nga shitja e automjetit “Mercedes Benz 270D” dhe të ardhurat familjare deri me 06.7.2015, duke shpjeguar se nuk ka pasur informacion për gjendjen *cash* që babai ka pasur deri në atë datë. Subjekti vijon shpjegimet se gjendja *cash* në fund të vitit 2015, ka qenë po 800.000 lekë, pasi me aq sa u pakësua nga blerja e automjetit, po me aq kursime në *cash* u shtua në periudhën 7 korrik - 31 dhjetor 2015. Subjekti shpjegon se kjo është edhe arsyeja se përse nuk ka deklaruar as shtesa e as pakësime në DVP-në e vitit 2015.

**14.3** Nga analizimi i deklaratës *vetting* dhe i deklarimeve në deklaratat periodike të pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit, për automjetin “Volkswagen Sharan 2.0”, ka deklaruar:

(i) Në deklaratën *vetting*: *automjet tip "Volkswagen Sharan 2.0", vit prodhimi 2009, me vlerë 9.250 euro + 266.550 lekë taksë doganore. Pjesa takuese: 100%. Burimi sipas deklaratës "vetting": të ardhura nga shitja e automjetit të parë tip "Mercedes Benz", në shumën 5.000 euro, shitur shtetasit N. D., ndërsa diferenca nga të ardhurat familjare.*

(ii) Në DVP-2015, subjekti ka deklaruar: *automjet tip "Volkswagen Sharan 2.0", vit prodhimi 2009; vlera 9.250 euro. Pagesë e taksës doganore 266.550 lekë; pjesa takuese: 100%. Burimi i financimit: Të ardhura nga shitja e automjetit të parë "Mercedes Benz", në shumën 5.000 euro, shtetasit N. D.. Ndërsa diferenca nga të ardhurat familjare.*

**14.4** Kolegji fillimisht verifikoi deklaratimet që subjekti ka bërë në deklaratën *vetting* dhe në DVP-2015 për mënyrën e financimit të kësaj pasurie, sipas të cilave ka përcaktuar si burim të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit të mëparshëm, "Mercedes Benz 270D", dhe të ardhurat familjare. Lidhur me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit "Mercedes Benz 270 D" në shumën 5.000 euro, në vijim të analizës dhe të konkluzioneve të mbajtura në këtë vendim në paragrafët e mësipërm 13.14 dhe 13.17, Kolegji çmon se provohet ligjshmëria e krijimit të kësaj shume, e cila gjenerohet nga shitja e një pasurie tjetër të krijuar po me burime të ligjshme prej subjektit. Në këto kushte, Kolegji vijoi analizën me verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të financuar me burime të ligjshme blerjen e këtij automjeti me të ardhurat që ai i konsideron si të siguruara nga të ardhurat familjare.

**14.5** Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon që në analizën financiare të Komisionit, duhet të ishte përfshirë si burim për blerjen e autoveturës "Volkswagen Sharan 2.0", gjendja e *cash*-it të disponuar nga bashkëshortja, në shumën 800.000 lekë, si dhe gjendja e *cash*-it të disponuar nga babai i tij. Sipas subjektit, ai nuk ka pasur dijeni se sa para në *cash* ka disponuar i ati në atë periudhë, por siç rezulton dhe nga analiza financiare e kryer nga vetë Komisioni, mundësia për kursim në periudhën nga emërimi i tij në detyrë, në gusht të vitit 2008, deri në vitin 2014, ka qenë 5.580.029 lekë, shumë e cila nuk përfshin shumën e huave të kthyer babait nga motrat e subjektit. Në lidhje me gjendjen e kursimeve në *cash* që ka disponuar bashkëshortja, në shumën 800.000 lekë, subjekti shpjegon se kjo vlerë është përdorur në momentin e blerjes së automjetit dhe më pas është zëvendësuar prej tyre me kursime të vitit, duke passjellë që në fund të vitit 2015, gjendja e kursimeve në *cash* e krijuar nga subjekti dhe bashkëshortja të ishte përsëri në shumën 800.000 lekë.

**14.6** Për verifikimin e këtij shkak ankimi, Kolegji kontrolloi analizën financiare të kryer prej Komisionit për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme pjesën e mbetur të vlerës së këtij automjeti 683.782 lekë, duke konsideruar se shuma prej 5500 eurosh ishte financuar me të ardhurat e krijuara prej shitjes së automjetit "Mercedes Benz 270D", nga e cila rezultoi se: **(i)** në analizën e kryer, duke konsideruar vetëm të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes së tij deri më datë 06.07.2015 (që është data e lidhjes së kontratës së shitblerjes së këtij automjeti), subjekti rezulton me një diferencë negative të mbulimit të shpenzimeve/investimeve me të ardhura të ligjshme në shumën (-) 463.507 lekë; **(ii)** në analizën e kryer vetëm për subjektin më datë 13 korrik (që është data e zhdoganimit të automjetit), subjekti rezulton me një diferencë pozitive të mbulimit të shpenzimeve/investimeve me të ardhura të ligjshme në shumën (+) 269.943 lekë. Kjo diferencë në analizën financiare vjen për shkak të faktit se më datë 07.07.2015, subjekti i rivlerësimit, për shkak të transaksioneve bankare (tërheqjes), ka disponuar likuiditete në *cash*, të cilat kanë përmirësuar

situatën financiare të tij lidhur me shlyerjen e detyrimeve për automjetin “Volkswagen Sharan 2.0”.

**14.7** Në analizë të të dhënave që janë administruar lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, Kolegji, duke bërë një vlerësim të deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato të bëra në deklaratat periodike e në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, çmon të konsiderojë si me vlerë provuese deklaratimet e para të dhëna me vullnet të lirë dhe të pakushtëzuara nga rezultatet e hetimit administrativ. Shpjegimet e subjektit të dhëna gjatë hetimit, në devijim të deklarimeve të bëra fillimisht prej tij, shihen si përpjekje për të stabilizuar analizën financiare të ndërtuar ndërkohë sipas qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni dhe Kolegji në jurisprudencën e tij lidhur me deklaratimet për përcaktimin e burimeve të financimit të pasurive në deklaratat periodike dhe përdorimin e kursimeve në *cash* për krijimin e tyre.

**14.8** Në rastin në analizë, rezulton se subjekti ka referuar si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu edhe në DPV-në e vitit 2015, se si burim të i krijimit të kësaj pasurie kanë shërbyer të “ardhurat familjare”, përveç atyre që kanë ardhur nga shitja e automjetit “Mercedes Benz 270 D”, të përshkruar më lart. Ai nuk ka referuar në këto deklaratime se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer kursimet e tij dhe të bashkëshortes në *cash*, të ardhurat e babait apo edhe gjendja e kursimeve në *cash* të këtij të fundit. Në këto deklaratime, ndryshe nga ato që subjekti ka bërë për financimin e dy automjeteve të tjera, të cilat kanë qenë në pronësi të tij [“Mercedes Benz 250 D” dhe “Mercedes Benz 270 D”], ai nuk ka përcaktuar të ardhurat e babait të tij si burim i krijimit të pasurisë, fakt që rezulton i deklaruar qartë në dy pasuritë e tjera. Në këto kushte, rezulton se vetë subjekti ka përcaktuar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe atë periodike si burim të krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat personale të krijuara prej tij e bashkëshortes, duke përjashtuar nga ky grup të ardhurat e familjarëve të tjerë. Për këto arsye, Kolegji vlerësoi se në kontrollin për financimin e kësaj pasurie do jenë vetëm të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes dhe në to nuk do të mund të përfshihen të ardhurat/kursimet e babait të tij.

**14.9** Në vijim të kësaj analize, Kolegji gjithashtu konstaton se në deklaratimet në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato periodike, subjekti ka përcaktuar si burim të *ardhurat familjare* dhe jo *kursimet familjare*, siç ai pretendon gjatë hetimit dhe ankimit të tij. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, kontrolli i burimit të krijimit të pasurive do të duhet t’u bëhet burimeve të ligjshme në momentin e krijimit të pasurisë dhe, përderisa subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat dhe jo kursimet, atëherë verifikimi i mundësisë për të justifikuar këtë pasuri do të mbështet mbi këto të dhëna, deri në datën e kryerjes së pagesave. Pretendimi i subjektit se përdorimi i kursimeve prej 800.000 lekësh, të disponuara në datën e kryerjes së pagesave, nuk ka lënë gjurmë në DPV-në e vitit 2015, duke qenë se ato janë zëvendësuar në fund të vitit, mbetet në nivel deklarativ, përderisa në përcaktimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, jo vetëm në DPV-në e vitit 2015, por edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti nuk ka përcaktuar si burim kursimet, por të ardhurat e disponuara deri në atë moment.

**14.10** Duke përdorur këto konkluzione si më sipër arsyetuar, Kolegji kontrolloi burimet dhe mundësinë e subjektit për financimin e kësaj pasurie, duke pasur në konsideratë, ndryshe nga



Komisioni, edhe momentet e kryerjes së pagesave për këtë pasuri. Rezulton nga aktet në dosje, se fillimisht subjekti ka paguar vlerën prej 1.269.840 lekësh në datën 06.07.2015 për blerjen e automjetit dhe më pas, në datën 13.07.2015, ka paguar vlerën prej 266.550 lekësh për shlyerjen e detyrimit doganor për të. Të dyja këto vlera së bashku përfaqësojnë vlerën e shpenzuar për krijimin e kësaj pasurie prej 1.536.390 lekësh. Në këndvështrim të këtyre rrethanave faktike, Kolegji vlerësoi mundësinë e subjektit për kryerjen e këtyre financimeve respektivisht në datat përkatëse, nga ku rezultoi se ai gjendej në mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar pagesën në datën 06.07.2015, në vlerën prej (-) 463.507 lekësh, dhe rezultonte në një situatë pozitive për shlyerjen e taksës doganore në datën 13.07.2015. Kjo situatë financiare ka ndryshuar thelbësisht për shkak se rezultoi se në datën 07.07.2015, vetëm një ditë pas pagesës së çmimit të automjetit, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria e saj bankare vlerën prej 1.000.000 lekësh, e cila nuk rezultoi të jetë përdorur për ndonjë investim apo shpenzim të posaçëm, por që ka shërbyer, pavarësisht si gjendje monetare në dispozicion të subjektit, për shlyerjen e pagesës që lidhej me taksën doganore të automjetit.

**14.11** Në përfundim të analizës së bërë më lart për automjetin “Wolkswagen Sharan 2.0”, me vlerë 9.250 euro, të blerë nga subjekti në vitin 2015, Kolegji pasi kreu analizën financiare, konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e tij në vlerën prej (-) 463.507 lekësh, duke u kualifikuar kjo situatë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 15 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për pasurinë “garazh”, të blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, se për sa kohë ai nuk ka të drejta reale/interesa pasurorë dhe as ndonjë marrëdhënie dhurimi apo huaje siç kërkon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për këtë pasuri, duke pretenduar gjithashtu se nëse në analizën ekonomike të Komisionit do të përfshihej si e ardhur mundësia për kursim e babait të tij për periudhën 2008-2014, rezulton se ai kishte mundësi për financimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie, Kolegji analizon sa vijon:**

**15.1** Për pasurinë garazh, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se:  
**42.4.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se është i drejtë konstatimi i tij që nuk ka të drejta reale mbi këtë pasuri, por ndërkohë është ai që e përdor këtë pasuri, pasi babai i tij nuk ka automjet në pronësi. Pavarësisht faktit të të drejtave të subjektit mbi këtë pasuri, babai i tij është person i lidhur, në kuptim të nenit 3/13 të ligjit nr. 84/2016, pasi është pjesë në certifikatën familjare të subjektit dhe, për rrjedhojë, ky i fundit ka detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij për blerjen e pasurisë garazh. Në lidhje me kursimet cash ndër vite të babait, ato nuk janë marrë në konsideratë, bazuar në analizën e bërë në pikën 39.7.1 të këtij vendimi. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë garazh në pronësi të babait të tij. Si rrjedhojë, subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë garazh, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**15.2** Në deklaratën *vetting*, për pasurinë garazh, kanë bërë deklaratime si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe babai i tij, në cilësinë e personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, duke deklaruar përkatësisht:

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Blerje garazhi poshtë apartamentit ku jeton familja, në shumën 6000 euro, më datë 29.04.2016. Garazhi është blerë nga të ardhurat e babait dhe kursimet familjare. Garazhi është hipotekuar në emrin e babait P. M., pa deklaruar pjesë takuese. Babai i subjektit, në deklaratën *vetting*, garazhin e deklaroi me të njëjtin përshkrim si subjekti i rivlerësimit, por me dallimin se ai ka përcaktuar se pjesa e tij takuese është 100%.*

**15.3** Në DVP-në e vitit 2016, për garazhin, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Blerje garazhi, poshtë apartamentit ku jeton familja, në shumën 6000 euro. Garazhi është blerë nga të ardhurat e babait nga puna e tij si avokat, si dhe kursimet familjare. Garazhi është hipotekuar në emrin e babait P. M., pa deklaruar pjesën takuese.*

Në DVP-2016, për garazhin, babai i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar: *Blerje garazhi, poshtë apartamentit ku jeton familja, në shumën 6000 euro. Garazhi është blerë nga të ardhurat e mia nga puna si avokat, si dhe kursimet familjare. Garazhi është hipotekuar në emrin e P. M.. Pjesa takuese: 100%.*

**15.4** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se për pasurinë “garazh”, për sa kohë nuk ka të drejta reale dhe as interesa pasurorë dhe as ndonjë marrëdhënie dhurimi apo huaje, siç kërkon neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të ngarkohet me barrë prove e me përgjegjësi për këtë pasuri, Kolegji mban të njëjtin qëndrim, të cilin e ka arsyetuar më lart, lidhur me detyrimin që ka personi i lidhur, babai i subjektit dhe vetë subjekti për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie sipas parashikimit të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, Kolegji çmon se kjo pasuri me të drejtë i është nënshtruar kontrollit dhe verifikimit të burimeve të krijimit të saj nga ana e Komisionit.

**15.5** Në vijim të sa më sipër, Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit, edhe në versionin që vlerësohet se pasuria “garazh” është objekt kontrolli, nëse do të përlllogaritet mundësia për kursim e babait të tij për periudhën 2008-2014, rezultoi se ai kishte mundësi për financimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie.

**15.6** Referuar konkluzioneve të vendimit, rezultoi se prej Komisionit, analiza për të verifikuar burimet e financimit të pasurisë “garazh”, është bërë duke konsideruar vetëm të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortes, të pensionit të nënës dhe të babait të tij, përgjatë vitit të krijimit të pasurisë, 2016, duke lënë jashtë analizës mundësinë e babait për të krijuar kursime nga puna e tij si avokat në vitet paraardhëse, me arsyetimin se këto kursime nuk janë deklaruar në DVP nga subjekti.

**15.7** Duke përdorur konkluzionin e arritur në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, të arsyetuar si më lart, Kolegji vlerësoi se analiza financiare për të verifikuar mundësinë e babait të subjektit për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2016, do të duhet të kryhet duke llogaritur edhe mundësinë e kursimit prej tij nga të ardhurat e krijuara në vite nga puna si avokat e noter, deri në vitin 2016.

Në analizën e këtij burimi, Kolegji mori në shqyrtim fillimisht qëndrimin e mbajtur në vendimin e Komisionit se: *Në lidhje me gjendjen cash të babait të subjektit, Komisioni e ka*

*analizuar në detaje në pikën 39.7.1 të këtij vendimi*, të përdorur për çdo pasuri të deklaruar se është financuar me të ardhurat e babait të subjektit. Kolegji konstatoi se edhe pse në përmbajtjen e të gjithë këtij vendimi nuk ka paragraf të numërtuar 39.7.1, tek i cili të gjendet një analizë e dedikuar për përlllogaritjen e mundësisë për të pasur kursime të akumuluar në *cash* të babait të subjektit të rivlerësimit, tek e cila Kolegji mund të referohej, në paragrafin 59.1.5 të vendimit objekt shqyrtimi, Komisioni arrin në konkluzione për mospërfshirjen në analizën ekonomike të familjes Maksuti të gjendjes *cash* të babait të tij, duke u bazuar kryesisht në arsyetimin se subjekti, në momentin e fillimit të detyrës, nuk ka deklaruar kursimet në *cash* të babait të tij dhe se llogaritja e këtyre kursimeve është e pamundur të realizohet veçmas, pasi nuk mund të abstragohet mundësia e tij autonome për kursime, për sa kohë ai ka jetuar së bashku me subjektin dhe shpenzimet e tyre kanë qenë të përbashkëta.

Kolegji kontrollon mundësinë e prindërve për të krijuar kursime në *cash*, duke analizuar fillimisht për periudhën 2000-2008 dhe më pas atë pas vitit 2008, kur subjekti fillon të ushtrojë funksionet e prokurorit. Për periudhën 2000-2008, në këtë analizë, janë konsideruar: 3 (tri) huadhënie të babait të subjektit të rivlerësimit, të konsideruara edhe nga Komisioni, si dhe *blerja e autoveturës tip "Mercedes Benz"*, në një vlerë totale prej 800.000 lekësh (duke përfshirë në të vlerën e blerjes, shlyerjen e detyrimeve doganore, si dhe shpenzime riparimi), për të cilat po analizohet si në vijim. Në këtë analizë, gjendja e *cash-it* të akumuluar në vitet paraardhëse (*deri 31.12.2004*), para finalizimit të blerjes së apartamentit, është në shumën (+) 851.429 lekë, e si rrjedhim në vitin 2005, familja e subjektit rezulton me një diferencë negative të mbulimit të shpenzimeve/investimeve (blerjes së apartamentit në rrugën "{\*\*\*}"), me burime të ligjshme prej (-) 2.386.496 lekësh. Në këtë analizë, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për dhënien e huave motrave, në një shumë totale prej 45.000 eurosh, pasi analiza e vitit 2000 dhe ajo e vitit 2002 rezultojnë në shifra pozitive. Ndërsa, referuar situatës financiare më datë 01.08.2008 (momenti i fillimit të detyrës si prokuror i subjektit të rivlerësimit), familja e tij ka rezultuar me një balancë pozitive të mbulimit të shpenzimeve, duke pasur mundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme si kursime të akumuluar në *cash*, shumën (+) 1.036.194 lekë. Kjo shumë, në analizën financiare të viteve vijuese të kryer nga Kolegji, nuk është përfshirë si kursim i akumuluar në *cash* nga babai i tij, nisur nga vlerësimi i dy elementeve: (i) faktit që vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, pretendon se babai ka disponuar si likuiditet *cash*, në vitin 2007, shumën prej 500.000 lekësh, të cilën Komisioni e ka inkorporuar në analizën financiare të vitit 2007. (ii) Nisur nga fakti që analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2007, ka një rezultat negativ prej (-) 308.156 lekësh, u vlerësua që shuma e pretenduar nga subjekti si kursime *cash* (500.000 lekë), nuk do të përcillet si gjendje në analizën vijuese të periudhës së rivlerësimit gusht 2008 – dhjetor 2016. Për pasojë, Kolegji nuk ka llogaritur gjendje *cash* të akumuluar në vitin 2008, por ka vijuar me llogaritjen e mundësisë së krijimit të gjendjes *cash* pas këtij viti, me të ardhurat e provuara se janë krijuar në vitet pasardhëse.

**15.8** Për të verifikuar këto mundësi kursimi, nga Kolegji u morën në konsideratë të ardhurat e krijuara prej babait të subjektit e nënës së tij që nga gushti i vitit 2008, kohë kur subjekti ka filluar të ushtrojë funksionin e prokurorit, deri në vitin 2016, si edhe çdo shpenzim i llogaritshëm për personat e lidhur, shpenzime jetese apo shpenzime të tjera të dokumentuara të cilat gjejnë pasqyrim në analizën financiare, përfshirë trajtimin si të hyra të shumave të huave

dhënë motrave të subjektit, për të cilat do të ketë një analizë të dedikuar në vijim të këtij arsytimi. Kjo analizë e kryer prej Kolegjit me të njëjtat standarde dhe metodologji që kryhet për subjektet deklaruese para fillimit të deklarimit, duke vlerësuar mundësinë potenciale për kursim në mënyrë akumulative, për sa kohë që në mungesë të detyrimit ligjor për deklarimin e gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore, nuk ka të dhëna të tjera që mund të afektojnë analizën financiare, prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultuan se kishin mundësi kursimi në shumën (+) 4.603.818 lekë.

**15.9** Në përfundim të analizës së mësipërme, për pasurinë “garazh” të blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2016, Kolegji konkludon se nga verifikimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie, nëpërmjet të ardhurave të krijuara në vite nga personi i lidhur, të cilat u vlerësuan sipas parimit të një *cash*-i kumulativ, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur justifikonin krijimin e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

- 16** Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimet në ankim të subjektit, *me të cilat ai kundërshton si jo të drejta dhe të bazuara në ligj konkluzionet e Komisionit për llogarinë dyemërore në Bankën BKT, në shumën 3.000.000 lekë, e cila figuron në emër të nënës dhe subjektit të rivlerësimit, për të cilën analizon sa vijon.*

**16.1** Në vendimin e Komisionit për llogarinë bankare dyemërore në Bankën BKT, është konkluduar sa vijon:

*Në përfundim, edhe pas përfshirjes në analizë të shumës 1.000.000 lekë, sërish subjekti dhe familjarët e tij nuk justifikojnë me të ardhura të ligjshme depozitimin e të gjithë shumës prej 3.000.000 lekësh, pasi rezulton një pamundësi financiare në shumën 1.535.633,97 lekë. Për sa më sipër, subjekti nuk arriti të provojë se ai dhe familjarët e tij kishin të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e plotë të llogarisë së kursimit dyemërore të tij dhe nënës së tij në BKT. Si rrjedhojë, subjekti dhe personi i lidhur me të kanë mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e llogarisë së kursimit në BKT, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**16.2** Për këtë llogari bankare, subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se as nuk ka krijuar dhe as gëzon asnjë pjesë të kësaj shume, e cila u krijua që në vitin 2005 prej nënës së tij dhe u rivendos në depozitë dyemërore në vitin 2012, tek e cila subjekti kishte vetëm të drejtën e tërheqjes se shumave me autorizim të nënës së tij. Subjekti thekson se shuma e kredituar në këtë llogari daton rreth tre vjet para emërimit të tij si prokuror dhe se ai nuk ka asnjë të drejtë pronësie apo kontribut në krijimin e kësaj llogarie, që provon faktin se nuk ka interesa pasurorë lidhur me të. Në drejtim të analizës financiare për kontrollin e burimeve të krijimit të kësaj llogarie, subjekti i rivlerësimit kërkon të konsiderohet fakti që nuk ka pasur detyrim për të deklaruar për nënën në deklaratat periodike të pasurisë, dhe specifikon që në analizë duhet të përfshihen: (i) gjendja e kursimeve në *cash* e babait të tij, e krijuar nga data e emërimit në detyrë deri më 30.03.2012; (ii) tërheqjet nga banka në vitin 2008, në shumën 1.009.076 lekë; (iii) tërheqja në datën 30.03.2012; në shumën 574.280 lekë; si dhe (iv) huatë e kthyera nga motrat, në shumën 45.000 euro.

**16.3** Kolegji konstaton se për llogarinë në Bankën BKT<sup>18</sup>, subjekti i rivlerësimit, në deklaratimet që ka bërë në deklaratën *vetting*<sup>19</sup>, si dhe në DPV-në e vitit 2012<sup>20</sup>, ka shpjeguar se fondet e saj e kanë burimin nga fondet e një llogarie tjetër bankare të nënës së subjektit, të krijuar që në vitin 2005, si dhe nga kursimet nga të ardhurat e punës së babait, duke specifikuar se emri i subjektit në këtë llogari, është futur si person që ka të drejtë të tërheqë shumën. Subjekti ka bërë të njëjtat deklarime edhe në vitet vijuese, duke qenë konsekuent qoftë në drejtim të të drejtave të tij mbi këtë depozitë, qoftë në drejtim të mënyrës së krijimit të saj.

**16.4** Llogaria objekt kontrolli me nr. {\*\*\*}, nën emërtimin “M. ose Bledar Maksuti”, tek e cila është kryer derdhja në vitin 2012, ka si “numër klienti” – {\*\*\*}, me të cilin Banka BKT identifikon znj. M. M.. Po të njëjtin “numër klienti” (referencë numerike) {\*\*\*}, rezulton se ka edhe numri i llogarisë tek e cila kreditohet pensioni i pleqërisë i nënës së subjektit, znj. M. M.. Ky fakt dëshmon se M. M. është titullari i parë i llogarisë së përbashkët me djalin e saj Bledar Maksuti dhe u jep besueshmëri deklaratimeve konsistente të subjektit rreth të drejtave të tij në këtë llogari.

**16.5** Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar që fillimisht ajo e ka burimin nga një llogari e nënës, e çelur që në vitin 2005, pas transaksionit të shitjes së apartamentit në Peshkopi dhe më pas është kredituar me fondet e kursimeve nga të ardhurat e babait. Kjo shumë ka qenë e derdhur që në vitin 2005, por një pjesë u tërhoq për të ndihmuar të afërmit. Lidhur me këtë depozitë, Kolegji konstaton se gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet për pyetësorin e datës 01.06.2020, ka paraqitur librezën e depozitës në Bankën BKT, të çelur në vitin 2005, në të cilën evidentohen veprimet si vijon: në datën 6.9.2005, është kredituar shuma 500.000 lekë; në datën 8.9.2005, është kredituar shuma 2.300.000 lekë; në datën 06.07.2006, është tërhequr shuma 1.000.000 lekë; në datën 21.11.2007, është tërhequr shuma 500.000 lekë; në datën 27.11.2008, është

---

<sup>18</sup> Sipas të dhënave të akteve të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, konstatohet se nga praktika e përcjellë nga Banka BKT, rezulton se më datë 30.03.2012, pranë kësaj banke është hapur një llogari e përbashkët në emër të subjektit dhe të nënës së tij, duke depozituar në “cash”, shumën 3.000.000 lekë. Nga aktet e sjella me këtë praktikë, rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit M. M. ka hapur në emër të saj, më datë 06.09.2005, në degën e BKT Peshkopi, një depozitë në monedhën lekë, me nr. {\*\*\*}, tek e cila rezulton të jetë kredituar në vlera të ndryshme, ndër të tjera, edhe vlera 2.300.000 lekë, më datë 08.09.2005, që subjekti i shpjegon se janë vlerat e siguruara nga shitja e apartamentit të familjes së tij në Peshkopi në këtë vit. Nga kjo depozitë bankare, rezulton të jenë kryer tërheqje dhe kreditime të ndryshme nga nëna e subjektit deri në datën 30.03.2012, kur ajo është mbyllur. Nga analizimi i llogarisë fillestare të depozitës së hapur në Peshkopi nga nëna e subjektit, vërehet se tërheqjet prej saj ndër vite arrijnë në shumën rreth 2,8 milionë lekë dhe në momentin e fundit, kur është mbyllur, rezulton që nëna ka tërhequr vlerën e mbetur prej 574.280 lekësh. Në vijim Banka BKT (Dega “{\*\*\*}”), në praktikën e sjellë ka përcjellë edhe të dhëna për llogarinë nr. {\*\*\*}, me emër M. M., në krah të së cilës jepet IBANI, duke u shprehur se kjo llogari është në monedhën “Lekë” dhe figuron në emër të dy personave, M. ose Bledar Maksuti, tek e cila figuron e kredituar më datë 30.03.2012, shuma 3.000.000 lekë.

<sup>19</sup> Në deklaratën “vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Llogari kursimi me interes në BKT Bank, në emër të nënës M. M.. Llogaria është hapur më datë 30.03.2012 dhe është bërë nga llogaria e mëparshme e nënës në të njëjtën bankë, plus kursimet nga të ardhurat e punës së babait. Është futur emri im si person që ka të drejtë të tërheqë shumën. Kjo shumë ka qenë derdhur që në vitin 2005, por u tërhoq një pjesë për të ndihmuar njerëz të afërm dhe u depozitua përsëri. Gjendja aktuale në llogari, sipas statement-it të datës 24.01.2017, është 3.034.646 lekë”.

<sup>20</sup> Në deklaratën periodike të vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “Llogari kursimi me interes në BKT Bank, në emër të nënës M. M.. Llogaria është hapur më datë 30.03.2012 dhe është bërë nga llogaria e mëparshme e nënës në të njëjtën bankë, plus kursimet nga të ardhurat e punës së babait. Është futur emri im si person që ka të drejtë të tërheqë shumën. Kjo shumë ka qenë derdhur që në vitin 2005, por u tërhoq një pjesë për të ndihmuar njerëz të afërm dhe u depozitua përsëri. Gjendja aktuale është 3.000.000 lekë”.

tërhequr shuma 1.009.076 lekë; në datën 30.3.2012, mbyllet llogaria në BKT, duke u tërhequr shuma e mbetur prej 574.280 lekësh.

**16.6** Në analizë të fakteve të renditura si më lart, lidhur me llogarinë dyemërore në Bankën BKT, Kolegji arriti në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni për sa u përket të drejtave të subjektit në këtë llogari, duke konkluduar se vetëm pasja e emrit të tij si një prej titullarëve të llogarisë, nuk provon bashkëpronësinë e tij mbi të, por në këndvështrim të të gjithë rrethanave, krijohet bindja se subjekti deklaroi të vërtetën rreth përkatësisë së nënës së tij mbi këtë pasuri. Për të arritur në këtë konkluzion, Kolegji mbajti parasysh se: (i) subjekti ka deklaruar këtë rrethanë që në vitin 2012 e në vijim, si edhe në deklaratën *vetting*, duke bërë të njëjtat shpjegime rreth mospasjes së të drejtave të tij mbi këtë llogari; (ii) të njëjtat deklarime rreth të drejtave mbi këtë llogari ka bërë edhe nëna e subjektit me cilësinë e personit të lidhur; (iii) llogaria e ka zanafillën nga një depozitë e mëparshme, e krijuar prej nënës së tij në vitin 2005, siç rezulton nga leximi i veprimeve bankare të përshkruara më lart, me të ardhura të deklaruara nga shitja e apartamentit në Peshkopi, mbi të cilat subjekti nuk kishte të drejta të posaçme; (iv) përfshirja e emrit të subjektit si një individ që mund të kryente tërheqje të shumave nga llogari, vlerësohet e arsyeshme, konsideruar moshën e nënës së subjektit dhe faktin që ata jetojnë në të njëjtën banesë në kuadër të ndihmës e bashkëjetesës familjare; (v) përcaktimi i burimeve të krijimit të kësaj llogarie, krahas fondeve të mbetura nga depozita e mëparshme dhe nga kursimet e krijuara nga të ardhurat e babait, duke përfshirë burimet e tij personale për krijimin e kësaj pasurie; (vi) mungesën e ndonjë indicie të ngritur qoftë nga Komisioni, që tregon se subjekti nuk ka deklaruar të vërtetën dhe se kjo pasuri është një pasuri e fshehur e tij; (vii) pasjen në konsideratë se në çdo rast, edhe sikur të konsiderohej se subjekti ishte pronari i vetëm i kësaj llogarie, ai duhej të provonte burimet e ligjshme të krijimit të saj, sipas deklarimeve që ai vetë kishte bërë për këto burime, fakt që do të çonte organet e rivlerësimit në çdo version në verifikimin e të ardhurave të nënës, të gjeneruara nga depozita e hapur në vitin 2005, në vlerën prej 574.280 lekësh, e cila është bërë pjesë e depozitës së hapur në vitin 2012, si edhe verifikimi i mundësisë së prindërve për të krijuar me burime të ligjshme, sipas vlerësimit të një *cash*-i kumulativ/kursimet, në shumën prej 2.424.720 lekësh.

**16.7** Për sa më sipër, Kolegji verifikoi burimet e ligjshme të krijimit të kësaj llogarie, duke konsideruar si pronare të vetme të llogarisë, nënën e subjektit, e cila e ka krijuar atë me burim nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit (babait të subjektit). Nga analiza financiare e kryer sipas këtyre konkluzioneve dhe në mbështetje të të njëjtave qëndrime të mbajtura rreth mundësisë për kursim të personave të lidhur të arsyetuar më sipër, rezultoi se prindërit e tij kishin mundësi të krijonin me burime të ligjshme shumat monetare të depozituara në depozitën në Bankën BKT, më datë 30.03.2012.

**16.8** Në përfundim të kësaj analize lidhur me llogarinë dyemërore në Bankën BKT, në shumën 3.000.000 lekë, e cila figuron në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të nënës së tij, Kolegji arriti në konkluzionin se kjo pasuri është krijuar me të ardhura të prindërve të subjektit të rivlerësimit, si dhe është deklaruar në deklaratat periodike vjetore prej subjektit, dhe nga analiza financiare e tyre rezultoi se ata kishin mundësi të krijonin këtë pasuri me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

17 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se llogaria e krijuar më datë 14.01.2017, në Bankën BKT, në vlerën 1.000.000 lekë, në emër të subjektit dhe të bashkëshortes, duhet të ngelet jashtë kontrollit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, pasi ajo është krijuar si kontribut i familjes së origjinës së bashkëshortes para martese, për të cilën gjithashtu provohet burimi i ligjshëm i krijimit, nga të ardhurat e familjes së origjinës së bashkëshortes, Kolegji analizon sa vijon:

17.1 Në vendimin e Komisionit lidhur me llogarinë në emër të bashkëshortes së subjektit në Bankën BKT, me vlerë 1.000.000 lekë, është konkluduar se:

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij, konstaton se nga dokumentacioni provohet që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka pasur të ardhura të konsiderueshme, po ashtu edhe babai i bashkëshortes së subjektit ka lëvizje bankare në vlera të konsiderueshme, duke u provuar në këtë mënyrë të ardhurat e tij, por ndërkohë subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me këto burime financiare. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë bankare në BKT. Si rrjedhojë, subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e llogarisë bankare në BKT, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

17.2 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se gjendja e llogarisë bankare në Bankën BKT, në shumën 1.000.000 lekë, nuk duhet t’i nënshtrohet analizës në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, edhe në këtë rast, ashtu siç ka argumentuar më lart në këtë vendim, Kolegji vlerëson se ky është një pretendim i pabazuar i subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i kontrollit në funksion të këtij procesi janë të gjitha pasuritë e burimet e krijimit të tyre, të personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit e të deklaruar si të tilla në deklaratën e pasurisë *vetting*. Llogaria bankare e bashkëshortes dhe e subjektit të rivlerësimit, duke qenë një nga llojet e pasurive të parashikuara nga ligji, do të duhet t’i nënshtrohet verifikimit e kontrollit të burimeve të krijimit të saj, sipas parashikimit të dispozitës së cituar më lart. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se kjo shumë është krijuar para martese dhe nuk është përdorur për të krijuar pasuri, janë elemente që Kolegji do t’i vlerësojë mbi bazën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, në raport me peshën/ndikimin që ajo do të ketë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit.

17.3 Për llogarinë bankare në Bankën BKT<sup>21</sup> në emër të bashkëshortes dhe të subjektit të rivlerësimit, të çelur më datë 14.01.2017, ai dhe personi i lidhur kanë deklaruar:

- Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Llogari kursimi në BKT, në vlerën 1.000.000 lekë. Burimi: Të ardhura të dhëna nga familja e bashkëshortes nga babai dhe nëna e saj para martese, si dhe para të grumbulluara si dhurata pas lindjes së tre fëmijëve. Shuma prej 800.000 lekësh është deklaruar që në vitin 2011. Këto para janë derdhur në një llogari të përbashkët me bashkëshorten, E. M., në Bankën BKT.*

---

<sup>21</sup> Në lidhje me llogarinë e kursimit pranë Bankës BKT, në shumën 1.000.000 lekë, nga ana e subjektit është depozituar mandatarkëtimi i datës 23.01.2017, pranë BKT-së, si dhe nxjerrja e llogarisë më datë 24.01.2017. Shuma fillimisht është derdhur nga subjekti i rivlerësimit në emër të tij dhe më pas është transferuar në një llogari të përbashkët me bashkëshorten. Burimi i krijimit sipas deklaramit në DVP-në e vitit 2011, si dhe në deklaratën “*vetting*”, sipas subjektit të rivlerësimit, ka qenë dhurime nga prindërit e bashkëshortes.

- Në DVP-2011, personi i lidhur ka deklaruar: *Para cash të kursyera, të dhëna nga prindërit, në shumën 800.000 lekë, si dhe llogari bankare në Bankën Credins, dhënë nga nëna si dhuratë në vitin 2010, rreth 1.100.000 lekë.*

**17.4** Në drejtim të verifikimit të burimeve të krijimit të kësaj shume, me burim të deklaruar 800.000 lekë të ardhura nga prindërit e bashkëshortes dhe 200.000 lekë dhuratë për ditëlindjet e fëmijëve ndër vite, Kolegji konstaton se burimi i dytë i identifikuar prej subjektit, dhuratat për fëmijët, përfaqëson një deklaram të bërë rishtas, në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe nuk mbështet nga asnjë deklaram i mëparshëm i tij apo nga ndonjë dokument ligjor që të provojë këtë fakt. Për pasojë, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit se ky burim i deklaruar mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar, për pasojë kjo shumë nuk do të llogaritet si një e ardhur e ligjshme për krijimin e llogarisë bankare të personit të lidhur.

**17.5** Kolegji kontrollon burimin tjetër të deklaruar prej subjektit dhe personit të lidhur se ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën prej 800.000 lekësh, që vjen nga të ardhurat e familjes së origjinës së bashkëshortes së tij. Në ankim, subjekti pretendon që mundësia për krijimin e shumës 800.000 lekë me burime të ligjshme, të përlllogaritet duke konsideruar: **(i)** veprimtarinë që ka kryer babai i bashkëshortes, si agjenci e shërbimeve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; **(ii)** të konsiderojë të ardhurat e siguruara nga vjehri i tij nga interesat dhe konvertimet e kryera në sistemin bankar; **(iii)** të ardhurat nga pagat e evidentuara në praktikën e sjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; si dhe **(iv)** marrjen/disponimin e një shume parash hua prej vjehrit nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, tek e cila ai ishte administrator, veprim ky i evidentuar në pasqyrat financiare të vitit 2006-2007.

**17.6** Nga të dhënat e fashikullit të hetimit administrativ, rezulton se Komisioni ka hetuar duke administruar dokumentacionin dhe informacionin<sup>22</sup> lidhur me aktivitetet private dhe të ardhurat

<sup>22</sup> Shtetasi N. D. (babai i znj. E. M.), figuron:

o Sipas QKB-së, rezulton se si administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, datë regjistrimi 20.01.1995, me NIPT {\*\*\*}; administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, i regjistruar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 5.02.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT; administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, i regjistruar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 1.7.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT.

o Përfaqësues ligjor në subjektin “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, i cili nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në QKB.

o Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.12.2020, nuk ka konfirmuar asnjë të ardhur për shoqëritë e mësipërme.

o Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.12.2020, ka informuar që fitimi i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 2008 – 2013, është 0 (zero), si dhe ka informuar mbi pagat e përfituara nga N. D. nga janari i vitit 2012 e në vijim.

o Në fashikull, disponohen statement-et e llogarive bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pranë “Union Bank”, në monedhën Euro, USD dhe Lekë, për periudhën 01.01.2006 deri më 31.12.2010. Rezulton se në llogaritë bankare të shoqërisë janë kryer transaksione të vazhdueshme, si kreditime dhe debitime në shuma të konsiderueshme në euro, të cilat janë kredituar nga {\*\*\*} ({\*\*\*}). Mënyra e operimit të {\*\*\*}-së bazohet në marrëveshjen midis saj dhe agjentëve {\*\*\*}, të cilët ofrojnë shërbimet e transfertave të parave nëpërmjet {\*\*\*} dhe përfituesve. Subjekti “{\*\*\*}” ShPK ka ofruar shërbimin {\*\*\*} si agjent i {\*\*\*}, duke kryer transferta për përfituesit, për të cilat është rimbursuar nga {\*\*\*}. Subjekti “{\*\*\*}”, në këtë rast agjenti, ka përdorur gjendjen e tij cash për të paguar klientët marrës/pritës të {\*\*\*} dhe pas rakordimit, {\*\*\*}-ja ia ka rimbursuar agjentit këto shuma, të cilat pasqyrohen në statement-et e llogarive bankare pranë “Union Bank”, kryesisht në monedhën



e prindërve të bashkëshortes së subjektit. Lidhur me këto të dhëna, në vendimin e Komisionit evidentohet se pasi janë analizuar shpjegimet e subjektit dhe dokumentacioni i depozituar prej tij, konstatohet se nga dokumentacioni provohet që shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka pasur të ardhura të konsiderueshme, po ashtu edhe babai i bashkëshortes së subjektit ka lëvizje bankare në vlera të konsiderueshme, duke u provuar në këtë mënyrë të ardhurat e tij, por ndërkohë subjekti nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me këto burime financiare. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e llogarisë bankare në Bankën BKT sipas standardit të të ardhurës së ligjshme, të parashikuar nga pika 19 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

**17.7** Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon që vjehri i tij, z. N. D.: **(i)** ka pasur llogari depozitë pranë Bankës BKT, në monedhën USD, në të cilën konstatohet që ka disa transaksione me anë të të cilave blen euro dhe me vonë i shet, duke blerë USD, veprime që kanë filluar që nga shtatori i vitit 2005, dhe në periudha të ndryshme ka fituar si nga konvertimet, ashtu dhe nga interesat e depozitave; **(ii)** ka realizuar të ardhura dhe nga paga neto sipas vërtetimit të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.03.2021; dhe se **(iii)** nga Kolegji duhet të merret në konsideratë që nga llogaritë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. N. D. ka tërhequr shumën 1.148.118 lekë, e cila është e kontabilizuar në zërin e aktiveve, me emërtimin “Të tjera kërkesa”, të cilat duhet të konsiderohen si të ardhura.

**17.8** Kolegji, pasi mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit në raport me faktet që kanë rezultuar nga aktet e administruara nga hetimi administrativ në Komision, në funksion të verifikimit të mundësisë së prindërve të bashkëshortes së subjektit, që t’i dhuronin asaj

---

*Euro. Nga shqyrtimi i llogarive bankare, rezulton se shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka pasur një qarkullim vjetor nga 200.000 euro deri në 1.500.000 euro/vit.*

*○ Vërtetimi me nr. {\*\*\*}, datë 26.3.2021, lëshuar nga {\*\*\*} Tiranë, nëpërmjet të cilit konfirmohen komisionet e përfituara nga subjekti “{\*\*\*}” ShPK, në kuadrin e shërbimit {\*\*\*}, të ofruar nga subjekti si agjent i {\*\*\*} ShA, për periudhën janar 2002 – shkurt 2010. Komisionet e përfituara nga subjekti “{\*\*\*}” ShPK për periudhën 2002 – 2004, janë në total në shumën 87.695,92 USD, ndërsa për periudhën 2004 – 2010, janë në shumën 136.320,52 euro.*

*○ Në fashikull disponohen të dhëna mbi llogaritë personale të z. N. D. pranë Bankës Kombëtare Tregtare në monedhën USD, Euro dhe Lekë. Nga transaksionet që pasqyrohen në statement-et bankare të këtyre llogarive, konstatohet se ka një sërë transaksionesh të kryera nëpërmjet sistemit bankar, të cilat konsistojnë në konvertime shumash, si dhe çelje depozitash me afate të shkurtra, për të cilat është përfitur interes bankar. Këto transaksione janë kryer gjatë periudhës shtator 2005 deri në mars 2008. Sipas Komisionit, në periudha të ndryshme ka përfitur edhe të ardhura nga interesat për depozitat e krijuara. Fitimet nga kursi i këmbimit dhe të ardhurat nga interesat janë tërhequr në datën 29.03.2007, në shumën 30.000 USD.*

*○ Vërtetimi me nr. {\*\*\*}, datë 30.03.202, i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, dega Rajonale Shkodër, e cila konfirmon pagesën e sigurimeve shoqërore për shtetasin N. D. nga subjekti tatimor “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën prill 2003 deri në gusht 2004, tetor 2004 deri në dhjetor 2005, janar 2008 deri në shkurt 2009, korrik 2009 deri në gusht 2009, tetor 2009 deri në dhjetor 2009.*

*○ Në fashikull disponohen dy pasqyra financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, të vitit 2006 dhe 2007, në të cilat rezulton se në vitin 2005, shoqëria ka realizuar një fitim para tatimit prej 121.104 lekësh, në vitin 2006 ka realizuar një fitim pas tatimit prej 240.000 lekësh dhe në vitin 2007, ka realizuar një fitim pas tatimit në shumën 380.856 lekë. Nga pasqyrat financiare, nuk rezulton që shoqëria të ketë shpërndarë dividend në këto vite. Në pasqyrat financiare është konstatuar në aktiv, zëri me emërtimin “Të tjera kërkesa”, në vlerën 1.148.118 lekë, që përfaqëson tërheqjet e ortakut nga likuiditetet e shoqërisë.*

shumën prej 800.000 lekësh, nën dritën e parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, arriti në konkluzionet e mëposhtme.

(i) Për sa u përket të ardhurave që prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë përfituar nga pagat, Kolegji duke iu referuar të dhënave të shkresës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. {\*\*\*} prot., datë 30.03.2021, kreu përlllogaritjen<sup>23</sup> e tyre dhe vlerat e evidentuara i përfshiu në analizën ekonomike si të ardhura të familjes {\*\*\*} në funksion të evidentimit të burimeve të ligjshme të shumës 800.000 lekë që kanë krijuar depozitën e subjektit dhe të bashkëshortes në Bankën BKT më datë 14.01.2017.

(ii) Nga analizimi i llogarive bankare të z. N. D. pranë Bankës BKT, rezulton se përgjatë periudhës 2005-2008, prej tij janë kryer shumë transaksione me qëllim shitblerjen në monedha të huaja apo konvertime të parave të disponuara nga ky individ në llogarinë bankare, me kurse preferenciale të ofruara nga vetë Banka BKT, prej të cilave janë krijuar të ardhura, të evidentuara edhe nga Komisioni në vendim. Të ardhurat e gjeneruara nga konvertimet<sup>24</sup>, të cilat janë kryer nëpërmjet sistemit bankar, Kolegji i vlerëson se janë të ardhura të krijuara nga transaksione të ligjshme brenda sistemit bankar, por për to mungon shlyerja e detyrimeve tatimore mbi fitimin e gjeneruar, për pasojë nuk mund të llogariten si të ardhura të ligjshme sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

(iii) Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton gjithashtu se përveç të ardhurave nga konvertimet, nga *statement*-et e llogarive bankare të Bankës BKT, z. N. D. ka krijuar të ardhura edhe nga interesat e depozitave afatshkurtra, në vlerën prej 1.525.441 lekësh<sup>25</sup>, për të cilat vetë banka, në momentin e maturimit të tyre, aplikon tatimin në burim, të cilat janë tërhequr prej tij para vitit 2011, vit kur deklarohet dhënia e shumës prej 800.000 lekësh. Të ardhurat e krijuara nga interesat e depozitave afatshkurtra, në të cilat janë depozituar paratë e disponuara prej z. N. D., të krijuara prej veprimtarisë së tij të ligjshme të konvertimit, siç edhe vetë Komisioni pranon në vendimin e tij, janë të vetmet të ardhura të cilat plotësojnë në kuptim të standardit ligjor, edhe kushtin e burimit të ligjshëm, por edhe atë të pagimit të detyrimeve tatimore, duke qenë se vetë banka vepron si agjent tatimor dhe e mban në burim detyrimin përkatës. Kjo vlerë monetare, e gjeneruar nga sistemi bankar, për shkak të interesit mbi depozitat e kredituara me shuma që vijnë nga burime të ligjshme, e cila i është nënshtruar gjithashtu regjimit të mbajtjes në burim të detyrimit tatimor, konsiderohet prej Kolegjit se i plotëson kriteret e së ardhurës të ligjshme, në kuptim të parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, dhe duhet të llogaritet si e tillë në analizën financiare që bëhet për verifikimin e burimeve të ligjshme të prindërve të personit të lidhur për dhurimin e shumës prej 800.000 lekësh. Në këtë konkluzion, Kolegji mban në konsideratë edhe faktin se kontrolli ushtrohet për prindërit e bashkëshortes së subjektit, për periudhën 2005-2008, ndërsa vetë martesë e subjektit me bashkëshorten ka

<sup>23</sup> Nga kjo përlllogaritje, Kolegji konstatoi se prindërit e bashkëshortes së subjektit, në vitin 2003 kishin të ardhura neto nga paga, në shumën 80.148 lekë; në vitin 2004, në shumën 105.617 lekë; në vitin 2005, në shumën 126.275 lekë; në vitin 2008, në masën 346.320 lekë; dhe në vitin 2009, në shumën 202.020 lekë.

<sup>24</sup> Sipas Komisionit, në periudha të ndryshme, z. N. D. ka përfituar fitimet nga kursi i këmbimit dhe të ardhurat nga interesat janë tërhequr në datën 29.3.2007, në shumën 30.000 USD.

<sup>25</sup> Kolegji ka përlllogaritur të ardhurat e siguruara nga interesat e këtyre llogarive bankare të babait të bashkëshortes së subjektit për periudhën 2005-2008, të cilat arrijnë në vlerën totale prej 1.525.441 lekësh.

ndodhur në vitin 2011, rrethana që përcaktojnë edhe peshën apo ndikimin që konkluzionet mbi standardet e aplikuara duhet të kenë mbi procesin e rivlerësimit të subjektit.

**17.9** Nga analiza e të dhënave që lidhen me aktivitetin e z. N. D., konstatohet se *statement*-et bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, të disponuara në fashikullin e hetimit administrativ, konfirmojnë lëvizje të konsiderueshme të shumave monetare përgjatë periudhës 2006-2010 (sipas Komisionit, nga shqyrtimi i llogarive bankare, rezulton se shoqëria ka pasur një qarkullim vjetor nga 200.000 euro deri në 1.500.000 euro/vit). Pasqyrat financiare për vitet 2006 dhe 2007, si të vetmet të disponuara për këtë shoqëri në fashikullin e hetimit administrativ, tregojnë që ajo nuk ka shpërndarë dividend përgjatë këtyre dy viteve, pavarësisht se aktiviteti i saj ka rezultuar me fitim. Gjithashtu, nga pasqyrat financiare të kësaj shoqërie, konstatohet se në aktivin e bilancit, është zëri “Të tjera kërkesa”, i cili në fund të vitit ushtrimor 2007, ka vlerën 1.148.118 lekë. Ky post në aktivin e bilancit të shoqërisë, duket se përfaqëson një të drejtë që ka shoqëria ndaj ortakut të saj për shumën e të hollave të tërhequra prej tij. Sipas leximit të kësaj të dhëne që vjen nga bilanci i shoqërisë, rezulton se nga llogaritë e shoqërisë, ortakut i saj i vetëm ka tërhequr likuiditetet në vlerën 1.148.118 lekë, vlerë e cila për shkak të mungesës së pasqyrave financiare për vitet në vijim, nuk mund të saktësohet nëse është kredituar përsëri për llogari të shoqërisë duke shuar të drejtën e shoqërisë ndaj ortakut apo shoqëria ka shpërndarë fitimin e akumuluar ndër vite, për të cilin është paguar tatim fitimi në vitet përkatëse. Nëse shoqëria do të kishte shpërndarë fitim, detyrimisht do të kishte paguar në favor të organeve tatimore dhe detyrimet për shpërndarjen e dividendit, dhe ky veprim do të ishte kontabilizuar në pasqyrat financiare të shoqërisë, duke shuar të drejtën e saj ndaj ortakut. Tërheqja e shumave nga likuiditetet e shoqërisë nga ana e ortakut, është një transaksion i mundshëm që aplikohet gjatë aktivitetit të njërive ekonomike, i cili gjen pasqyrim në regjistrat kontabël të shoqërisë, por meqenëse dhurimi i shumës prej 800.000 lekësh deklarohet nga bashkëshortja e subjektit në vitin 2011, shuma e pretenduar nga subjekti si e përdorur për këtë qëllim, me burim aktivitetin e shoqërisë, nuk mund të merret në konsideratë, për shkak të mungesës së pasqyrave financiare të viteve pasardhëse, në mënyrë që të lexohej qartë çfarë ka ndodhur me këtë detyrim të pasqyruar në aktivin e bilancit të vitit 2007. Nëse subjekti do të kishte pretenduar se bashkëshortja e ka përfutur shumën në vitin 2007, kjo shifër mund të ishte një e ardhur e llogaritshme në analizën financiare të familjes së bashkëshortes, por nga aktet nuk rezulton asnjë deklaram i tillë, për pasojë, Kolegji e gjen këtë pretendim të subjektit të pambështetur në prova.

**17.10** Nga sa evidentuar më sipër, duke iu referuar të ardhurave të gjeneruara nga z. N. D. nga depozitat dhe pagat për periudhën 2005-2008 (*periudha gjatë së cilës janë krijuar interesat nga depozitat*), Kolegji kreu dhe një analizë financiare<sup>26</sup>, me qëllim identifikimin e mundësisë financiare të prindërve të bashkëshortes së subjektit për dhurimin e shumës 800.000 lekë. Nga kjo analizë financiare, duke konsideruar si të ardhura të ligjshme vetëm ato nga pagat dhe të ardhurat nga interesat bankarë, rezultoi se personat e tjerë të lidhur kishin mungesë të burimeve

---

<sup>26</sup> Për kryerjen e kësaj analize, Kolegji u bazua në të dhënat mbi të ardhurat nga pagat të familjes D., të ardhurat e siguruara nga z. N. D. nga interesat e depozitave bankare dhe mbi to aplikoi shpenzimet e jetesës për person sipas ILDKPKI-së. Nga kjo analizë, rezultoi se mundësia financiare e familjes D. në vitin 2008, rezultoi me diferencë negative prej (-) 94.924 lekësh, për krijimin/dhurimin e shumës 800.000 lekë vajzës E. D.

të ligjshme për të justifikuar krijimin e shumës prej 800.000 lekësh, në vlerën prej (-) 94.924 lekësh.

**17.11** Kolegji e vlerësoi këtë rezultat në zbatim të parimit të objektivitetit, duke konsideruar disa elemente specifike të rastit, të cilat përcaktojnë edhe qëndrimin për të konsideruar se subjekti dhe personi i lidhur provuan bindshëm burimet e ligjshme të prindërve të bashkëshortes për t'i dhuruar asaj shumën prej 800.000 lekësh para martesës. **Së pari**, nga analiza financiare e kryer duke përdorur vetëm të ardhurat e ligjshme të konsideruara sipas standardit të ligjit nr. 84/2016 dhe shpenzimet jetike të përballuara prej këtyre të ardhurave, sipas jurisprudencës së konsoliduar tashmë të Kolegjit, rezultoi se personat e tjerë të lidhur kishin balancë negative për një vlerë që nuk afekton, në vlerësimin e Kolegjit, të gjithë shumën e dhënë hua për shkak të peshës/raportit që ajo ka me këtë shumë, sipas një metodologjie të përdorur prej Kolegjit edhe në raste të tjera<sup>27</sup>. **Së dyti**, analiza e situatës financiare të prindërve të bashkëshortes i përket periudhës para se subjekti të martohej me të, dhe konsiderohet jo objektive të ngarkohet me barrë subjekti i rivlerësimit për pasuri të krijuara prej kësaj kategorie personash, në një kohë kur ai nuk kishte me ta asnjë lloj marrëdhënieje që do t'i detyronte ata apo vetë subjektin të ishte i vëmendshëm rreth standardit të së ardhurës së ligjshme sipas parashikimit të ligjit nr. 84/2014. **Së treti**, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, konstaton se familja e bashkëshortes ka pasur një qarkullim të konsiderueshëm parash në këtë periudhë në sistemin bankar, nga e cila ka gjeneruar edhe fitim sipas dokumentacionit bankar, në vlera që do të justifikonin disa herë dhurimin e shumës prej 800.000 lekësh vajzës së tyre, situatë e cila ndikon në vlerësimin e analizës financiare që u bëhet burimeve të tyre me një rezultat negativ të pakonsiderueshëm në këto rrethana. Në këtë kontekst, rezultati financiar i dalë nga analiza e bërë si më lart përshkruar, do të duhet të vlerësohet në mënyrë të arsyeshme dhe të logjikshme për të pasur një konkluzion që i afrohet të vërtetës procedurale, por edhe asaj jetësore. **Së katërti**, dhurimi i një shume të tillë nga prindërit, me aktivitet ekonomik që prodhon të ardhura të konsiderueshme, te fëmija, vlerësohet i besueshëm dhe brenda arsyes e logjikës së rrethanave të rastit.

**17.12** Për sa më lart arsyetuar, për llogarinë në Bankën BKT, në vlerën 1.000.000 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, Kolegji, në analizë të të ardhurave të krijuara prej babait të bashkëshortes në vite, konkludoi se ai arrin të justifikojë krijimin me të ardhura të ligjshme të shumës prej 800.000 lekësh, dhuruar vajzës së tij. Për pasojë, subjekti dhe bashkëshortja e tij gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme vetëm për shumën prej 200.000 lekësh, deklaruar se janë dhuruar me rastin e lindjes së fëmijëve, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 18** Lidhur me pretendimet e subjektit se për llogarinë në Bankën BKT, në shumën 3.116.878 lekë, në emër të babait të tij: *se ai nuk mund të ngarkohet me barrë prove dhe përgjegjësi për pasuri individuale të babait, mbi të cilën ai nuk ka asnjë të interes dhe të drejta pasurore dhe për më tepër që për këtë llogari provohet krijimi, me burime të ligjshme nga kursimet cash të babait, sipas mundësisë së tij për kursim*, Kolegji analizon sa vijon:

**18.1** Në vendimin e Komisionit për llogarinë në Bankën BKT, në shumën 3.116.878 lekë, në emër të babait të subjektit, është konkluduar se: *Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit,*

<sup>27</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023; nr. 15/2023 (JR), datë 13.04.2023.

vlerëson se ato nuk janë të mbështetura në ligj dhe në prova. Babai i subjektit, edhe sikur të merret hipotetikisht që ka pasur kursime cash ndër vite, nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 2.700.000 lekë. Në lidhje me të drejta reale apo të pronësisë, Komisioni vlerëson se konstatimi i subjektit është i drejtë, por ndërkohë babai i tij është në përbërjen e certifikatës familjare dhe, për rrjedhojë, konsiderohet person i lidhur. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për depozitimin e shumës 2.700.000 lekë nga babai i tij. Si rrjedhojë, babai i subjektit ka mungesë të burimeve të ligjshme për depozitimin e shumës 2.700.000 lekë në datën 24.1.2017, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016

**18.2** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se meqenëse nuk provohet se ai ka të drejta reale dhe pasurore mbi llogarinë bankare në Bankën BKT në emër të babait të tij, ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi lidhur me të, Kolegji, në referim të konkluzioneve të dhëna më sipër në këtë vendim, në kushtet kur babai i subjektit është person i lidhur me të sipas parashikimeve të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se edhe kjo pasuri e tij do të jetë objekt kontrolli në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, për të cilën duhet të provojë burimet e ligjshme të krijimit të fondeve që kanë furnizuar këtë llogari bankare.

**18.3** Në deklaratën *vetting*, babai i subjektit P. M. ka deklaruar se disponon llogarinë e pensionit të tij në Bankën BKT<sup>28</sup>, me nr. IBAN {\*\*\*}, me gjendje aktuale në vlerën prej 3.116.878.96 lekësh, e krijuar pas derdhjes së parave *cash* prej 2,7 milionë lekësh disponuara në shtëpi prej tij. Nga të dhënat bankare të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se babai i subjektit në datën 24.01.2017, ka depozituar në këtë llogari shumën 2.700.000 lekë, me përshkrimin: “Të ardhura nga puna si noter + kursime”.

**18.4** Në vlerësimin e kësaj çështjeje, Kolegji konsideroi si edhe në çështjet e mësipërme, se *cash*-i potencial i kursyer nga prindërit e subjektit, duhej të konsiderohej në kryerjen e analizës financiare për krijimin e shumës prej 2.700.000 lekësh në vitin 2016, në ndryshim nga Komisioni që ka konsideruar se për krijimin e saj, kanë shërbyer vetëm të ardhurat e prindërve përgjatë këtij viti. Duke përdorur të njëjtin arsyetim si më sipër, Kolegji kreu analizën financiare për mundësinë e krijimit të kësaj shume, duke konsideruar kursimet e mundshme në vite që vijnë nga të ardhurat nga puna e personit të lidhur si noter dhe avokat dhe siç ai ka përcaktuar jo vetëm në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe në përshkrimin e bërë në depozitimin në bankë të shumës, si edhe huatë e kthyera nga motrat, të cilat do të trajtohen në vijim, nga e cila rezultoi se ata kishin mundësi që të krijonin me të ardhura të ligjshme shumën prej 2.700.000 lekësh, të depozituar në Bankën BKT, në datën 24.01.2017.

---

<sup>28</sup> Në këtë llogari evidentohen transaksionet si vijojnë:

- datë 14.08.2015, babai i subjektit ka depozituar shumën 3.000.000 lekë, të cilën në të njëjtën datë ia ka dërguar shtetasit Sh.Ll., me emërtim: “Parapagim (kapar) për blerje shtëpie karabina”;
- datë 18.12.2015 dhe 30.12.2015, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK i ka depozituar babait të subjektit, shumën totale prej 800.000 lekësh (400.000 lekë për secilin depozitim), me emërtim: “Pagesë për konsulencë dhe përfaqësi rastësore avokatie”;
- datë 24.01.2017, babai i subjektit ka depozituar shumën 2.700.000 lekë, me përshkrimin: “Të ardhura nga puna si noter + kursime”;
- datë 24.01.2017, gjendja e kësaj llogarie është: 3.116.878,96 lekë.

**18.5** Në analizën e kryer në Kolegj për periudhën 01.08.2008 deri më 31.12.2016, sipas metodologjisë së mësipërme, vetëm për prindërit e subjektit, duke përfshirë si zëra përkatësisht: **(i) të ardhura:** shumat e përfituara nga pensionet e prindërve, aktiviteti privat i babait të subjektit, të ardhurat e siguruara nga ekzekutimi i një vendimi gjyqësor në favor të babait të subjektit, të ardhurat nga interesat bankarë të likuiditeteve bankare dhe vlerën e llogarisë së kursimit pranë Bankës BKT, në total në shumën 12.431.640 lekë; **(ii) shpenzime:** shpenzimet e jetesës sipas të dhënave të përvitshme të INSTAT-it, të përcjella në Kolegj nga ILDKPKI-ja; shpenzimet për udhëtime të përlllogaritura sipas metodologjisë së Kolegjit; shpenzime të tjera (për blerje pajisjesh elektroshtëpiake dhe shpenzimet për veprime në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme), në total në shumën 3.951.260 lekë; **(iii) pasuri dhe investime:** shumat e huave të kthyera babait të subjektit nga motrat e tij dhe i afërmi (V. M.), të cilat në total rezultuan në shumën 7.617.850 lekë; investimi për blerjen e garazhit në vitin 2016, dhe investimit i babait të subjektit për automjetin e bashkëshortes së subjektit, dhënia e huave nga babai i subjektit përkatësisht z. Sh. Ll. dhe Xh. K. në vitin 2015, në shumën totale 6.000.000 lekë; si dhe likuiditetet në bankë, në vlerën totale 4.443.897 lekë.

Nga kjo analizë ekonomike, rezultoi se prindërit e subjektit, për periudhën 01.08.2008 deri më 31.12.2016, kishin mundësi për kursime të akumuluar vit pas viti, në shumën 4.142.953 lekë.

**18.6** Për sa më sipër, lidhur me llogarinë në Bankën BKT, në shumën 3.116.878 lekë, në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, Kolegji, nga verifikimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie, nëpërmjet të ardhurave të krijuara në vite nga personi i lidhur, të cilat u vlerësuan sipas parimit të një *cash*-i kumulativ, konkludoi se subjekti dhe personi i lidhur justifikonin krijimin e saj me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

- 19** Për sa u përket pretendimeve të ankimit të subjektit në drejtim të gjendjes në *cash* “si trung familjar në shumën 1.400.000 lekë”, të deklaruar në deklaratën *vetting*, me të cilat subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit *për pamundësinë e krijimit të tyre, duke pretenduar se kjo shumë përfaqëson një pjesë të kursimeve në cash, në shumën prej 4.300.000 lekësh, që babai kishte në fund të vitit 2016, nga e cila një pjesë, 2.700.000 lekë, u derdhën në Bankën BKT dhe pjesa tjetër u mbajt si likuiditet cash në banesë*, Kolegji analizon sa vijon.

**19.1** Në vendimin e Komisionit lidhur me kursimet në *cash* prej 1.400.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, është konkluduar: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për gjendjen cash si trung familjar, në shumën 1.400.000 lekë.*

**19.2** Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësinë e krijimit të saj, duke pretenduar se kjo shumë përfaqëson një pjesë të kursimeve totale në *cash*, në shumën 4.300.000 lekë, që babai dispononte në fund të vitit 2016.

**19.3** Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit lidhur me kursimet në *cash*, në deklaratën *vetting* ka deklaruar se disponohen *gjendje cash si trung familjar, shuma 1.400.000 lekë*. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se analiza e kryer nga Komisioni për këto kursime në *cash*, është bërë duke verifikuar mundësinë e familjes Maksuti për t'i krijuar këto kursime në janar të vitit 2017, nga e cila ka rezultuar pamundësia e tyre për të krijuar me

burime të ligjshme, shumën prej 1.400.000 lekësh, në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*.

**19.4** Lidhur me kursimet në *cash* të familjes Maksuti, Kolegji vlerëson që kontrolli mbi konkluzionin e Komisionit të kryhet mbi të njëjtin qëndrim/metodologji të aplikuar më lart për pasuritë e tjera të personit të lidhur e që ndikohen nga analiza e mundësisë së kursimeve në *cash* të prindërve të subjektit për të gjithë periudhën dhe huatë e kthyer nga motrat e subjektit, si edhe të subjektit për vitin 2016 deri në momentin e dorëzimit të deklaratës. Nga analiza e kryer në Kolegj sipas kësaj metodologjie, të përshkruar edhe më lart, rezultoi se prindërit e subjektit të rivlerësimit, në fund të vitit 2016, kishin mundësi kursimi në shumën 4.233.303 lekë, shumë e cila justifikon si depozitën prej 2.700.000 lekësh, po ashtu edhe gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting* prej 1.400.000 lekësh.

**19.5** Për sa më sipër, lidhur me gjendjen e *cash*-it si trung familjar, në shumën 1.400.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, Kolegji, nga verifikimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie, nëpërmjet të ardhurave të krijuara në vite nga personi i lidhur, të cilat u vlerësuan sipas parimit të një *cash*-i kumulativ, konkludoi se subjekti dhe personi i lidhur justifikonin krijimin e saj me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

- 20** Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimet e ankimit të subjektit, të adresuara ndaj konkluzioneve të Komisionit lidhur me huatë e dhëna në vitin 2015 nga babai i tij, z. Sh. Ll., në shumën 4.500.000 lekë, dhe z. Xh. K. në shumën 1.500.000 lekë, sipas të cilave subjekti pretendon *se provohet mundësia e krijimit me burime të ligjshme e këtyre shumave nga huadhënësi (babai)*, për cilat analizon si vijon.

**20.1** Nga analizimi i vendimit të Komisionit, si dhe i rezultateve paraprake të hetimit administrativ, Kolegji konstaton se analiza e mundësisë së babait të subjektit të rivlerësimit për të dhënë në vitin 2015 huatë, z. Sh. Ll. shumën 4.500.000 lekë, si dhe z. Xh. K. shumën 1.500.000 lekë, është ndikuar/afektuar në mënyrë të rëndësishme nga qëndrimi dhe konkluzioni që Komisioni ka mbajtur lidhur me kthimin e huave babait të subjektit nga motrat e tij, hua të deklaruar si të dhëna në vitet pararendëse. Në këtë kuptim, analiza e mundësisë për financimin e shumave të deklaruar si të dhëna hua prej personit të lidhur dy individëve të përmendur më lart në vitin 2015, lidhet me analizën dhe qëndrimin ligjor që duhet të mbahet lidhur me huatë e dhëna nga personi i lidhur te vajzat e tij, të cilat deklarohen se janë kthyer në vite e që kanë përbërë fondin monetar që ka mundësuar dhënien e huave të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

**20.2** Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, lidhur me huatë e dhëna nga babai i subjektit motrave të tij, është konkluduar sa vijon:

*Në përfundim, Komisioni, duke analizuar deklaratimet periodike të subjektit ndër vite, të cilat përbëjnë provë, në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se kursimet cash të babait, të pretenduara nga subjekti, nuk do të përfshihen në analizën financiare, duke u bazuar dhe duke pasur parasysh se: i. subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës çdo interes pasuror të prindërve të tij dhe në logjikën e deklaratimeve nuk kishte si të mos deklaroheshin kursimet cash të babait, nëse ky i fundit do t'i kishte këto kursime deri para fillimit të detyrës; ii. subjekti, në vijimësi, ka deklaruar rregullisht në deklaratat periodike*

vjetore të ardhurat e prindërve të tij dhe krijimin e pasurive të tjera; **iii.** subjekti ka deklaruar se ka pasur ekonomi të përbashkët me prindërit; **iv.** subjekti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të sqaruar kursimet cash të babait në deklaratën “vetting” – ai nuk rezulton të ketë deklaruar që babai i tij ka pasur kursime cash ndër vite, si dhe të ketë deklaruar faktin që huatë e dhëna shtetasve Sh. Ll. dhe Xh. K. e kanë burimin nga huatë e kthyer nga të motrat, të cilat babai i kishte pasur në banesë si kursime cash [...].

Në përfundim, Komisioni vlerëson se shuma 45.000 euro nuk do të përfshihet në analizën financiare, pasi subjekti:

*i. nuk ka arritur të provojë me dokumentacion provues, burimin e ligjshëm të të ardhurave për kthimin e huave nga ana e motrave të tij;*

*ii. nuk rezulton të ketë deklaruar kthimin e këtyre huave në vitin 2009;*

*iii. nuk rezulton të ketë deklaruar si gjendje cash të babait për vitet 2009 – 2015, shumën 45.000 euro; si dhe*

*iv. nuk rezulton që në deklaratën “vetting” të ketë deklaruar faktin që kthimi i këtyre huave ka shërbyer si burim për dhënien e huave në vitin 2015.*

**20.3** Nga deklarata e pasurisë vetting, rezulton se personi i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar ndër të tjera se i ka dhënë hua në vitin 2015, z. Sh. Ll., klient dhe mik personal, shumën prej 4.500.000 lekësh, me burim krijimi nga të ardhurat e tij nga puna si noter e avokat, marrëdhënie e cila është formalizuar në kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*} kol., datë 31.12.2015, si edhe shumën prej 1.500.000 lekësh, nipit të tij, z. Xh. K. përgjatë vitit 2015, marrëdhënie e cila është pasqyruar në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 23.01.2017. Në këto rrethana, me të drejtë Komisioni ka kontrolluar burimet e krijimit të këtyre shumave nga ana e personit të lidhur, në kuptim të parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, meqenëse ai shfaqet në këtë deklaratë si huadhënës i këtyre shumave dhe duhet të justifikojë burimet e krijimit të tyre.

**20.4** Komisioni, në drejtim të verifikimit e kontrollit të burimeve të ligjshme për të mundësuar krijimin e këtyre shumave, përveç se ka ndjekur të njëjtën metodologji të përmendur më lart, duke konsideruar vetëm të ardhurat e vitit korrent, në të cilin janë dhënë huatë, pra nuk ka konsideruar kursimet e mundshme të akumuluar nga prindërit e subjektit në vite, nuk ka njohur dhe as ka llogaritur si gjendje në cash të tyre një shumë ekuivalente prej 45.000 eurosh, të cilat subjekti ka pretenduar se kanë qenë dhënë hua prej babait të tij, motrave të subjektit, dhe e cila është kthyer në vite duke filluar që prej vitit 2009, duke krijuar gjithashtu një fond monetar që ka mundësuar dhënien e këtyre huave në vitin 2015.

**20.5** Përveç arsytimit të mësipërm që lidhet me trajtimin e gjendjes cash të prindërve të subjektit, për të cilin Kolegji ka dhënë qëndrimin e tij në analizën që i bëhet mundësisë për dhënien e huave në vitin 2015, do të trajtohen disa elemente të tjera, të cilat diktojnë qëndrimin e Kolegjit në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme për krijimin e shumës, në total prej 6.000.000 lekësh (4.500.000 + 1.500.000), elemente që lidhen me: **i)** ekzistencën e marrëdhënies së huas mes personit të lidhur dhe motrave të subjektit; **ii)** mundësinë e personit të lidhur, babait të subjektit, për t'i krijuar me burime të ligjshme shumat e dhëna hua në kohën që ato u janë dhënë motrave të subjektit; **iii)** detyrimin ligjor të subjektit për deklarimin e kthimit të këtyre huave në kohën kur ky kthim ka ndodhur; **iv)** detyrimin ligjor të subjektit për të provuar mundësinë e motrave të tij për financimin me burime të ligjshme të këtyre shumave



si kthim të huave; v) mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting*, të huave të kthyer si burim për krijimin e shumave të dhëna hua në vitin 2015.

Analiza e çështjeve të identifikuara më sipër do të bëhet në vijim, duke u mbështetur në të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi, analiza financiare e kryer nga Komisioni, për të cilën subjekti është mbrojtur në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, por edhe në ankim, si edhe në këndvështrim të dispozitave ligjore që rregullojnë situatën e mësipërme.

**20.6** Lidhur me çështjen e parë që i adresohet ekzistencës së marrëdhënies së huas mes babait të subjektit dhe motrave të tij, rezulton se subjekti ka bërë deklarime në DVP-në para fillimit të detyrës<sup>29</sup>, të vitit 2008<sup>30</sup>, ku ka dhënë sqarime në ILDKPKI, më 25 mars 2009<sup>31</sup> dhe më datë 23.03.2016<sup>32</sup>, si dhe ka dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ në Komision<sup>33</sup>. Nga këto deklarime, pavarësisht disa pasaktësive apo mospërputhjeve mes tyre, siç mund të evidentohen në poshtëshënim të këtij vendimi, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ekzistencën e një marrëdhënieje huaje të babait me motrat e tij, në total për një shumë prej 45.000 eurosh, që në deklaratën fillestare të pasurisë, pas emërimit të tij si prokuror. Gjithashtu, nga këto deklarime, rezulton konsistent përcaktimi i subjektit se këto hua u janë dhënë motrave nga të ardhurat e krijuara prej punës së babait të tij si noter dhe avokat. Kolegji konstaton se këto deklarime të subjektit janë bërë gjithashtu përtej detyrimeve ligjore që ai kishte për deklarim sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003 dhe në një situatë ligjore në të cilën kjo rrethanë nuk prodhonte asnjë pasojë për të si subjekt deklarues. Gjithashtu, rezulton se këto deklarime janë

---

<sup>29</sup> Në DVP para fillimit të detyrës të vitit 2008: Në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Dhënie hua znj. M. L. (motra), vlera 20.000 euro, me marrëveshje gojore midis palëve. Dhënia hua znj. A. Ç. (motra), vlera 25.000 euro, me marrëveshje gojore midis palëve”.

<sup>30</sup> Në DVP periodike të vitit 2008, po në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Dhënie hua znj. M. L. (motra) për nevoja biznesi, vlera 20.000 euro, para të fituara nga puna e babait si noter, dhënë nga babai, me marrëveshje gojore midis palëve”.

<sup>31</sup> Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 25.02.2009, lidhur me huatë, subjekti ka deklaruar: Burimi i krijimit të huadhënieve në shumën 45.000 euro, është nga të ardhurat e përfituara nga puna e babait si noter në vitet 1994-1996 dhe nga viti 2006 e në vazhdim, nga puna si avokat. Kjo shumë zotërohej nga ana e babait tim, P. M..

<sup>32</sup> Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 23.03.2016, lidhur me huatë, subjekti ka deklaruar se huatë i ka deklaruar vetëm për faktin se jeton së bashku me prindërit dhe këtë e ka vërtetuar me certifikatën familjare: “E kam paraqitur në faqen konfidenciale [i referohet deklaratimit të huave] si marrëdhënie mes personash të lidhur me mua (babi) dhe motrat. Po ju paraqes dokumentacionin justifikues në lidhje me të ardhurat e përfituara nga puna private e babait tim nga viti 1992 e aktualisht. Këto shuma i janë kthyer babait pjesë-pjesë në vite”.

<sup>33</sup> Me përgjigjet e dhëna më datë 24.06.2020 mbi pyetësin e Komisionit të datës 01.06.2020, subjekti i rivlerësimit, për huatë, ka shpjeguar sa vijon: “Këto shuma janë dhënë nga babi: 1- motrës A. C., 25.000 euro në vitin 2000 dhe janë kthyer nga ana e saj në fund të vitit 2008; 2- motrës M. L., shuma prej 20.000 eurosh në vitin 2002 dhe janë kthyer në fillim të vitit 2009. Të dyja këto hua i kam deklaruar në deklaratimin fillestar të vitit 2008 dhe jam pyetur edhe në ILDKPKI, për të cilat pranë këtij organi kam deklaruar se kjo shumë zotërohej nga babai im P. M., çka do të thotë që është deklaruar si gjendje në cash. Duke qenë se u pyeta në ILDKPKI dhe ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes përkatëse nuk e përmenda në deklaratimin e vitit 2009, për shkak mospërsëritje”. Më përgjigjet e datës 21.12.2020, lidhur me pyetësin e Komisionit të datës 09.12.2020, subjekti i rivlerësimit, për huatë, ka shpjeguar sërish sa vijon: “[...] për kthimin e shumave të marra borxh nuk ka dokumentacion provues pasi është marrëdhënie midis babait dhe vajzave të tij. Datën e saktë nuk e mbaj mend, por ashtu sikurse kam deklaruar në pyetësin 01.06.2020, këto para janë kthyer në fund të vitit 2009. Kursimet e grumbulluara prej tij si burim të ardhurash, të cilat, siç kam shpjeguar edhe në pyetësin e datës 01.06.2020, kanë qenë të mbajtura në gjendje cash në shtëpi. Periudha 1994-1996 ka qenë periudha që babai ka ushtruar detyrën e noterit dhe kam dashur të saktësoj se këto të ardhura janë nga puna si noter [...]”.

bërë krejtësisht jashtë kontekstit të procesit të rivlerësimit, duke qenë se datojnë në vitin 2008. Në këtë kuptim, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit rreth kësaj marrëdhënieje, lexohen dhe interpretohen si përpjekje për të dhënë informacion rreth gjendjes financiare të familjes së tij, ndonëse në tejkalim të parashikimit ligjor, siç duket edhe për shkak të paqartësisë se ku fillonin dhe ku mbaronin detyrimet ligjore të subjektit, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me pasuritë e prindërve të tij, me të cilët ai jetonte në një gjendje familjare, por për të cilët, sipas ligjit, nuk kishte detyrim të deklaronte.

**20.7** Për sa më sipër, Kolegji i gjen të dhënat që vijnë nga deklaratimet e subjektit si informacion/indicie të rëndësishme, të cilat, të ofruara në mënyrë vullnetare dhe të pakërkuara nga ligji, krijojnë bindjen se kjo marrëdhënie ka ekzistuar dhe se babai i subjektit u ka dhënë para hua vajzave të tij për t'i ndihmuar ato në ngritjen e ekonomisë së tyre familjare, parë edhe në kontekstin e një raporti familjar të ambientit shqiptar.

**20.8** Lidhur me çështjen tjetër që i adresohet *kontrollit dhe verifikimit të mundësisë së personit të lidhur për të justifikuar me burime të ligjshme krijimin e këtyre shumave të dhëna hua, vajzave të tij*, Kolegji ushtroi kontrollin e këtyre mundësive duke shqyrtuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit rreth analizës financiare të kryer nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, e cila gjithashtu është bërë pjesë e vendimit objekt shqyrtimi. Kolegji vlerëson se kontrolli i këtij momenti vjen për shkak të parashikimit ligjor të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit personi i lidhur që shfaqet në cilësinë e huadhënësit, ka detyrimin të provojë burimet e ligjshme të pasurisë së dhënë hua. Lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, për sa i takon momentit se kur këto para janë dhënë hua, kanë qenë të pasakta dhe të paqarta. Duke u nisur nga prezumimi se meqenëse ato janë deklaruar si ekzistuese që në deklaratën fillestare të pasurisë, dokument me cilësinë e provës sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duhet minimalisht të jenë dhënë para kësaj kohe, që në çdo rast i përket një periudhe në të cilën subjekti nuk ushtronte funksionet e prokurorit.

**20.9** Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, mbi të cilën janë ndërtuar rezultatet paraprake të hetimit dhe i ka kaluar subjektit barra e provës, rezulton se familja e subjektit është ngarkuar me shpenzim për dhënie të këtyre huave në vitin 2000, për shumën 20.000 euro, dhënë hua motrës M. L. dhe në vitin 2002, për shumën 25.000 euro<sup>34</sup>, dhënë hua motrës A. Ç. (hua që në total janë në vlerën korresponduese prej 45.000 eurosh), duke pranuar versionin e subjektit të dhënë gjatë shpjegimeve të hetimit administrativ për kohën e dhënies së tyre. Analiza financiare për këto periudha është kryer në funksion të kontrollit të burimeve të ligjshme të familjes për blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, në të cilin banon e gjithë familja e subjektit dhe për të cilin është arsyetuar më lart në këtë vendim. Nga kjo analizë, ka rezultuar se babai i subjektit kishte mundësi t'i krijonte këto shuma me burime të ligjshme që vinin nga puna e tij si avokat e noter ndër vite. Në këtë kuptim, ndonëse Komisioni në vendimin e tij ngre çështje lidhur me pabesueshmërinë e deklaratimeve të subjektit lidhur me kohën e dhënies së këtyre huave, duke qenë në kushtet kur i ka vendosur vetë në analizën

---

<sup>34</sup> Nga të dhënat e akteve të fashikullit administrativ, rezulton se Komisioni në analizën financiare për huatë që babai i subjektit u ka dhënë motrave të subjektit, ka përdorur kursin e këmbimit të monedhës nga euro në lekë, sipas të dhënave të marra nga faqja zyrtare në internet e Bankës së Shqipërisë për vitet 2000 dhe 2002. Shih: [https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/).

financiare, në vitet 2000 dhe 2002, të cilat rezultojnë me bilanc pozitiv për familjen, Kolegji, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, pranon si të mirëqene këtë moment kohor për dhënien e tyre dhe e mbështet analizën financiarë për verifikimin e burimit të krijimit të këtyre shumave, pikërisht në këtë periudhë, siç Komisioni ka vendosur.

**20.10** Pavarësisht kësaj situatë që vjen për shkak të deklarimeve të subjektit, përtej detyrimit ligjor, Kolegji mban në vëmendje se në këtë rast, subjekti do të duhet të përgjigjet për rrethana e fakte që nuk lidhen drejtpërdrejt me të, që i përkasin disponimit të lirë të pasurisë së babait të tij, të krijuar nga aktiviteti i tij privat, e që për më tepër në çdo rast ka ndodhur para se subjekti të fillonte të kryente detyrën e prokurorit.

**20.11** Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka provuar se personi i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme për t'ua huazuar vajzave të tij, shumë 20.000 dhe 25.000 euro në vitet 2000 dhe 2002<sup>35</sup>, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor që vjen nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**20.12** Lidhur me çështjen e tretë të adresuar për zgjidhje e që kërkon analizën ligjore që përcakton nëse kishte apo jo detyrim subjekti i rivlerësimit të deklaronte kthimin e këtyre huave në kohën që ai kishte ndodhur, Kolegji sërish risjell në vëmendje parashikimet e ligjit nr. 9049/2003 dhe detyrimet për subjektet deklaruese të përcaktuara prej këtij ligji. Vetëm fakti që subjekti ka deklaruar rreth ekzistencës së huave dhe vlerës së tyre në deklaratimet e tij fillestare, nuk e ngarkon atë me përgjegjësi që të vijojë të deklarojë rreth statusit të këtyre marrëdhënieve, përderisa ato krijojnë të drejta e detyrime jo për atë dhe personat e lidhur me të sipas atij ligji, por për familjarë të tij, të cilët pavarësisht afërsisë gjinore dhe asaj faktike, nuk kishin asnjë status të përcaktuar në ligj, përderisa nuk kishin hyrë me subjektin në ndonjë marrëdhënie interesi. Deklarimi apo mosdeklarimi i interesave pasurorë të babait të subjektit përgjatë kohës që zbatohet regjimi i ligjit nr. 9049/2003, ishte një çështje pa relevancë dhe pa detyrime për subjektin deklarues. Në këto rrethana, vetëm arsyetimi se ai duhej të deklaronte kthimin përderisa kishte deklaruar dhënien e huave, nuk mjafton si një shkak ligjor për ta ngarkuar atë me barrën e mosprovimit të kthimit të tyre, përderisa ky veprim nuk është deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se kjo rrethanë e përcaktuar nga Komisioni si një arsye e mosnjohjes në analizë të shumës prej 45.000 eurosh, nuk është e mbështetur në ligj dhe nuk duhet të ngarkojë subjektin me përgjegjësi. Risillet sërish në vëmendje se objekt analize e kontrolli janë të ardhurat e babait të subjektit, të cilat ai i ka disponuar në favor të fëmijëve të tij, veprimtari e cila jo detyrimisht duhet të ishte në dijeninë, vëmendjen apo përgjegjësinë e subjektit, duke konsideruar edhe faktin që personi i lidhur rezulton të ketë qenë një individ që ka ushtruar profesionin e tij edhe në një fazë të avancuar të moshës.

**20.13** Për sa më lart, Kolegji çmon se në mungesë të përcaktimit të saktë të kohës së kthimit të huave në deklaratimet periodike, do të duhet të pranohen shpjegimet që subjekti ka dhënë për këtë moment gjatë hetimit administrativ, nga të cilat evidentohet në mënyrë konsistente se kthimi i tyre ka ndodhur pas vitit 2009 dhe se ato janë poseduar në *cash* nga babai i tij, duke u

---

<sup>35</sup> Pavarësisht se në vitin 2000, monedha në euro nuk ishte ende në fuqi, Kolegji vlerëson se kjo vlerë përfaqëson ekuivalentin në lekë të saj, konsideruar se ajo është deklaruar si e tillë në vitin 2008, kur përdorej gjerësisht në qarkullimin civil edhe të vendit tonë.

bërë në këtë mënyrë pjesë e gjendjes së *cash*-it të disponuar prej prindërve e të përdorur po prej tyre për dhënien më pas të huave në vitin 2015.

**20.14** Lidhur me çështjen e katërt të shtruar për zgjidhje e që i dedikohet përcaktimit të detyrimit ligjor të subjektit për të provuar se huamarrëset, motrat e tij, kishin mundësi që me burime të ligjshme të kthenin shumën e marrë hua babait të tyre, Kolegji kontrolloi vendimin e Komisionit duke interpretuar parashikimin ligjor të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>36</sup>, sipas një interpretimi teologjik të ligjit.

**20.15** Konstatohet se Komisioni ka ushtruar kontroll mbi mundësinë e motrave të subjektit për të krijuar me burime të ligjshme sipas standardit të ligjit nr. 84/2016, shumat e pretenduara prej tij se i janë kthyer babait prej tyre, dhe ka konkluduar se vetëm njëra prej tyre, znj. A. Ç., kishte mundësi të kthente shumën e deklaruar të marrë hua, prej 25.000 eurosh (pa përfshirë në analizë shpenzimet jetike), ndërsa motra tjetër e subjektit, znj. M. L., rezulton të ketë qenë në pamundësi të krijojë me burime të ligjshme shumën prej 20.000 eurosh të kthyer babait të saj në këmbim të huasë së marrë. Në vijim, Komisioni e ka përdorur këtë rezultat si një element tjetër, krahas atyre që lidhen me mosdeklarimin e kthimit të huave, për të konkluduar se kjo shumë e pretenduar prej 45.000 eurosh, nuk mund të llogaritet si një e ardhur e familjes dhe që ka shërbyer për financimin e huave të vitit 2015.

**20.16** Sipas një interpretimi teologjik të nenit 32, pika 4 e ligjit, në bazë të të cilit Komisioni ka ushtruar kontrollin për burimet e motrave të subjektit, Kolegji konstaton se qëndrimi i Komisionit tejkalon qëllimin e dispozitës dhe ngarkon subjektin e rivlerësimit me një barrë të paarsyeshme. Parashikimet e kësaj dispozite do të duhet të lexohen se ngarkojnë me përgjegjësi personat e tjerë të lidhur kur ata janë huamarrës apo dhurues të subjekteve të rivlerësimit apo personave të lidhur me ta. Në këto raste, pasuria e krijuar prej tyre, ka kaluar në zotërim apo përdorim të subjekteve apo personave të lidhur, duke u shtuar atyre vlerën e pasurisë apo mundësuar kryerjen e shpenzimeve me burime të jashtme, që nuk u përkasin të ardhurave të krijuara prej vetë subjekteve apo personave të lidhur. Në këto raste, këta individë, kur e konfirmojnë këtë marrëdhënie, duhet të provojnë se pasurinë e dhënë hua apo dhuruar e kanë krijuar me burime të ligjshme, në kuptim të parashikimeve të këtij ligji. I njëjti detyrim lind për vetë subjektin e rivlerësimit apo personin e lidhur që shfaqet, sipas kësaj dispozite, në cilësinë e huadhënësit apo dhuruesit. Ai duhet të provojë se pasurinë të cilën ai e disponon nëpërmjet këtyre veprimeve juridike, e ka krijuar me burime të ligjshme në kuptim të parashikimeve të këtij ligji, përderisa kjo pasuri është krijuar fillimisht prej tyre e pastaj është tjetërsuar apo hequr nga posedimi. Kalimi i barrës subjekteve, për të provuar se edhe ata që u kanë marrë hua atyre, kanë burime të ligjshme për të justifikuar kthimin e parave të dhëna hua, nuk vjen në harmoni me qëllimin e ligjit, i cili synon të kontrollojë pasuritë e krijuara prej subjekteve, dhe jo ato që u kthehen atyre si pasojë e një detyrimi kontraktor. Në këto raste, subjektet nuk rrisin vlerën e pasurisë së tyre, nuk krijojnë pasuri të reja, nuk përdorin burime që nuk i përkasin aktivitetit të tyre për të përballuar shpenzime; ata rifitojnë të drejtat e tyre mbi pasuri të vetat, për të cilat janë kontrolluar në cilësinë e huadhënësve. Vlerësimi i

---

<sup>36</sup> *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*

mundësisë së huamarrësve për të kthyer paratë e marra hua, sa kohë që nuk është një çështje vullneti apo zgjedhjeje, por një detyrim kontraktor, do të neutralizonte qëllimin për të cilin kjo dispozitë ka këtë përmbajtje.

**20.17** Në këtë kuptim, Kolegji çmon se verifikimi i mundësisë së motrave të subjektit për të kthyer huatë babait të tyre, del jashtë parashikimeve dhe detyrimeve që subjektet e rivlerësimit kanë sipas kësaj dispozite. Pavarësisht këtij arsytimi, Kolegji çmon të nënvizojë faktin se ky interpretim nuk duhet të kufizojë kontrollin e këtyre burimeve, kur marrëdhëniet e huave janë të ndërtuara mbi baza interesi dhe subjektet deklaruese përfitojnë jo vetëm shumat e dhëna hua, por rrisin vlerën e pasurive të tyre nëpërmjet aplikimit të interesave mbi vlerën e huasë, apo në çdo rast tjetër që organet e rivlerësimit do të kenë indicie apo dyshime se këto marrëdhënie përfaqësojnë një skemë për të rritur fiktivisht të ardhurat e subjekteve të rivlerësimit.

**20.18** Në rastin konkret, natyra e marrëdhënies së deklaruar mes prindit dhe fëmijës, si edhe fakti që huatë kthehen pa interes, konsideruar gjithashtu edhe informacionin se të dyja motrat e subjektit kanë ushtruar aktivitete private nëpërmjet familjarëve të tyre, nuk ka evidentuar asnjë rrethanë që ta bëjë të pabesueshëm këtë raport, për pasojë, kontrolli në këtë rast duhet të fokusohet vetëm te mundësia e babait të subjektit për t'i krijuar me burime të ligjshme shumat e dhëna hua, mundësi e cila siç u arsyetua më lart, rezultoi e konfirmuar prej vetë Komisionit.

**20.19** Lidhur me çështjen e pestë të shtruar për zgjidhje, që i adresohet argumentit të përdorur prej Komisionit për mosnjohjen si burim të shumës prej 45.000 eurosh, të kthyer nga motrat, për përballimin e dhënies së shumës prej 6.000.000 lekësh hua dy shtetasve në vitin 2015, faktin që personi i lidhur nuk ka përcaktuar në deklaratën e pasurisë *vetting* kur deklaroi dhënien e këtyre huave, si burim për krijimin e shumave, kthimin e huave nga vajzat, por të ardhurat e krijuara nga puna e tij si noter e avokat, Kolegji vlerëson se është i pabazuar në ligj. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur ka përcaktuar se burimi që ka krijuar të ardhurat e dhëna hua dy shtetasve, z. Ll. dhe z. K. në vitin 2015, janë të ardhurat e krijuara prej punës së tij si noter e avokat, duke përcaktuar drejt, në vlerësimin e Kolegjit, burimin që ka mundësuar krijimin e këtyre të ardhurave. Kthimi i huave nga vajzat e personit të lidhur, nuk ka krijuar një burim të ri të ardhurash për të, ky veprim vetëm ka rivendosur personin e lidhur në posedimin e pasurive të tij të krijuara pikërisht me aktivitetin e tij si avokat e noter, në këtë kuptim ai ka deklaruar saktë burimin e krijimit të shumave të dhëna hua dy shtetasve në vitin 2015.

**20.20** Për sa më sipër, lidhur me huatë e dhëna nga babai i subjektit në vitin 2015, z. Sh. Ll. në shumën 4.500.000 lekë dhe z. Xh. K. dhe 1.500.000 lekë, Kolegji, pasi analizoi të ardhurat e personit të lidhur në vite dhe deklarimet e subjektit, vlerësoi se në kushtet kur nga analiza e kryer në Komision, ka rezultuar mundësia financiare e personit të lidhur për dhënien e huave dy motrave të subjektit në vlerën 45.000 euro, provueshmëria e burimeve të ligjshme për kthimin e tyre është një barrë që tejkalon parashikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur ky kthim nuk shoqërohet me përfitimin e ndonjë interesi apo me dyshimet për ndonjë situatë fshehjeje pasurie. Në këto kushte, ky qëndrim i harmonizuar me qëndrimin për *cash*-in kumulativ të personave të lidhur, i cili u vlerësua sipas një analize financiare të kryer për të ardhurat e shpenzimet e tyre, çon në konkluzionin se subjekti dhe personi i lidhur

justifikojnë me të ardhura të ligjshme shumat e dhëna hua shtetasve të mësipërm, sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

- 21 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit *se konstatimi i Komisionit se ai nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 dhe në deklaratën e pasurisë “vetting”, marrjen hua prej babait të shumës 800.000 lekë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, është jo i drejtë dhe i bazuar në ligj*, Kolegji analizon sa vijon.

21.1 Në vendimin e Komisionit, për këtë shkak ankimi është konkluduar se:

*Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse. Subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion provues që shuma 800.000 lekë i është dhënë hua nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, babait të tij. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, si dhe nga deklaratimet e babait të tij në DVP-2015, rezulton se kjo shumë është deklaruar si e ardhur. Subjekti nuk ka provuar gjatë hetimit, por as pas kalimit të barrës së provës, pagimin e detyrimeve tatimore për këtë shumë, për rrjedhojë nuk do të përfshihet në analizën financiare.*

21.2 Në ankim, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin qëndrim që ka mbajtur gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se në vitin 2015, nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë dhe të ardhurat e babait të tij dhe se për këtë fakt, ai nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi. Ndërsa mosdeklarimin e kësaj huaje të marrë nga babai në deklaratën *vetting*, subjekti në ankim, ashtu siç ka pretenduar edhe në Komision, e shpjegon se ka ndodhur për shkak të vështirësisë që i ati ka pasur për të evidentuar dhe pasqyruar në mënyrë të plotë në deklaratën *vetting* të gjitha të ardhurat që ka pasur në kaq shumë vite punë dhe se ky mosdeklarim është thjesht një harresë.

21.3 Lidhur me këtë shkak ankimi, si dhe duke iu referuar trajtimit që Komisioni i ka bërë çështjes së huas prej 800.000 lekësh, që babai i subjektit ka marrë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, tek e cila ai ishte bashkortak, Kolegji konstaton se pavarësisht mospasjes detyrim të subjektit për ta deklaruar këtë shumë si hua të babait të tij në DPV-në e vitit 2015, sipas arsyetimit të bërë më lart, kjo e dhënë do të duhej të deklarohet në deklaratën e pasurisë *vetting* nga vetë personi i lidhur, babai i tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016.

Sipas Komisionit, nga dokumentacioni i administruar, si dhe nga deklaratimet e babait të tij në DVP-në e vitit 2015, rezulton se shuma prej 800.000 lekësh është deklaruar si e ardhur dhe jo si hua. Subjekti nuk ka provuar gjatë hetimit administrativ, por as pas kalimit të barrës së provës, pagimin e detyrimeve tatimore për këtë shumë, e cila nuk rezulton të jetë deklaruar si hua në pasqyrat financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Për rrjedhojë, shuma prej 800.000 lekësh nuk është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të këtij viti.

21.4 Në drejtim të huas prej 800.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si e marrë nga babai i tij në vitin 2015, nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, tek e cila ai ishte bashkortak, Kolegji verifikoi pasqyrimin e kësaj huaje në pasqyrat financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si edhe mundësinë e kësaj shoqërie për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën e dhënë hua.

21.5 Në kundërshtim të këtyre konkluzioneve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

(i) Nga transfertat bankare të vitit 2015, konfirmohet përfitimi nga babai i subjektit i shumës prej 800.000 lekësh.

(ii) Pasqyrat financiare të vitit 2015, të depozituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, janë hartuar me gabime, se shoqëria më datë 01.02.2016 ka kaluar në status pasiv dhe nga administratori nuk ka pasur një fokus aq të madh në përpilimin e saktë të tyre. Pasqyrat financiare janë depozituar *online* dhe gabimisht në to është pasqyruar fitimi neto në shumën 283.173 lekë, aksione të vetat në shumën 555.993 lekë, si dhe shpenzime amortizimi në shumën 269.820 lekë, kur ndërkohë shoqëria nuk ka pasur aktive afatgjata, për të cilat është përlllogaritur amortizim. Zëri “aksione të vetat”, i pasqyruar gabim në vlerën 555.993 lekë, përfaqëson pjesë të shumës së dhënë hua nga shoqëria, e cila së bashku me zvogëlimin e shpenzimeve, do të rriste fitimin në masën 550.953 lekë.

(iii) Shoqëria ka depozituar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (në vijim “DRT Tiranë”), pasqyrat financiare të ndryshuara, si dhe deklaratën e tatimit të ndryshuar më datë 20.06.2020, të cilat janë konfirmuar me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.03.2021, të lëshuar nga DRT Tiranë.

(iv) Babai i tij nuk ka pasur detyrim të deklarojë në DVP-në e vitit 2015, huanë e marrë nga shoqëria, ndërsa në lidhje me mungesën e deklarimit në deklaratën *vetting*, ky është konstatim i drejtë nga Komisioni, por kjo ka ardhur për shkak të vështirësisë për të mbajtur mend të gjitha shpenzimet dhe detyrimet ndër vite.

**21.6** Rezulton se subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ<sup>37</sup>, ka sqaruar se: *Në fund të vitit 2015, babai pati një përkeqësim të shëndetit dhe kërkoi nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK që nga të ardhurat e saj, t’i jepej në formë huaje shuma prej 800.000 lekësh, që t’i përdorte për shpenzimet spitalore. Me vendim asambleje të ortakëve të datës 14.12.2015, u vendos t’i jepet P. M. një hua në shumën 800.000 lekë, me afat kthimi 10-vjeçar. Kjo gjë është pasqyruar edhe në kontratën e huasë, datë 16.12.2015, përpiluar mes z. D. C. (administratori) dhe z. P. M. (huamarrësi). Sipas subjektit, kjo u pasqyrua edhe në bilancet (pasqyrat financiare) e shoqërisë. Subjekti ka shpjeguar që këtë shumë e ka pasqyruar si të ardhur, duke qenë se kështu iu deklarua nga ana e babait. Sipas subjektit, duke qenë se është marrëdhënie financiare mes dy ortakëve të shoqërisë, vlera prej 800.000 lekësh nuk i nënshtrohet tatimit.*

**21.7** Kolegji, nga analizimi i akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, konstatoi se në fashikull disponohet gjithashtu dhe shkresa me nr. {\*\*\*}, datë 17.12.2020, e lëshuar nga DRT Tiranë, e cila i ka përcjellë Komisionit, pasqyrat financiare të

<sup>37</sup> Subjekti, në përgjigje të pyetësorëve, ka depozituar në Komision dokumentacionin si vijon:

- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.12.2015, i asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregtare “{\*\*\*}”, ku është vendosur dhënia e huasë në shumën 800.000 lekë, z. P. M.;
- procesverbali i mbledhjes së ortakëve të shoqërisë “{\*\*\*}”, datë 14.12.2015, në të cilën deklarohet se z. P. M. ka shprehur nevojën e një huadhënieje për arsye shëndetësore;
- kontratë huaje, datë 16.12.2015, lidhur midis shoqërisë “{\*\*\*}” dhe z. P. M.;
- pasqyrat financiare të vitit 2015 të shoqërisë “{\*\*\*}”, në të cilat pasqyrohet dhënia e huasë në shumën 800.000 lekë;
- pasqyrat financiare të shoqërisë “{\*\*\*}”, të vitit 2015;
- deklarata noteriale nr. {\*\*\*}, datë 17.12.2020, e D. C., i cili deklaroi se shuma 800.000 lekë, me vendim të asamblesë së ortakëve të datës 14.12.2015, u vendos t’i jepet hua ortakut P. M.. Kjo gjendje është pasqyruar në bilancin e shoqërisë. Në deklaratë është shpjeguar që përshkrimi në formularët e transaksionit bankar për derdhjen e shumës në favor të P. M., është transkriptuar gabimisht me shënimin: “Pagesë për konsulencë dhe përfaqësi rastësore avokatie”, ndërkohë që kjo ka qenë një hua e marrë nga shoqëria.

shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Bilancet e disponuara nga DRT-ja nuk pasqyrojnë te pasqyra “Aktivet”, në zërin “Tituj të tjerë të huadhënies” (aktive afatgjata / aktive financiare), shënimin: “Hua financiare dhënë ortakut P. M., në vlerën 800.000 lekë”, shënim që figuron te pasqyrat financiare të depozituara në Komision nga vetë subjekti. Në deklaratën e vitit 2015, subjekti ka deklaruar në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private”, shumën 800.000 lekë si të ardhur nga puna si avokat e babait, me numër licence {\*\*\*}, të kredituara në llogarinë personale të tij. Nëse kjo shumë do të ishte një hua e marrë nga shoqëria, ajo do të ishte deklaruar në seksionin e “Detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”. Pavarësisht se subjekti nuk ka pasur detyrim të deklaronte këtë të drejtë/detyrim të babait, kjo shumë është deklaruar prej tij si e ardhur në DVP-në e vitit 2015, dhe jo si një detyrim.

**21.8** Në analizë të kësaj situate faktike, Kolegji evidenton faktet se: (i) të dyja transfertat bankare të vitit 2015, të firmosura nga administratori D. C., me përshkrimin “pagesë për konsulencë dhe përfaqësi rastësore avokatie”, konfirmojnë shlyerjen e detyrimit si pagesë konsulence dhe jo si huadhënie të shoqërisë; (ii) pasqyrat financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK vitit 2015, të depozituara në vitin 2016 në DRT Tiranë, pasqyrojnë shifra të tjera, të cilat nuk përputhen me pretendimin e subjektit për një huadhënie të mundshme, të marrë nga shoqëria. Bilanci i kësaj shoqërie nuk pasqyron në asnjë zë huadhënien, por një situatë të ndryshme financiare dhe një fitim më të vogël, i cili nuk përmbush dhënien e huasë. Pavarësisht se bilanci kontabël i vitit 2015 është ribërë nga subjekti tatimor dhe është ridepozituar pranë organeve tatimore me korrektime, Kolegji vlerëson se kjo nuk e bën të besueshëm pretendimin e subjektit për një huadhënie të mundshme nga ana e shoqërisë.

**21.9** Për sa më sipër, Kolegji e gjen të drejtë këtë konkluzionin të Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të shumës prej 800.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti se ka qenë një hua e marrë prej babait të tij nga shoqëria “{\*\*\*}” ShKP në vitin 2015, duke qenë se subjekti nuk provoi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje.

**22** Lidhur me pretendimin e subjektit, sipas të cilit ai konsideron si jo të bazuar ligjërisht qëndrimin e Komisionit lidhur me konstatimin për mosdeklarimin në deklaratën “vetting”, prej babait, të kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2014, duke pretenduar se detyrimi ligjor është për deklarimin e pasurive dhe jo të marrëveshjeve që nuk kanë prodhuar të mira, pasi babai i tij nuk kishte regjistruar ndonjë pasuri apo të kishte ndonjë të drejtë reale mbi këtë truall, Kolegji analizon sa vijon.

**22.1** Në vendimin e Komisionit lidhur me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2014, është konkluduar se:

*Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se babai i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, duhet të deklaronte të drejtat që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes, pasi në të parashikohej krijimi i të drejtave të pronësisë në të ardhmen, duke e vënë babain e subjektit (person i lidhur) në kushtet e deklarimit të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, gërmës “a” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*



**22.2** Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë qëndrim të Komisionit duke e konsideruar atë jo të drejtë, pasi ai nuk mund të përgjigjet aktualisht për mosdeklarimin nga babai i tij i ndjerë i kësaj kontrate sipërmarrjeje, duke arsyetuar se kjo kontratë me kusht nuk ka prodhuar asnjëherë një të drejtë reale për pjesën takuese që babai i tij do të përfitonte në rast të pajisjes me certifikatë pronësie të palës tjetër. Gjithashtu, kërkon nga Kolegji të konsiderojë faktin se në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* nga babai i tij, si person i lidhur, ai nuk kishte të regjistruar si pronë të tij truallin e përshkruar në kontratën e sipërmarrjes dhe as nuk kishte ndonjë të drejtë reale mbi të, pasi ajo do të përfitohej vetëm nëse plotësohej kushti.

**22.3** Në analizë të këtij shkakut ankimi, Kolegji konstaton se babai i subjektit, së bashku me z. R. I. me cilësinë e avokatit dhe trashëgimtarët e ish-pronarëve të një sipërfaqeje trualli, të A. e I. K. dhe të H. L., kanë nënshkruar kontratën paraprake të sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, të datës 16.05.2014, me shoqërinë e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK, me qëllim kryerjen e procedurave që mundësojnë kthimin e ish-pronësisë mbi truallin dhe ndërtimin më pas në truallin e kthyer të një ndërtese që do të ndahet mes palëve të kësaj kontrate, sipas përqindjeve të përcaktuara në të. Sipas kësaj kontrate, avokatët P. M. dhe R. I., së bashku me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, do të ndërmerrnin të gjithë hapat e nevojshëm që kjo ish-pronë që ishte e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të palëve të tjera të kontratës, t’u kthehej trashëgimtarëve, dhe në këmbim të këtij shërbimi, shoqëria do të fitonte të drejtën të ndërtonte në këtë truall, ndërsa avokatët do të merrnin pjesën e tyre nga trualli që do të kthehej. Nëse procedurat dështonin, atëherë, sipas kontratës, avokatët, përfshi babain e subjektit, do t’i kalonin në pronësi shoqërisë, në këmbim të shpenzimeve të kryera, 250 m<sup>2</sup> nga trualli i sipërcituar, i cili ishte i regjistruar në ZVRPP në emër të tyre. Gjatë hetimit administrativ, rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, të datës 10.10.2018, të nënshkruar nga të 18 trashëgimtarët e truallit prej 750 m<sup>2</sup>, tek e cila, ndër të tjera pasqyrohet se të gjithë trashëgimtarët dhe shoqëria e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK janë dakord që kontrata e sipërmarrjes (nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2014) të priset dhe palët nuk kanë asnjë detyrim ndaj njëri-tjetrit.

**22.4** Për sa më sipër, në analizë të qëndrimit të Komisionit lidhur me këtë çështje, Kolegji vlerëson se ai është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi:

*Së pari*, konstatohet se Komisioni nuk ka bërë një vlerësim të situatës faktike të evidentuar nga kontrata e sipërmarrjes dhe, më pas, nga prishja e saj. Nga kjo kontratë sipërmarrjeje, kuptohet se babai i subjektit është në rolin e avokatit të disa prej trashëgimtarëve të ish-pronarëve që pretendojnë pronësinë mbi një truall prej 750 m<sup>2</sup>. Nga aktet e administruara, konstatohet se në emër të babait të subjektit dhe z. R. I. nuk rezultoi të jetë e regjistruar në ZRPP Tiranë, sipërfaqja prej 250 m<sup>2</sup>, siç pasqyrohet në kontratën e sipërcituar. Përveçse nuk rezultoi të jetë e regjistruar, kjo sipërfaqe nuk mund të jetë e regjistruar sipas asaj që parashikon kontrata, pasi prona është ende një “ish-pronë” në pronësi të shtetit, ajo nuk u është kthyer trashëgimtarëve dhe për këtë qëllim janë angazhuar edhe avokatët. Për pasojë, jo vetëm rrethanat faktike dëshmojnë për pavërtetësinë e këtij elementi, por asnjë analizë ligjore nuk e mundësonte as potencialisht ekzistencën e këtij fakti.

*Së dyti*, në kushtet kur në momentin e plotësimit të deklaratës *vetting*, babai i subjektit nuk ka pasur të regjistruar në emrin e tij asnjë pjesë nga pasuria prej 750 m<sup>2</sup> truall – ai është angazhuar vetëm si përfaqësues i palëve të interesuara për pronësinë mbi këtë truall, të cilat, si shpërblim për këtë angazhim, premtojnë se do t’i japin pronësi mbi pjesë nga ky truall, pasi të realizohet shërbimi i kontraktuar – rezultoi se e gjithë kjo marrëdhënie e pamaterializuar në kalimin e

pronësisë, është një situatë të cilën subjekti apo personat e lidhur nuk kanë detyrim ta deklarojnë.

*Së treti*, kontrata paraprake e sipërmarrjes nuk ka prodhuar të drejta për personin e lidhur, të drejtat e parashikuara në të se do të lindnin në të ardhmen, janë të kushtëzuara nga ngjarje që nuk provohet se kanë ndodhur, për pasojë, ato mbeten thjesht deklarime të vullneteve të palëve, por të porealizuara konkretisht, ndërsa ligji kërkon deklarimin e detajeve që gëzohen në momentin e deklarimit.

*Së katërti*, kjo lloj kontrate, ndonëse ka titullin e një kontrate sipërmarrjeje, në thelb rezulton se për personin e lidhur përfaqëson një kontratë shërbimi – për të cilën ai do të ketë si shpërblim fitimin e pronësisë mbi një truall, pas realizimit të shërbimit të tij si avokat – kontrata për të cilat ligji po ashtu nuk parashikon ndonjë detyrim për deklarim.

*Së fundmi*, fakti që subjekti gjatë hetimit administrativ ka provuar se kontrata e sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2014 (*nga e cila babait të subjektit mund t'i kalonin të drejta pronësie mbi një pjesë trualli në rast se do të kryheshin prej tij veprimet e përfaqësimit*), është shfuqizuar, dëshmon se është shuar përfundimisht edhe ndonjë pretendim i ardhshëm i babait të subjektit për të pasur të drejta reale/pasurore mbi këtë pronë.

**22.5** Bazuar në situatën faktike të evidentuar më sipër, në përfundim të analizës lidhur me konstatimin e Komisionit për mosdeklarimin në deklaratën *vetting* prej personit të lidhur, babait të subjektit, të kontratës së sipërmarrjes nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2014, Kolegji vlerëson se kjo kontratë nuk përfaqëson fitimin e të drejtave reale, por marrëveshjen për një shërbim që do të kryhej dhe që do të mund të krijonte pasoja në të ardhmen, të cilat provohet se nuk kanë ekzistuar në kohën e dorëzimit të deklaratës *vetting* dhe as do të realizohen në të ardhmen.

- 23** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit që kundërshton si jo të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti dhe babai i tij nuk kanë deklaruar në deklaratën “*vetting*” në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë lokale, me sip. 80 m<sup>2</sup>, Kolegji analizon sa vijon.

**23.1** Në vendimin e Komisionit lidhur në pasurinë lokale, me sip. 80 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Dibër, është konkluduar se *subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij nuk kanë deklaruar në deklaratën “vetting”, blerjen e truallit në vitin 1999, mbi të cilin është ndërtuar ky lokal, pjesën takuese në të, koston e shpenzuar për ndërtimin e tij, duke arritur në përfundimin se babai i subjektit/subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germës “a” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**23.2** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se trualli i marrë në pronësi nga babai në Peshkopi, në datën 15.02.1997, mbi të cilin është ndërtuar lokali me sip. 80 m<sup>2</sup>, ka kushtuar 500.000 lekë. Mbi këtë pasuri, ai nuk ka asnjë të drejtë reale dhe asnjë pretendim, pasi ajo ka qenë pasuri e prindërve të tij, të cilët kanë pasur burime të ligjshme për krijimin e saj.

**23.3** Nga analizimi i vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se për efekt të analizës financiare, është përfshirë si shpenzim për ndërtimin e objektit në vitin 1996, vlera 1.108.065 lekë, si dhe në vitin 1999 është përfshirë si shpenzimin për blerjen e truallit<sup>38</sup> të

<sup>38</sup> Me akt noterial blerje nr. {\*\*\*}, datë 12.02.1999.

objektit, vlera prej 350.000 lekësh. Në analizën ekonomike gjithashtu është përfshirë si e ardhur edhe vlera e siguruar nga shitja e objektit<sup>39</sup>, në masën 1.500.000 lekë, në vitin 1999.

**23.4** Lidhur me pasurinë truall dhe dyqan me sip. 80 m<sup>2</sup> në Peshkopi, Kolegji konstaton se vetë vendimi i Komisionit evidenton se kjo pasuri është shitur nga familja Maksuti në vitin 1999, fakt i cili tregon se ajo jo vetëm nuk ka ekzistuar si pronë e kësaj familjeje në kohën e dorëzimit të deklaratës *vetting*, përkatësisht në janar 2017, por edhe shumë kohë para qenies së subjektit të rivlerësimit subjekt deklarues i pasurisë sipas ligjit nr. 9049/2003. Në analizë të kësaj shtate faktike, duke iu referuar përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, i cili për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, ka përcaktuar detyrimin e tyre për të deklaruar të gjitha pasuritë që disponojnë në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, si dhe deklarimin e burimeve të financimit të tyre, Kolegji çmon se as subjekti i rivlerësimit dhe as babai i tij nuk kanë pasur detyrim të deklarojnë në deklaratën *vetting*, një pasuri që nuk e dispononin në momentin e dorëzimit të kësaj deklarate, pasi e kanë shitur në vitin 1999.

**23.5** *Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij nuk kanë deklaruar në deklaratën “vetting” në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë truall dhe lokal me sip. 80 m<sup>2</sup> në Peshkopi, vlerësohet nga Kolegji se nuk është një konkluzion i drejtë, pasi subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016, nuk kanë detyrim për të deklaruar të dhënat e pretenduara në këtë deklaratë për një pasuri të tjetërsuar dhe që nuk ishte në pronësi të tyre që nga viti 1999.*

- 24** Përveç sa më sipër, Kolegji mori në shqyrtim edhe disa nga konkluzionet e Komisionit, të përsëritura përgjatë arsytimit të vendimit, sipas të cilave subjekti ka kryer *deklarime të pasakta*<sup>40</sup>, lidhur me të ardhurat e tij apo të babait të tij ndër vite, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Kolegji vlerëson se ky konkluzion i Komisionit është i pambështetur në ligj, përderisa nga të gjitha të dhënat e administruara gjatë hetimit, rezulton se subjekti nuk arrin të provojë të gjitha të ardhurat e deklaruara se ka përfituar ai dhe babai i tij në periudhën para se subjekti të ushtronte funksionet e prokurorit. Në këtë kuptim, kualifikimi i saktë i situatës do të duhej të asociohej me pamundësinë e subjektit për të provuar të ardhurat e deklaruara, por edhe standardin e së ardhurës së ligjshme të përcaktuar nga parashikimet e ligjit nr. 84/2016. Të ardhurat e

---

<sup>39</sup> *Me aktin noterial nr.{\*\*\*} rep., e nr.{\*\*\*} kol., datë 15.1999, në të cilin është evidentuar edhe pagesa e detyrimeve tatimore për këtë transaksion.*

<sup>40</sup> *Në vendimin e Komisionit, lidhur me deklarime të pasakta për elemente të caktuara të kriterit të vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, është arsyetuar/konkluduar se:*

○ *Në paragrafin 33.7, fjalia e fundit për pasurinë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, ndër të tjera, është konkluduar se: “[...] si përfundim, ka rezultuar se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.*

○ *Në paragrafin 74.6, lidhur me kursimet në cash të babait të subjektit, ndër të tjera, është konkluduar se: “Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me të ardhurat e krijuara nga babai i tij, si dhe nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e pasurive për periudhën 1993 – 2008, në kuptim të pikave 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, germave “a” dhe “b” të nenit 33/5, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.*

pretenduara prej subjektit se janë realizuar prej tij dhe babait të tij, para se ai të fillonte të ushtronte detyrën, vetëm sepse ai gjendet në pamundësi t'i provojë në vlerat e deklaruara, nuk duhet të çonin Komisionin në konkluzionin se ai ka bërë deklarime të pasakta, si një shkak penalizues për vendosjen e masës disiplinore. Mungesa e provueshmërisë së tyre, sigurisht që ka konsekuencën e saj në procesin e rivlerësimit, nëpërmjet mosnjohjes së tyre si të ardhura të ligjshme sipas parashikimit të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 dhe krijon pasojën e saj në analizën financiare që i bëhet subjektit, por kjo rrethanë nuk mund të penalizojë subjektin edhe me kualifikimin e një deklarimi të pasaktë.

**24.1** Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se konkluzionet e Komisionit për deklarime të pasakta të të ardhurave të subjektit dhe të personit të lidhur nuk mund të kualifikohen sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që saktësia e tyre përcaktohet me pamundësinë në disa raste të provueshmërisë së këtyre të ardhurave, konkluzion që afekton burimin e krijimit të pasurisë, por jo deklarimet e subjektit.

**24.2** Gjithashtu, Kolegji, në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni ka përcaktuar balanca negative në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, duke mbledhur balancat negative të konstatuara për krijimin e secilës pasuri dhe duke krijuar praktikisht një balancë të re negative artificiale për situatën e subjektit dhe të familjes së tij. Ndonëse Kolegji arriti në konkluzione të ndryshme nga Komisioni për burimet e krijimit të pasurive të tij dhe të personit të lidhur, kryesisht mbështetur në konsiderimin e kursimeve në *cash* të babait të tij, ndonëse të padeklaruara në DPV-të, për shkak të mospasjes së detyrimit për deklarim, sërish Kolegji e gjen me vend të evidentojë si një pasqyrim të pasaktë nga ana e Komisionit, të gjendjes financiare nëpërmjet një përlllogaritjeje të tillë.

**24.3** Për pasojë, lidhur me konkluzionet e Komisionit që konstatojnë mungesë të burimeve të ligjshme si shumatore të balancave negative të viteve, Kolegji vlerëson se nuk afektojnë kriterin e vlerësimit të pasurisë, për sa kohë që mbivendosen me balancat negative konkrete të lidhura me çdo pasuri.

**24.4** Pasi shqyrtoi të gjitha shkaqet e ankimit të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit dhe arriti në konkluzionet e sipërcituara për secilën prej tyre, Kolegji vlerëson të evidentojë rrethanat e konstatuara, të cilat konsiderohen se e vendosin subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të cilat duhet të shqyrtohen në këtë rast në mënyrë të veçantë, në zbatim të parimeve të objektivitetit e proporcionalitetit, sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**24.5** Situatat për të cilat subjekti do të ngarkohej me përgjegjësi në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, në përfundim të shqyrtimit të të gjitha shkaqeve të ankimit, janë ato që lidhen me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin nga personi i lidhur, babai i subjektit, të shtëpisë së ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, të blerë në vitet 2004 dhe 2005, në total, sipas analizës dhe vlerësimit të bërë në Kolegji, në vlerën prej 2.386.496 lekësh, si edhe me balancat negative të konstatuara në krijimin prej subjektit të rivlerësimit të pasurisë automjet “Wolkswagen Sharan 2.0” dhe me llogarinë në Bankën BKT, në total në vlerën prej 663.507 lekësh, në vitet 2009 dhe 2017. Në vlerësimin e këtyre balancave negative, Kolegji mbajti në konsideratë një sërë rrethanash që shoqërojnë rastin objekt gjykimi e që përcaktojnë peshën e

këtyre balancave negative në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

**24.6** *Së pari*, pasuria apartament banimi në pronësi të personit të lidhur, babait të subjektit, për krijimin e së cilës rezulton se konstatohet balanca negative prej 2.386.496 lekësh, është një pasuri e krijuar në vitet 2004-2005, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka filluar të ushtrojë funksionet e prokurorit në gusht të vitit 2008. Ky fakt përjashton tej çdo dyshimi se subjekti ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit me detyrën e tij në krijimin e kësaj pasurie, duke ardhur në një frymë pajtuese me qëllimin e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, që synojnë nxjerrjen nga sistemi të individëve që kanë abuzuar me detyrën për përfitimet e tyre personale.

**24.7** *Së dyti*, kjo pasuri është në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit dhe është deklaruar se është krijuar me të ardhurat e fituara prej tij përgjatë viteve të punës si avokat e noter në qytetin e Peshkopisë. Për më tepër, kjo pasuri nuk rezulton të jetë vetëm formalisht në emër të tij, por ajo është banesa ku ka jetuar e gjithë familja, kryefamiljar i së cilës është babai i subjektit, pas zhvendosjes nga Peshkopia në Tiranë, fakt që dëshmon për kontributin real të personit të lidhur për të siguruar banimin në qytetin ku kishin vendosur të jetonin së bashku. Kjo rrethanë për ligj përdorimin e çdo burimi financiar për financimin e saj, si një obligim familjar të kryefamiljarit, veçanërisht brenda kontekstit të realitetit shqiptar. Këto përpjekje e veprime të kryera nga personi i lidhur, kur subjekti i rivlerësimit nuk kishte funksionet e magistratit, nuk mund të përcaktojnë në një shkallë domethënëse karrierën e tij të mëpasshme.

**24.8** *Së treti*, edhe Kolegji ashtu si Komisioni, ndonëse ka pranuar se të ardhurat e provuara prej subjektit se janë përfituar prej babait të tij, mund të kenë qenë më ulëta se ato të krijuara realisht, sërish kanë përdorur në analizën financiare të kryer për verifikimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, vetëm atë pjesë, madje në disa periudha bazike dhe të paarsyeshme, konsideruar shërbimit avokator e përfaqësues të personit të lidhur, por për të cilat gjendet bazueshmëri në dokumentacionin ligjor të kohës. Tarifat e përfaqësimit në gjykatë, në vlerën prej 500 lekësh, mbeten në vëmendjen e Kolegjit gjithsesi si shifra që vështirë t'i përgjigjen realitetit, i cili impononte edhe në fillesat e ushtrimit të avokatisë tarifa më të larta shërbimi. Pjesë e këtij vlerësimi mbeten edhe të ardhurat e krijuara prej vetë subjektit prej entiteteve të huaja [*Misionit të Monitorimit të Komunitetit Europian (ECMM) dhe Komitetit Ndërkombëtar të Shpëtimit (IRC)*], për të cilat ai nuk provon pagimin e detyrimeve tatimore. E gjithë kjo situatë dëshmon për ekzistencën me shumë mundësi të të ardhurave të tjera nga burime të ligjshme, por të pamundura për t'u provuar, që duhet të ketë afektuar situatën financiare të familjes në kohën e krijimit të kësaj pasurie.

**24.9** *Së katërti*, një burim tjetër i përdorur për financimin e kësaj pasurie, ka ardhur nga shitja e dy pasurive të paluajtshme të tjera në pronësi të babait të subjektit dhe atij vetë, pasuri të krijuara gjithashtu para marrjes së detyrës e të konfirmuara se janë krijuar me burime të ligjshme. Të dyja këto pasuri, një apartament në Peshkopi dhe një apartament te pallatet “{\*\*\*}” në Tiranë, janë shitur dhe paratë e fituara janë përdorur për financimin e pasurisë në fjalë. Nga analiza e këtyre transaksioneve, *së pari* potencohet qëllimi i strehimit në Tiranë të familjes, si një përpjekje legjitime për jetesë më të mirë; *së dyti*, ka rezultuar se vlerat e përfituara nga shitja e këtyre pasurive, kanë pasur kundërshti nga ana e subjektit, mbështetur

qoftë në akte shkresore, siç është aktmarrëveshja për apartamentin në Peshkopi, por edhe çmimi më i ulët i shitjes nga ai blerjes i apartamentit në pallatet “{\*\*\*}”, në Tiranë, elemente që evidentojnë minimalisht çështje rreth vlerës reale të përfituar prej shitjes së tyre, e cila me gjasa ka qenë më e lartë se ajo e dokumentuar, fakte të pranuar e të njohura edhe nga vetë Komisioni në arsyetimin e tij.

**24.10** Të gjitha këto rrethana dobësojnë peshën specifike të balancës negative prej 2.386.496 lekësh, për krijimin e pasurisë apartament, si e vetmja pasuri e paluajtshme e disponuar jo vetëm nga subjekti, por nga gjithë familja e tij e origjinës, por edhe ajo e krijuar pas martesës. Kjo pasuri e krijuar para se subjekti të merrte detyrën e prokurorit, e pajisur edhe me një mobilim modest sipas pamjeve të fotografive të administruara në fashikull, që ka shërbyer për strehimin e gjithë familjes dhe është krijuar jashtë ndikimit të subjektit si prokuror, pavarësisht faktit se rezultoi të mos jetë krejtësisht e mbuluar me të ardhura të ligjshme, sipas standardit të ligjit nr. 84/2016, pavarësisht se evidentohen burime të ligjshme për krijim të ardhurash në vlera të paprovuara, nuk mundet, në vlerësimin e Kolegjit, të përfaqësojë një problematikë të tillë në vlerësimin e pasurisë, që të justifikojë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**24.11** Kolegji vlerësoi edhe balancën negative që u përket realisht pasurive të subjektit, asaj të krijuar për shkak të blerjes së automjetit “Wolkswagen Sharan 2.0”, në vlerën prej 463.507 lekësh, dhe mungesës për krijimin e shumës 200.000 lekë, të përdorur për llogarinë në Bankën BKT të bashkëshortes dhe të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të të njëjtave parime dhe në këndvështrim të praktikës së Kolegjit mbi vlerësimin e balancave negative, duke i konsideruar ato pa peshë në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

**25** Në përfundim, Kolegji vlerësoi balancat negative të konstatuara në vitet 2004 dhe 2005 – në vlerën prej 2.386.496 lekësh, dhe që lidhen me krijimin e pasurisë apartament me sip. 133,4 m<sup>2</sup> në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, si dhe balancat negative lidhur me krijimin e pasurisë automjet “Wolkswagen Sharan 2.0” dhe të llogarisë në Bankën BKT, në total në vlerën prej 663.507 lekësh – të cilat, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, u çmuan si balanca negative që nuk justifikojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra dhe plotësojnë kushtet për konkludimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e një deklarami të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**26** Për sa më sipër, duke konsideruar se subjekti ka rezultuar se ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me konkluzionin e arritur për një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në këto rrethana, vendimi i Komisionit duhet ndryshuar dhe ai duhet të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupit gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 367, datë 16.04.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bledar Maksuti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 03.05.2023.

### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi - kundër*

### **ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi - kundër*

### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

### **KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

## MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, votuam për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [nr. 367, datë 16.04.2021] që ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Bledar Maksuti. Në vlerësimin tonë, ndryshe nga shumica e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm në kontrollin e kriterit të pasurisë, në vijim të disa konstatimeve që bazohen në arsyetimin që shtjellohet në vijim.
2. Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe personat e lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet dhe krijimin e pasurive në një vlerë mbi 9 milionë lekë, për periudhën kohore nga viti 2008 deri në vitin 2016. Viti 2008 përkon me kohën kur subjekti është emëruar prokuror. Duhet theksuar që më herët ai ka qenë sidoqoftë subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, si Oficer i Policisë Gjyqësore (OPGj), duke filluar nga viti 2004. Me fjalë të tjera, subjekti ka deklarime të interesave private që mund të shërbejnë si provë në procesin e rivlerësimit edhe përpara vitit 2008. Komisioni duket të ketë pranuar pretendimet e subjektit për të kryer kontrollin e pasurisë vetëm për periudhën gjatë së cilës ai ka qenë magjistrat, duke nisur për rrjedhojë nga viti 2008.
3. Edhe në vlerësimin tonë, subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, në sasi të konsiderueshme, që nuk legjitimojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit edhe nëse merren në konsideratë *vetëm* pasuritë që janë formalisht në emër të subjektit të rivlerësimit. Nëse përfshihen edhe pasuritë, frytet e të cilave i gëzon subjekti e bashkëshortja, apo ato për të cilat zbatohet prezumimi ligjor i bashkëpronësisë – siç është llogaria bankare e çelur në vitin 2012 me *cash* të depozituar nga subjekti, formalisht në emër të tij e të nënës, konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Sjell në vëmendje këtë dallim mes dy kategorive të pasurive, atyre në emër të tij, e atyre në emër të prindërve, pasi ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në ankim, ai vetë nuk rezulton të ketë qenë i dyzuar ndër vite. Subjekti rregullisht ka deklaruar të ardhurat e prindërve, si dhe veprime të caktuara juridike [si shembull, huaja motrave shtjelluar më poshtë], të kryera nga i ati, duke paraqitur në këtë mënyrë me vullnet të qartë një panoramë të zbalancuar. Nga njëra anë, paraqiten të ardhura të konsiderueshme në dispozicion të tij, por përtej kontrollit nga ligji nr. 9049/2003. Nga ana tjetër, subjekti ka parashtruar një situatë në të cilën gjithë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme në dispozicion, e pronësi të tij [e bashkëshortes], u janë atribuar të ardhurave të prindërve. Ndërkohë, kontributi i tij – subjekt që i nënshtrohet kontrollit ndër vite dhe në procesin e rivlerësimit – nuk rezulton të jetë deklaruar asnjëherë, qoftë edhe përafërsisht.
4. Në kushtet kur procesit të rivlerësimit i nënshtrohen pasuritë e personave të lidhur me subjektet e rivlerësimit<sup>41</sup>, është përtej çdo kontestimi të mundshëm që procesit të rivlerësimit për subjektin Bledar Maksuti do t'i nënshtrohen pasuritë dhe të ardhurat që janë deklaruar prej tij rregullisht si burim, e konkretisht, të ardhurat e familjarëve me të cilët ai ka jetuar në mënyrë të pandërprerë, përpara dhe pas martesë, përfshirë edhe pasi ai dhe bashkëshortja kishin krijuar familje e shtuar me tre fëmijë. Subjekti ka zgjedhur pa asnjë ekuivok në gjithë deklaratat

---

<sup>41</sup> Sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016: “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.



periodike vjetore që çdo posedim, pasuri e shpenzim të kryer t'ia atribuojë kontributit të prindërve të tij<sup>42</sup>, pavarësisht se në janar 2017 – në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit [deklarata *vetting*] – kishte punuar për 18 vjet, 14 prej të cilave në sistemin e drejtësisë<sup>43</sup>. Nën dritën e ligjit, në rrethanat konkrete, subjekti ka detyrimin të justifikojë pasuritë e prindërve në cilësinë e personave të lidhur.

5. Është alogjizëm, për këtë arsye, qasja kontradiktore e treguar prej subjektit për kursimet e prindërve në formë likuiditetesh jashtë sistemit bankar, të cilat për herë të parë janë parashtruar si burim krijimi të ardhurash apo ekzistuese, përtej sa deklarohet indirekt për ekzistencën e tyre në funksion të krijimit të pasurive e huadhënieve në deklaratat periodike vjetore. Kjo qasje bie ndesh edhe me mënyrën se si ai deklaroi *cash*-in, në vlerën 1,4 milionë lekë, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si “*trung familjar*”. Subjekti ka deklaruar rregullisht të ardhurat e prindërve në vite, deklaruar në vitet 2008, 2009 dhe 2010 [me deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe ato periodike vjetore për vitet 2008 dhe 2009], huatë e dhëna nga babai motrave, sikurse edhe krijimin e pasurive në emër të tij nga kursimet e puna e prindërve, por asnjëherë kursime të tyre jashtë sistemit bankar. Specifikimi i *cash*-it si “*trung familjar*”, duke abstraguuar nga fakti që përbën një koncept të pabazuar në ligjin nr. 84/2016, vlerësojmë se bën pjesë në qasjen e vullnetshme të subjektit ndër vite për të mos treguar transparencë në kontributin e tij në krijimin e pasurive, për të mënjeluar kontrollin.
6. E konstatojmë jobindës, për rrjedhojë, pretendimin e subjektit se ka treguar transparencë përtej sa kërkon ligji nr. 9049/2003, në kushtet kur ai nuk rezulton ta ketë pasur këtë qasje për veprime të tjera të babait, por vetëm për të ardhura të krijuara e të disponueshme, qoftë edhe teorikisht, pretenduar në një moment kyç, siç ishte deklarata para fillimit të detyrës si prokuror. Këto fonde, më pas do t'i atribuoheshin babait, një individ që nuk ishte subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003. Nëse subjekti do të kishte vepruar me transparencën që pretendohet, minimalisht në deklaratat periodike vjetore do të tregoheshin përqindjet e kontributit të tij kundrejt *cash*-it apo edhe në atë që përshkruhet si *cash*-i jashtë sistemit bankar si “*trung familjar*” në deklaratën e pasurisë. Kjo nuk rezulton të ketë ndodhur. Përkundrazi, subjekti, i gjendur përpara faktit në të cilin Komisioni konstatoi problematika lidhur me të ardhurat e fituara nga një automjet në pronësi të tij, ia atribuoi edhe krijimin e kësaj pasurie formalisht të dhuruar, “shërbimeve juridike” të kryera nga i ati për shitësin, për të evituar pasojat financiare që do të kishte mospagimi i tatimeve sipas Komisionit. Me fjalë të tjera, subjekti parashtroi në mënyrë konsistente një dhurim si blerje. Në momentin kur ky shpjegim rezultoi i pafavorshëm për situatën e tij financiare, subjekti paraqiti shpjegime të ndryshme duke e argumentuar dhurimin tashmë, si shlyerje detyrimesh *ndaj babait*, i cili në kohën e veprimit nuk ishte objekt kontrolli i pasurisë.
7. Siç përmendëm më sipër, subjekti ka deklaruar interesa privatë të babait të tij në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror. Nga analiza e këtyre deklaratave, rezulton se dy hua, në shumën në total prej 45 mijë eurosh, nuk i ishin kthyer babait të paktën deri në 15 mars 2010, ditën kur subjekti ka plotësuar deklaratën periodike vjetore për vitin 2009. Më pas, pavarësisht

---

<sup>42</sup> Subjekti pretendon edhe dhurime bashkëshortes nga prindërit e saj, të cilët në kuptim të ligjit janë trajtuar nga Komisioni dhe Kolegji si persona të tjerë të lidhur.

<sup>43</sup> Në faqen 8 të deklaratës së pasurisë, subjekti deklaroi të ardhura duke nisur nga viti 1999, pranë disa misioneve ndërkombëtare të monitorimit dhe organizatave ndërqeveritare. Si OPGj në vitet 2002-2008.

nga detyrimi për të reflektuar ndryshime të kësaj marrëdhënieje juridike, në kushtet që subjekti i kishte deklaruar, qoftë edhe për të treguar kujdes për anën formale të deklarimit, këto hua për herë të parë janë përmendur prej tij në hetimin administrativ, si *cash* i disponuar jashtë sistemit bankar, e nga i cili janë gjeneruar hua që i ati u ka dhënë dy individëve të tjerë në vitin 2015, si dhe një depozitë bankare e krijuar prej tij në janar 2017. Në analizën e gjithë rrethanave konkrete, kemi vlerësuar se deklarimi i një shume monetare të pritshme teorikisht, deklaruar në tri deklarata periodike vjetore si të dhëna nga babai i subjektit motrave të tij, në totalin prej 45 mijë eurosh, nuk pasqyron të vërtetën.

8. Është kjo arsyeja përse në deklaratën përpara fillimit të detyrës së prokurorit, më 2 dhjetor 2008, subjekti nuk ia ka atribuuar këto fonde e këtë marrëdhënie huaje babait të tij. Ky atribuuim ka ndodhur në mars 2009, me deklaratën periodike vjetore për vitin 2008. Po ashtu, vërejmë që subjekti ishte evaziv e kontradiktor në specifikimin e periudhës kohore konkrete kur janë kthyer huatë. Gjatë pyetësorëve, subjekti e ka vendosur kthimin “në fillim të vitit 2009”<sup>44</sup>. Ky pretendim bie ndesh me deklarimin e tyre të pandryshuar në mars 2010, në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009, si ekzistente dhe ende në fuqi. Ndërkohë, në deklaratën përpara fillimit të detyrës, subjekti ka deklaruar sikur huaja të ishte dhënë prej tij. Vetëm tre muaj më vonë, në mars 2009, me deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti ia ka atribuuar huatë babait. Pyetur nga ILDKPKI-ja, më 25 mars 2009, subjekti ka pretenduar se paratë “zotërohen” nga babai, ndërkohë që disa ditë më herët, më 15 mars 2009, sikurse edhe një vit më pas, i ka deklaruar në deklaratat periodike. Subjekti ka qenë kontradiktor edhe për kohën e dhënies së këtyre huave. Në pyetësorin e Komisionit, më 24 qershor 2020, subjekti ka specifikuar se huatë janë dhënë në vitet 2000-2002, ndërsa në mars 2016, në ILDKPKI, subjekti ka përfshirë edhe të ardhurat deri në vitin 2006, në gamën e fondeve që kanë shërbyer për huatë. Ky fakt e ndryshon kohën e huadhënies me disa vite. Së fundmi, është i pakuptimtë deklarimi i llojit të valutës së përdorur [euro], ndërkohë që ekuivalenti i tyre shfaqet më pas në ALL, sikurse edhe fakti që euro nuk ekzistonte në treg në vitin 2000<sup>45</sup>.
9. Në përmbledhje të sa më sipër, vlerësojmë që pretendimet e subjektit për huatë e dhëna motrave nga babai në vitet 2000 dhe 2002, sikurse edhe për kthimin e tyre, veprime të cilat nuk kanë gjetur pasqyrim në deklaratat periodike vjetore, që më pas deklarohen si burim krijimi pasurish/transaksionesh financiare, karakterizohen nga mospërputhje të atilla logjike që i bëjnë ato jobindëse, e në funksion të justifikimit të veprimeve të mëvonshme.
10. Një aspekt tjetër i kontrollit të pasurisë së subjektit, mbi të cilën bazohet vlerësimi ynë për subjektin, bazohet në rrethanat që lidhen me dinamikën e krijimit të depozitës bankare dyemërore të subjektit me nënën në BKT, në vitin 2012. Pretendimet e subjektit se këto janë të njëjtat fonde që kanë qenë edhe më herët në të njëjtën bankë, janë jobindëse pasi janë thjesht deklarative e bien ndesh me prezumimin ligjor dhe faktet. Së pari, prezumimi ligjor nënkupton që llogaria dyemërore u përket të dy llogarimbajtësve. Subjekti ka kryer depozitimin e vlerës personalisht, në *cash*, në vitin 2012. Minimalisht, këto rrethana tregojnë që pretendimet e tij se

---

<sup>44</sup> Përgjigje të pyetësorit, datë 24.06.2020, të Komisionit.

<sup>45</sup> [https://european-union.europa.eu/institutions-laë-budget/euro/history-and-purpose\\_en#:~:text=After%20a%20decade%20of%20preparations,changeover%20in%20history%20took%20p lace](https://european-union.europa.eu/institutions-laë-budget/euro/history-and-purpose_en#:~:text=After%20a%20decade%20of%20preparations,changeover%20in%20history%20took%20p lace)

këto ishin fonde “të përdorura për të ndihmuar familjarë” dhe përbëjnë të njëjtat fonde që janë tërhequr në vitin 2005 nga nëna, janë të paprovuara dhe të pakuptimta.

11. Sa më sipër, bazohet në analizën e disa fakteve. Së pari, të gjitha depozitimet në shtator 2005, në totalin e 2,8 milionë lekëve, janë kryer me *cash*. Së dyti, nuk ka asnjë gjurmë të destinacionit të fondeve të tërhequra nga nëna në periudhën kohore nga korriku 2006 deri në nëntor 2008, për 28 muaj, në total në vlerën prej 2,5 milionë lekësh [afërsisht]. Së treti, është e pakuptimtë tërheqja e vlerës së mbetur, prej 574.280 lekësh, në mars 2012, dhe hapja e një llogarie të re dyemërore me para të sjella në *cash* nga vetë subjekti i rivlerësimit, në të njëjtën bankë, në të njëjtën ditë. Përpos pretendimit të subjektit se këto 2,5 milionë lekë janë ato të tërhequra më sipër, nuk ka asnjë indicie që këto janë të njëjtat fonde, sikurse edhe nuk bën kuptim hapja e një llogarie të re pasi janë tërhequr paratë në *cash* nga një llogari në të njëjtën bankë.
12. Në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar *cash* jashtë sistemit bankar asnjëherë [përveç atyre të deklaruar nga bashkëshortja në deklaratën e saj të parë si dhuratë nga prindërit, shtjelluar më sipër], pretendimi i tij për të njëjtat fonde të ridepozituara është jobindës dhe bie ndesh me metodologjinë e deklarimeve të tij, shtjelluar në detaj më sipër. Në këtë linjë ka qenë qëndrimi i Kolegjit në një çështje të ngjashme, kundrejt pretendimeve të subjektit për kursime të prindërve, të cilët u konsideruan persona të tjerë të lidhur. Në atë çështje<sup>46</sup>, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që:

“[...] Në mungesë të provave të tjera, të vetmet akte provuese për deklaratimet *cash*, mbeten deklaratimet e subjektit në deklaratat vjetore. Në rastin e deklarimit të *cash*-it në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk arrin të provojë të kundërtën për sa pretendon, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se mbetet i bazuar qëndrimi i Komisionit se deklarimi i subjektit gjatë procesit të rivlerësimit mbetet deklarativ dhe i pambështetur në dokumentacion provues, në mungesë dhe të deklarimeve *vetting* nga personat e lidhur, prindërit e tij. I njëjti qëndrim mbahet nga Kolegji edhe lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se motrat kanë pasur likuiditete *cash*, në vlerën prej 1.000.000 lekësh, si kursime në vitin 2009 [...]”
13. Një rrethanë tjetër që mbajmë në konsideratë në vlerësimin e besueshmërisë së subjektit, është ajo që lidhet me dinamikën e çeljes së llogarisë bankare. Subjekti pretendon se ka çelur llogarinë e ruajtur të drejta tërheqjeje prej saj, për shkak të pamundësisë shëndetësore të nënës. Ky pretendim paraqitet jobindës nëse sillet në vëmendje që babai i subjektit deklarohet të ketë qenë aktivisht i përfshirë në aktivitet fitimprurës, përfshirë edhe në dobi të subjektit. Për pasojë, duket e pashpjegueshme nevoja për t’ia “deleguar” subjektit ndihmën e nënës, për një llogari në të cilën babai ishte edhe formalisht bashkëpronar i këtyre likuiditeteve, në një periudhë kohore kur ai [babai] rezulton i angazhuar në mënyrë të konsiderueshme në krijimin e të mirave materiale. Nga ana tjetër, depozita bankare në vitin 2012, çelet me derdhje parash *cash* në vlerë të konsiderueshme, nga subjekti, në të njëjtën ditë që ishte mbyllur një llogari tjetër në emër të nënës, në të njëjtën bankë, në prani të llogarimbajtëses. Si subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, subjekti duhet të ishte minimalisht i ndërgjegjshëm për pikëpyetjet që ngre një dinamikë e tillë me *cash* të sjellë fizikisht në bankë, në vlera të konsiderueshme, nga një prokuror.

<sup>46</sup> <https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/06/Vendim-JR-Ervin-Begiri-anonimizuar.pdf>, paragrafi 37.1.

14. Subjekti pretendon se të ardhurat për krijimin e kësaj depozite, kishin burim gjendjen e *cash*-it që kishte babai nga emërimi i subjektit në detyrë dhe të ardhurat e tjera. Në analizën e kryer për ekonominë e përbashkët, siç deklaroi subjekti, ai dhe prindërit rezultojnë me mungesë burimesh për krijimin e depozitës dyemërore.
15. Në vlerësim të sa më sipër, dhe jo vetëm, rezulton se subjekti gjendet në pamundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme pasuritë: (i) automjet, blerë në vitin 2015 [marka “Mercedes Benz”, me balancë negative në vlerën (-) 463.507 lekë]; (ii) llogari bankare dyemërore me nënën në BKT, në vlerën përreth 3 milionë lekë, çelur në vitin 2012 [me balancë negative në vlerën (-) 414.600 lekë afërsisht]; (iii) llogaria në BKT, krijuar në vitin 2017, me bashkëshorten [me balancë negative në vlerën (-) 294.924 lekë]; (iii) *cash*-i si “trung familjar”, i deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në vlerën 1,4 milionë lekë në total. Përpos këtyre pasurive të cilat janë në emër të tij, subjekti e personat e lidhur gjenden në pamundësi financiare për të krijuar edhe pasuritë: (i) depozitë bankare e çelur në janar 2017, në vlerën 2,7 milionë lekë [me balancë negative në vlerën (-) 2 milionë lekë afërsisht]; (ii) garazh i blerë nga babai në vitin 2016 [me balancë negative në vlerën (-) 579.542 lekë].
16. Subjekti nuk është bindës në *asnjë* prej pretendimeve të tij dhe përpiqet ta parashtrijë situatën në një dritë të favorshme, në funksion dhe sipas situatës së tij financiare në procesin e rivlerësimit. Pavarësisht nga këto përpjekje, e çmojmë me rëndësi të theksojmë se çdo pasuri e gëzuar prej tij paraqitet me probleme thelbësore. Konkretisht dhe si edhe shtjelluar më sipër, këto probleme janë më të dukshme, ndër të tjera, si vijojnë:
- (i) Automjeti *i dhuruar* deklarohet *i shitur* ndër vite, në çdo deklaram, dhe në procesin e hetimit administrativ, ndërsa vlera e shpenzuar për të paraqitet e ndryshme në kohë të ndryshme. Asnjëherë subjekti nuk ka specifikuar totalin e shpenzuar prej tij për këtë automjet. Në pikën fundore, pasi nga hetimi i Komisionit rezultoi se automjeti ishte fituar me dhurim formalisht, subjekti parashtrijoi një skenar të ri, sipas të cilit shitësi ia dhuroi automjetin subjektit, për të shpërblyer *babanë e subjektit* për shërbime juridike.
- (ii) Kontradiktat e shumta dhe mospërputhjet në deklaramin e huave të dhëna motrave, të cilat subjekti ia atribuon mënyrës së të shprehurit të tij. Përpos të tjerave, është e pakuptimtë dhënia e huave në *euro*, ndërkohë që të njëjtat fonde shfaqen më vonë si burim krijimi huash/pasurie në *lekë*, duke abstraguuar nga fakti që sasi të konsiderueshme likuiditeti mbahen jashtë sistemit bankar për periudha të gjata kohore. Përpos këtij fakti, monedha *euro* nuk ka ekzistuar në vitin 2000, kur subjekti pretendon huanë e parë, në vlerën 20.000 “euro”. Për herë të parë, euro është hedhur në tregun e disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian më 1 janar 2002.
- (iii) Subjekti është konsistent në mosdeklaramin e pjesës takuese të kontributit të tij kundrejt atij të prindërve, në gjithë sa deklaruar më sipër. Nëse subjekti do të kishte zgjedhur përgjigje të cilat me transparencë përcaktonin përqindjen e të ardhurave të tij e bashkëshortes përkundër atyre të prindërve, të ardhurat e prindërve do të ishin bërë pjesë e një analize përkatëse e me probabilitet të lartë, me rezultate të ndryshme për procesin e rivlerësimit të subjektit.
- (iv) Pamundësia e vjehrrit për t’i dhuruar shumën e pretenduar bashkëshortes, në vlerën 800.000 lekë përpara martesë, së bashku me dinamikën e këtij dhurimi. Pretendohet sërish dhuratë në likuiditet *cash*, jashtë sistemit bankar, nga një individ, i cili ka për aktivitet tregtar

përdorimin e lehtësisë dhe sigurisë së veprimeve nëpërmjet bankës kundrejt fitimit<sup>47</sup>. Me fjalë të tjera, edhe kur dhurues është një individ me njohuri e familjaritet të shtuar me tregun financiar dhe përfitimet e lehtësitë që ofron lëvizja e fondeve nëpërmjet bankave, pretendohet dhurim në *cash*, që për nga natyra, është i pagjurmueshëm.

(v) Problematika e konstatuar nga Komisioni në vendim lidhur me provueshmërinë e burimeve të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar blerjen e apartamentit [ku jeton subjekti] në vitin 2005, në pronësi të babait, parë bashkë me huadhënien motrave të subjektit në vitet 2000 dhe 2002.

17. Në rrethanat kur subjekti i rivlerësimit parashtron një dinamikë raportesh në të cilat një magjistrat, i dypunësuar, i atribuon bujarisë e gatishmërisë së prindërve për të prodhuar dhe kontribuar mbulimin e çdo nevojë financiare të subjektit e familjes së tij prej pesë anëtarësh, dy prej të cilëve të punësuar, argumentet e subjektit i konsideruam të pasinqerta. Subjekti sjell një panoramë në të cilën prindërit paraqiten si dhurues të përhershëm, thuajse një institucion financiar në dispozicion të tij, ndërsa subjekti e bashkëshortja, përfitues të vazhdueshëm, ndonëse këta të fundit janë madhorë, të punësuar e me përgjegjësi familjare të familjes së ndërtuar prej tyre. Duke u shtuar pretendimeve të pabesueshme sa më sipër faktin që subjekti ka detyrime si subjekt deklarues, si dhe në procesin e rivlerësimit për qartësi e saktësi në kontributin e tij, vlerësuam që subjekti i rivlerësimit Bledar Maksuti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe vendimi i Komisionit për shkarkimin e tij duhet të ishte lënë në fuqi.

**GJYQTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

---

<sup>47</sup> Vjehri i subjektit rezulton, ndër të tjera, i licencuar të veprjës si agjent i {\*\*\*} për {\*\*\*}, minimalisht në periudhën 2002-2010.